



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 563 Akti

Nr. 730 Vendimi
Tiranë, më 10.1.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datat 19.12.2023 dhe 9.1.2024, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi dy seanca dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Valentin Preçi**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Valentin Preçi është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Valentin Preçi i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Nga Komisioni janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

4. Trupi gjykues, me vendimin nr.1 datë 22.6.2020 pas studimit të raporteve të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesuese komisioneren Firdes Shuli dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues me vendimin nr. 2 datë 21.11.2023 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Valentin Preçi për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave e thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në datën 21.11.2023, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për sjelljen e provave dhe shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës deri në datën 5.12.2023. Me kërkesën e datës 30.11.2023, subjekti kërkoi kohë shtesë për të sjellë prova dhe shpjegime. Me vendimin nr. 3, datë 1.12.2023, Komisioni vendosi të pranojë kërkesën e subjektit, duke e shtyrë afatin deri në datën 15.12.2023.

7. Trupi gjykues, pas marrjes së provave dhe shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. 4, date 18.12.2023 ka vendosur të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore, në datën 19.12.2023, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, Tiranë. Pas seancës dëgjimore trupi gjykues u tërhoq për vendim.

8. Me vendimin nr. 5 të datës 26.12.2023, trupi gjykues vendosi të riçelë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit për shkak të administrimit të denoncimeve të reja, si dhe disa qartësimeve e saktësimeve të mëtejshme në lidhje me pretendimet e tij për rishikimin e analizës financiare, duke i dhënë subjektit një afat për dërgimin e parashtrimeve deri në datën 5.1.2024

9. Me vendimin nr. 6 të datës 5.1.2024, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimin administrativ dhe të thërrasë në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit në datën 9.1.2024, ora 10:00.

10. Në datën 9.1.2024 u zhvillua seanca e dytë dëgjimore në prani të subjektit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

11. Në datën 10.1.2024, ora 10:00, u shpall vendimi përfundimtar.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

12. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

13. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

14. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr.

84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

15. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga AKSIK-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja dhe dokumentet shkresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shkresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit dhe çdo informacion të marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinione të vëzhguesit të ONM-së sipas nenit 49, pikat 10-12 të ligjit.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

Vlerësimi i pasurisë

16. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 25.1.2017, pra në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, z. Valentin Preçi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, kur ka dorëzuar deklaratën përpara fillimit të detyrës (në vijim DPF) me nr. indeksi *** dhe në vijim ka dorëzuar rregullisht deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV).

17. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Valentin Preçi ka konstatuar se: (a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (ç) nuk ka kryer deklarim të rremë; (d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

18. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Valentin Preçi, si dhe të personave të lidhur me të.

19. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur në deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV) dhe në deklaratën *Vetting*; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*

20. Apartament me sip. 84.54 m² dhe garazh me sip. 14 m², me çmim total blerjeje 50.000 euro – apartamenti me nr. pasurie ***, z. k. *** dhe garazhi me nr. pasurie ***, z. k. ***, me

adresë rruga “****”, pall. ***, shk. ***, ap. ***, ***, Tiranë. Kjo pasuri është porositur me anën e kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.1.2008. Burimi i krijimit: kredi hipotekore dhe konsumatore, e para me vlerë 24.500 euro, sipas kontratës së huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.3.2008 dhe e dyta me vlerë 5.500 euro, sipas kontratës së huas datë 12.3.2008 të marrë nga Emporiki Bank, sot e njohur si ABI Bank. Diferenca 20.000 euro është paguar nga kursimet e familjes me para në dorë, e ndarë në 3 këste (respektivisht 10.000 euro në vitin 2008, 5.000 euro në vitin 2011 dhe 5.000 euro në vitin 2014). Subjekti është shprehur se: “*Shuma 5.000 euro e shlyer në vitin 2011 është paguar për llogarinë time nga kunati im L. D., i është shlyer atij prej meje me anë të kursimeve të familjes në vitin 2012*”. Vlera e asetit: 50.000 euro. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi i Komisionit në lidhje me mënyrën e përfitimit të pasurisë

21. Nga deklaratimet e subjektit rezultoi se:

- Në DPV-në për vitin 2008, subjekti ka deklaruar si adresë banimi/regjistrimi në gjendjen civile këtë apartament. Gjithashtu, në seksionin “Ndryshim të interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar apartamentin me sip. ndërtimi 90.8 m², S., Tiranë, me kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.1.2009, e pahipotekuar, në shumën 50.000 euro, me pjesë 100%. Burimi: 2 kredi në Emporiki Bank në shumën totale 30.000 euro + 1.250.000 lekë nga gjendja *cash* e deklaruar më parë, konvertuar në euro. Shlyer firmës ndërtuese deri më 31.12.2008 shuma 40.000 euro dhe detyrim i mbetur ndaj firmës në shumën 10.000 euro.

- Në DPV-në për vitet 2009 dhe 2010, subjekti nuk ka deklaruar ndryshime në lidhje me këtë pasuri, përveç detyrimeve financiare ndaj Emporiki Bank për kreditë e marra në vitin 2008.

- Në DPV-në për vitin 2011, subjekti ka deklaruar ndër të tjera “...shlyer detyrim ndaj firmës së ndërtimit “G. C.” në shumën 5.000 euro me mandatarkëtimin nr. ***, datë 25.8.2011 (detyrim i mbetur shuma 5.000 euro)...”.

- Në DPV-në për vitin 2014, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, regjistrimin në ZVRPP Tiranë, në datën 30.9.2014, të pasurive të llojit “apartament” dhe “garazh”, si dhe likuiduar pjesa e mbetur nga detyrimi ndaj shoqërisë ndërtimore në vlerën 5.000 euro.

22. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

22.1. ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2018, ka konfirmuar se në emër të shtetasit Valentin Preçi figurojnë të regjistruara: (i) pasuria nr. *** – G***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit “garazh” me sip. 14 m²; (ii) pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit “apartament”, me sip. 84.54 m². Bashkëlidhur janë paraqitur ndër të tjera:

- Kartelat e pasurive.

- Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.9.2014, për apartamentin me nr. pasurie ***, me sip. 84.54 m² (së bashku me ambientet e përbashkëta është 90.8 m²) dhe garazh me nr. pasurie ***-G***, me sip. 14.0 m². Në total, apartamenti dhe garazhi me çmim 50.000 euro (45.000 apartamenti + 5.000 euro garazhi).

- Dy certifikata për vërtetim pronësie të lëshuara në emër të shoqërisë “G. C” sh.p.k. me datë 19.9.2014: (a) për pasurinë “apartament” me sip. 84.54 m², nr. pasurie ***; (b) për pasurinë “garazh” me sip. 14 m², nr. pasurie ***, lëshuar në datën 19.8.2014.

- Kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.1.2008, midis shoqërisë “G. C” sh.p.k. dhe subjektit Valentin Preçi.

- Vërtetim datë 26.9.2014, lëshuar nga shoqëria “G. C” sh.p.k., për shlyerjen e vlerës së plotë të detyrimit kontraktor prej 50.000 euro, si dhe vlerën e kontratave të furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, shoqëruar me dokumentacionin ligjor të shoqërisë.

22.2. Nga informacioni i përcjellë nga noteri A. M.¹ u evidentuan kontrata e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.1.2008 dhe kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.9.2014, të cilat kanë të njëjtat palë nënshkruese, të njëjtin çmim, si dhe mënyrë likuidimi.

22.3. U administruan të dhëna nga FSHU-ja², sipas të cilave kontrata për energji elektrike me numër *** në emër të subjektit për këtë objekt është lidhur në datën 16.1.2008.

22.4. Komisioni ka kërkuar informacion edhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me çështje penale të hetuara me shoqërinë “G. C” sh.p.k. apo ortakun (ët)/administratorin(ët)/përfaqësuesin e administratorit për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet³ nuk ka rezultuar ndonjë situatë e tillë.

22.5. Për sa më sipër, është vërtetuar përfitimi i pasurisë nga subjekti në mënyrë të ligjshme, si vijon:

- Referuar kontratës së sipërmarrjes datë 31.1.2008, subjekti i rivlerësimit ka porositur tek shoqëria ndërtimore “G. C” sh.p.k. apartamentin me nr. *** (2+1) me sip. 90.8 m², në katin e tretë dhe një vendparkim me nr. ***, në katin nëntokë, kundrejt shumës 50.000 euro.

- Me kontratë shitjeje datë 29.9.2014, subjekti ka blerë nga shitësi shoqëria “G. C” sh.p.k. apartamentin nr. ***, me sip. 84.54 m² dhe garazhin me sip. 14 m², kundrejt çmimit 50.000 euro (45.000 euro apartamenti dhe 5.000 euro garazhi), shumë e cila është likuiduar më parë në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 31.1.2008 dhe pa asnjë pretendim nga palët, pranuar edhe me vërtetimin datë 26.9.2014, lëshuar nga shoqëria “G. C” sh.p.k.⁴.

Në lidhje me çmimin e blerjes, kohën e pagesës, burimin e të ardhurave dhe mundësinë financiare për blerjen e pasurisë

23. Në referencë të dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti në dosjen *Vetting*, në kartelën e pasurisë së paluajtshme të llojit apartament, shuma e paguar rezulton 50.000 euro, dhe në kartelën e pasurisë së llojit garazh në emër të subjektit të rivlerësimit shuma e paguar rezulton 5.000 euro, pra në total 55.000 euro, ndërsa në kontratën e shitjes në total apartamenti dhe garazhi janë në çmimin 50.000 euro (45.000 euro apartamenti dhe 5.000 euro garazhi). Siç vërehet, ka një mospërputhje në çmimin e shitjes së pasurisë. Gjithashtu, ka mospërputhje të numrit të apartamentit të porositur në kontratën e sipërmarrjes me atë në kontratën e shitjes dhe në certifikatën për vërtetim pronësie. Ndonëse Komisioni nuk kishte ngritur dyshime në lidhje me këto mospërputhje dhe, për këtë arsye, subjektit nuk i janë kërkuar sqarime me njoftimin e rezultateve të hetimit, në parashtrimet e veta ai ka dhënë shpjegime (shihni paragrafët 20 dhe 21 të parashtrimeve), nëpërmjet të cilave ka argumentuar bindshëm shkaqet e këtyre pasaktësive.

23.1. Sa i takon mënyrës së likuidimit të çmimit të shitjes, nga aktet rezultoi se:

- Në bazë të nenit 3 të kontratës së sipërmarrjes datë 31.1.2008, lidhur ndërmjet shoqërisë “G. C” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit, është parashikuar që çmimi i blerjes së apartamentit dhe garazhit prej 50.000 euro të paguhej me këste, konkretisht: (i) këstin I, në shumën 5.000 euro, do ta likuideojë me lidhjen e kontratës; (ii) këstin II, në shumën 35.000 euro, do ta likuideojë me marrjen e kredisë në Emporiki Bank, brenda 1 muaji nga nënshkrimi i kësaj kontrate; (iii) këstin III, në shumën 10.000 euro, do ta likuideojë në fund me nënshkrimin e kontratës së shitjes.

- Referuar DPV-së rezultoi se në vitin 2008 është deklaruar se është paguar shuma 40.000 euro dhe është deklaruar detyrimi financiar prej 10.000 euro shoqërisë ndërtimore. Në DPV-në për

¹ Shkresë kthim përgjigje, administruar në Komision me nr. *** prot., datë 17.11.2022.

² Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.7.2020.

³ Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.12.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁴ Subjekti ka bashkëlidhur edhe mandatarkëtimin nr. ***, datë 25.8.2011, ku shtetasi L. D. ka paguar shumën 5.000 euro, me përshkrimin “Likuidim pjesor të kontratës së apartamentit Valentin Preçi”.

vitet 2009 dhe 2010, subjekti nuk deklaroi detyrime financiare ndaj shoqërisë së ndërtimit. Në DPV-në për vitin 2011 ka deklaruar pagesë të shumës prej 5.000 euro nga kunati i tij, shtetasi L. D. dhe në DPV-në e vitit 2014 ka deklaruar shlyerje edhe të shumës prej 5.000 euro.

- Nga të dhënat e ABI Bank, në datën 10.4.2008 është transferuar në llogari të shoqërisë “G. C” sh.p.k. shuma 24.500 euro për blerje apartamenti sipas kontratës nr. ***.

- Subjekti ka depozituar në dosjen *Vetting* mandatarkëtimin nr. ***, datë 25.8.2011, të shoqërisë “G. C” sh.p.k., me përshkrimin “Arkëtuar nga Valentin Preçi të shumës 5.000 euro”. Gjithashtu, me vërtetimin datë 26.9.2014, shoqëria “G. C” sh.p.k. vërtetoi se porositësi ka shlyer vlerën e plotë të detyrimit kontraktor prej 50.000 euro të kontratës së sipërmarrjes së datës 31.1.2008.

- Në pyetësit nr. 2, subjekti i rivlerësimit në lidhje me shlyerjen e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit, në vlerën 5.000 euro, ka deklaruar ndër të tjera se: “... Shuma pesë mijë euro është paguar prej meje cash pak ditë përpara nënshkrimit të kontratës së shitjes, datë 29.9.2014, konkretisht është paguar më datë 26.9.2014...”. Subjekti ka paraqitur bashkëlidhur “Shkresë përcjellëse”, datë 13.12.2022, të shoqërisë ndërtuese, e cila ka konfirmuar pagesën e shumës 5.000 euro në datën 26.9.2014 nga z. Valentin Preçi, por nuk ka paraqitur asnjë dokument, si faturë, mandat, dokument bankar, për të provuar në kohë dhe vlerë veprimin/transaksionin financiar (mandatarkëtimi i paraqitur i përket datës 25.8.2011, paguar nga z. L. D.).

23.2. Bazuar në sa më sipër, në pamundësi të marrjes së informacionit të plotë për kohën e pagesës së kësteve të çmimit të blerjes së kësaj pasurie nga shoqëria ndërtuese “G. C” sh.p.k., pasi referuar ekstraktit historik të regjistrit tregtar të të dhënave të tatimpaguesit (faqja *online* e QKB-së) rezultoi se kjo shoqëri ka statusin “pezulluar”, Komisioni vlerësoi që shuma prej 40.000 euro të pasqyrohet në analizën paraprake financiare si e paguar në vitin 2008, ndërsa për sa i përket shumës 10.000 euro të pasqyrohet e shlyer në vitet 2011 dhe 2014.

Analizë e burimit të deklaruar të të ardhurave dhe mundësisë financiare

24. Nga deklarimet e subjektit u konstatua se:

- Në DPV-në për vitin 2008, subjekti ka deklaruar si burim për pagesat e kryera për çmimin e blerjes së këtyre pasurive në këtë vit: 2 kredi në Emporiki Bank në shumën totale 30.000 euro + 1.250.000 lekë nga gjendja *cash* e deklaruar më parë, konvertuar në euro.

- Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim: (i) kredi hipotekore dhe konsumatore, e para me vlerë 24.500 euro sipas kontratës së huas me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.3.2008, dhe e dyta me vlerë 5.500 euro, sipas kontratës së huas datë 12.3.2008, të marra nga Emporiki Bank; (ii) diferencën prej 20.000 euro, paguar me para në dorë, e ndarë në 3 këste (respektivisht 10.000 euro në 2008, 5.000 euro në vitin 2011, 5.000 euro në vitin 2014, nga kursimet e familjes. Subjekti është shprehur: “Shuma prej 5.000 euro e shlyer në vitin 2011 është paguar për llogarinë time nga kunati im L. D. dhe i është shlyer atij prej meje me anë të kursimeve të familjes në vitin 2012”.

- Në pyetësit nr. 2, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me burimin e të ardhurave për shlyerjen e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit në vlerën 5.000 euro në vitin 2014, ka deklaruar ndër të tjera se: “...Burimi i të ardhurave, me sa kujtoj, për këtë shumë, ka qenë gjendja *cash* e disponuar, shtuar me kursimet e vitit deri në momentin e likuidimit të pagesës së këtij kësti...”

Analizë e burimit të të ardhurave për pagesën e shumës 40.000 euro në vitin 2008

25. Nga Komisioni u analizuan specifikisht burimet e deklaruara si vijojnë:

25.1. Sa u takon kredive, u konstatua se: (i) me kontratën e huas datë 12.3.2008, Emporiki Bank i ka dhënë huamarrësit Valentin Preçi një hua në shumën 24.500 euro, me qëllim për t'u përdorur për blerjen e apartamentit me sip. 90.8 m², në përputhje me kontratën e sipërmarrjes datë 31.1.2008 me shoqërinë "G. C" sh.p.k.; (ii) me kontratë huaje datë 12.3.2008, Emporiki Bank i ka dhënë huamarrësit Valentin Preçi një hua në shumën 5.500 euro, me qëllim për t'u përdorur për blerje mobiliesh.

Në bazë të të dhënave nga ABI Bank, rezulton se në datën 31.3.2008 janë disbursuar në llogari të subjektit në këtë bankë dy kredite, përkatësisht në vlerat 24.500 euro dhe 5.500 euro. Në datën 10.4.2008 është transferuar në llogari të shoqërisë "G. C" sh.p.k. shuma 24.500 euro për blerje apartamenti sipas kontratës nr. ***, ndërsa shuma 4.950 euro është tërhequr *cash* nga subjekti në të njëjtën datë.

Subjekti është pyetur sërish në lidhje me kohën e pagesës së çmimit prej 40.000 euro, deklaruar i paguar në vitin 2008 për blerjen e apartamentit dhe garazhit në Selitë, Tiranë, dhe ka shpjeguar se: *"...sikundër rezulton nga deklaratimet e mia, si në DPV-në e vitit 2008, ashtu edhe në deklaratën Vetting, në datën 31.1.2008, kam lidhur kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 31.1.2008, me shoqërinë "G. C". Në këtë datë, pra 31.1.2008, sapo kam nënshkruar kontratën, kam paguar në arkën e shoqërisë shumën prej 5.000 euro. Këtë pagesë e kam kryer në cash, me burim kursimet e mia ndër vite. Në datën 10.4.2008 kam paguar në llogarinë bankare të shoqërisë shumën prej 24.500 euro nga llogaria ime në llogarinë e shoqërisë "G. C". Burimi i kësaj shume është kredia bankare e miratuar nga Banka Emporiki (sot ABI Bank) dhe, po në këtë datë, kam tërhequr cash shumën prej 4.950 euro nga kredia konsumatore e disbursuar nga Emporiki Bank (sot ABI Bank). Kësaj shume i kam shtuar 5.000 euro nga kursimet ndër vite, dhe 550 euro nga kursimet e mia të atij viti (janar 2008 – prill 2008), dhe në total shkon në vlerën prej 10.500 euro. Këtë shumë brenda ditës e kam arkëtuar cash pranë shoqërisë "G. C..."*

Subjekti ka bashkëlidhur edhe vërtetimin datë 11.10.2023 nga shoqëria "G. C" sh.p.k., si dhe dokumentin e quajtur kartelë llogarie të kësaj shoqërie.

25.2. Në lidhje me deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar në përgjigje të pyetësorit nr. 3, përcjellë nga shoqëria ndërtuese, në përfundim të hetimit paraparak Komisioni vlerësoi se duket se ato nuk arrijnë të japin një paraqitje të qartë të: (i) veprimeve/ngjarjeve financiare dhe veprimeve kontabël të shoqërisë në vitin 2008⁵, të finalizuara në pasqyrat financiare dhe shpjegimet përkatëse të depozituara në organin tatimor; (ii) destinacionit të shumës 4.950 euro të tërhequr *cash* në datën 10.4.2008 nga Emporiki Bank, krahasuar me transfertën bankare të kryer në të njëjtën ditë për këtë shoqëri; (iii) po kështu, subjekti nuk ka arritur të sqarojë se përse shuma 4.950 euro, e përfituar nga kredia për mobilim, nuk i kaloi me transfertë shoqërisë ndërtuese, bashkë me vlerën 24.500 euro të transferuar në të njëjtën ditë.

25.3. Sa më sipër, në referencë të fakteve dhe dokumentacionit të kohës (kontratë huaje shoqëruar me tërheqje *cash* të shumës së huas bankare, e cila duket se mbështet faktin se qëllimi i kësaj huaje nuk ka qenë pagesa për shoqërinë ndërtuese), kohës së deklaruar të fillimit të banimit në këtë apartament nga subjekti (maj 2008), si dhe jurisprudencës së Kolegjit⁶, nga Komisioni vlerësohet që shuma prej 4950 euro, e tërhequr *cash* në datën 10.4.2008, me burim kontratën e huas/kredisë konsumatore datë 12.3.2008, të pasqyrohet si shpenzim për blerje

⁵ Referuar nenit 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, ku përcaktohet se: *"1. Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Evidenca mbështetëse mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore, të përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji. 2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes"*.

⁶ Vendim nr. 34/2019, paragrafi 74.

mobiliesh, sikurse ka qenë dhe parashikimi në kontratën e kredisë “për t’u përdorur për blerje mobiliesh”.

25.4. Sa i takon burimit “Gjendje *cash* e deklaruar më parë (kursime)”, u konstatua se:

- Në lidhje me këtë burim të deklaruar, Komisioni shqyrtoi deklaramet e subjektit pranë ILDKPKI-së për periudhën 2003 – 2008, duke analizuar mundësinë financiare të tij dhe bashkëshortes për krijimin e kursimeve të deklaruara. Konkretisht, referuar deklaramit për herë të parë dhe DPV-ve, subjekti i ka deklaruar këto kursime si gjendje *cash* në banesë:

- Në deklaratën e interesave privatë për herë të parë në datën 15.3.2004 dhe në DPV-në e vitit 2004, subjekti nuk ka deklaruar likuiditete kursime *cash*.

- Në DPV-në për vitin 2005, subjekti ka deklaruar: “*Gjendje cash në shumën 200.000 lekë të përfituar nga kursimet e pagës*”.

- Në DPV-në për vitin 2006, subjekti nuk ka deklaruar shtesa/pakësim/gjendje likuiditetesh *cash*. Në këtë deklaratë, në seksionin “Deklarim i interesave privatë - pasuritë e paluajtshme, të luajtshme”, subjekti në kolonën e dytë “Vlera e secilës pasuri, shtuar ose pakësuar në lekë apo në valutë në momentin e veprimit” ka deklaruar “*500.000 lekë gjendje cash*”.

Sa më sipër, duket i paqartë deklarimi i bërë nga subjekti në lidhje me gjendjet *cash* në banesë, në datën 31.12.2006.

- Në DPV-në për vitin 2007, subjekti ka deklaruar shtuar gjendje *cash* nga të ardhurat e përfituara nga paga për vitin 2007, në shumën 700.000 lekë.

- Në DPV-në për vitin 2008, subjekti ka deklaruar edhe: “*Pakësuar gjendja cash e deklaruar më parë në shumën 1.250.000 lekë*”; “*Gjendje cash në fund të vitit nga kursimet e të ardhurave familjare vjetore në shumën 400.000 lekë*”.

25.5. Nga vlerat e deklaruara nga subjekti dhe bashkëshortja në DPV, si kursime *cash* të krijuara në vitet përkatëse të deklaramit (pra, shtesë të likuiditeteve *cash*), shuma totale e likuiditeteve *cash* gjendje në banesë, në datën 31.12.2007, do të rezultonte në dukje në vlerën 1.400.000 lekë. Nga analiza paraprake financiare rezultoi se për vitet 2005, 2006 dhe 2007 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur duket se kanë pasur mundësi financiare për kursimin e vlerave të deklaruara në deklaramet e interesave periodikë privatë përkatës.

26. Në përfundim të hetimit administrativ nga Komisioni u krye një analizë paraprake financiare për vitin 2008, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për pagesën e shumës prej 40.000 euro si pjesë e çmimit të blerjes së apartamentit në S., Tiranë, kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara, si dhe shtesën në likuiditete *cash* të deklaruar në fund të vitit 2008, nga ku duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme të ardhurash për pagesën e shumës 40.000 euro, pjesë e çmimit të blerjes së apartamentit dhe garazhit në S., Tiranë, kursimin në likuiditete *cash*, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara (përfshirë edhe mobilimin) për vitin 2008 (balanca negative paraprake në vlerën -1.336.380 lekë). Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Komisioni vlerësoi që shuma e likuiditeteve *cash*, të deklaruara të kursyera gjatë vitit 2008 (në vlerën 400.000 lekë), të mos përfshihet në analizën financiare për pasuritë e krijuara më vonë, të cilat kanë si burim të deklaruar kursimet *cash* të mbartura gjatë viteve (përfshirë edhe këtë shumë).

Analizë e burimit të të ardhurave për pagesën e shumës 5.000 euro në vitin 2011 si kësht për blerjen e apartamentit dhe garazhit

27. Në DPV-në për vitin 2011, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ndër të tjera ka deklaruar: “*Huamarrje nga kunati në shumën 5.000 euro për shlyerje detyrimi ndaj firmës “G. C” me mandatarkëtimi nr. ***, datë 25.8.2011 (detyrim i mbetur 5.000 euro)*”. Ndërsa në të dhëna konfidenciale (dhurata dhe trajtime preferenciale), subjekti ka deklaruar: “*Detyrim kunatit L. D. në shumën 5.000 euro, i cili në datën 25.8.2011 ka arkëtuar për llogarinë time shlyerje detyrimi me mandatpagesë ndaj firmës së ndërtimit, së cilës i kam blerë apartamentin*”.

27.1. Në lidhje me burimin e të ardhurave të huadhënësit për pagesën e shumës prej 5.000 euro në vitin 2011, subjekti në përgjigjet e dhëna në ILDKPKI, në datën 9.3.2016, ka sqaruar se kunati L. D. ka jetuar dhe punuar në Greqi nga viti 2001 deri në vitin 2012, periudhë në të cilën ka siguruar dhe ka pasur mundësi financiare për të dhënë hua këtë shumë. Ndërsa në përgjigje të pyetësorit standard ka deklaruar ndër të tjera se: “*...kam marrë borxh nga kunati im, shtetasi L. D.. Ky shtetas në datën 25.8.2011 ka paguar shumën 5.000 euro si likuidim pjesor të kontratës së apartamentit të porositur në shoqërinë “G. C” sh.p.k, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 31.1.2008. Ky borxh është shlyer nga ana ime gjatë vitit 2012, duke i dhënë kunatit cash shumën prej 5.000 euro, edhe sipas deklarimit të kryer në DPV-në e këtij viti*”. Subjekti ka depozituar të dhëna nga regjistri kombëtar i të siguruarve në Kozanë, Greqi, për periudhën 1.9.2001 – 1.5.2011.

27.2. Referuar dokumentacionit të administruar, shuma e të ardhurave totale për këtë periudhë për shtetasin L. D. rezulton në vlerën rreth 60.700 euro. Ndërsa, nisur nga shpenzimet për jetesë për një person⁷ në vlerën rreth 57.000 euro, duket një mundësi kursimi e tij në vlerën rreth 3700 euro. Gjithashtu, në këtë dokumentacion evidentohet fakti se në tri vitet e fundit personi tjetër i lidhur nuk ka arritur me të ardhurat totale të dokumentuara të mbulojë shpenzimet e jetesës e, për rrjedhojë, nuk ka pasur mundësi kursimi. Po kështu, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Lezhë, me shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.1.2023, informon se shtetasi L. D. rezulton i siguruar për periudhën mars-maj 2016 në subjektin tregtar “F. P.”, regjistruar me NIPT ***, me të ardhura bruto të përfituara në vlerën totale 26.000 lekë.

27.3. Bazuar në sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni vlerësoi se pa marrë në konsideratë të ardhura të tjera të realizuara dhe/ose pasuri të krijuara apo shpenzime të kryera nga personi tjetër i lidhur, shtetasi L. D., duket se subjekti nuk ka arritur të dokumentojë burimin e ligjshëm të të ardhurave për shumën prej 5.000 euro, të paguar si huadhënie për këstin e çmimit të blerjes së apartamentit në datën 25.8.2011. Rrjedhimisht, kjo shumë nuk është pasqyruar si e ardhur në analizën paraprake financiare në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme. Për këtë arsye, Komisioni kreu analizën paraprake financiare për vitin 2011, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe të personit të lidhur për krijim të pasurive (përfshirë edhe shtesën në likuiditet *cash* në banesë), si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për këtë vit, nga e cila duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme të ardhurash për krijim pasurie, shtesën në likuiditet, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për vitin 2011 (balanca negative paraprake në vlerën -1.384.679 lekë). Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

27.4. Gjithashtu, Komisioni vlerësoi që shuma e likuiditeteve *cash* të deklaruara si shtesë në vitin 2011 (në shumën 2.000 USD) të mos përfshihet në analizën financiare për pasuritë e krijuara më vonë, që kanë si burim të deklaruar kursimet *cash* të mbartura gjatë viteve. Gjithashtu, në lidhje me shlyerjen e pretenduar të huas së deklaruar nga kunati i tij, Komisioni,

⁷ Minimumi jetik (në euro) sipas <http://www.statistics.gr/el/statistics/-/publication/SFA10/>

nisur nga fakti i mospërfshirjes në analizën paraprake financiare të huas në shumën 5.000 euro në vitin 2011, ka vlerësuar të mos pasqyrohet edhe shlyerja e saj, deklaruar në vitin 2012.

Analizë e burimit të të ardhurave për pagesën e shumës 5.000 euro në vitin 2014, si këst i fundit i çmimit të blerjes së apartamentit dhe garazhit

28. Në DPV-në për vitin 2014, në rubrikën “Ndryshim i pasurive”, subjekti ka deklaruar ndër të tjera: “Regjistruar në ZVRPP Tiranë, në datën 30.9.2014, apartamenti + garazhi, i porositur tek shoqëria “G. C” sh.p.k. (deklaruar më parë) dhe likuiduar pjesa e mbetur nga detyrimi i shoqërisë ndërtimore në vlerën 5.000 euro”. Gjithashtu, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar ndër të tjera “Shlyer detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit në vlerën 5.000 euro”.

28.1. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në lidhje me kohën e pagesës së këstit të fundit, subjekti ka deklaruar: “Shuma pesë mijë euro është paguar prej meje cash pak ditë përpara nënshkrimit të kontratës së shitjes datë 29.9.2014, konkretisht është paguar më 26.9.2014. Burimi i të ardhurave, me sa kujtoj, për këtë shumë, ka qenë gjendja cash e disponuar, shtuar me kursimet e vitit, deri në momentin e likuidimit të pagesës së këtij kësti”.

28.2. Nisur nga fakti që në DIPP-në e vitit 2014 subjekti nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për pagesën e shumës 5.000 euro në datën 26.9.2014, si dhe pakësim të gjendjes cash në banesë, Komisioni ka vlerësuar se analiza paraprake financiare për periudhën 1.1.2014 – 26.9.2014, për të evidentuar mundësinë financiare për pagesën e këtij kësti, të mos përfshijë të ardhurat cash të deklaruara/llogaritura të akumuluar deri në datën 31.12.2013. Analiza është me rezervë, pasi nuk u paraqit dokumentacion në lidhje me llogari bankare të subjektit dhe/ose personit të lidhur në SHBA. Shpenzimet e deklaruara për mobilim në vitin 2014⁸ nuk janë përfshirë (nuk ka të dhëna për kohën e kryerjes). Gjithashtu, shpenzimet për qira në SHBA janë pasqyruar referuar deklarimit të subjektit vetëm për muajin janar 2014.

28.3. Nga analiza paraprake financiare duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare nga burime të deklaruara të ardhurash për pagesën e këstit të fundit të çmimit të blerjes së apartamentit dhe garazhit në S., Tiranë, në vlerën 5.000 euro, në datën 26.9.2014, shtesën në likuiditet në bankë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën 1.1.2014 – 26.9.2014 (balanca negative paraprake në vlerën -93.965 lekë). Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit për secilën nga barrat e provës

29. Në parashtrimet e veta, subjekti ka bërë një analizë të detajuar të deklarimeve të tij ndër vite dhe gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe dokumenteve shkresore që kanë lidhje me blerjen e dy pasurive apartament dhe garazh, në çmimin 50.000 euro, për të cilat i ka kaluar barra e provës; duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për: (i) pagesën e shumës 40.000 euro në vitin 2008 (balanca negative paraprake në vlerën -1.336.380 lekë); (ii) pagesën e këstit 5.000 euro në vitin 2011 (balanca negative paraprake në vlerën -1.384.679 lekë); (iii) pagesën e këstit të fundit në vlerën 5.000 euro, në datën 26.9.2014 (balanca negative paraprake në vlerën -93.965 lekë).

29.1. Subjekti paraprakisht rikujton se ka deklaruar saktësisht në deklaratën *Vetting* burimin e ligjshëm të kësaj pasurie në këtë mënyrë: (i) *Kredi hipotekore dhe konsumatore, e para me vlerë 24.500 euro, sipas kontratës së huas me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.3.2008, si dhe e dyta me vlerë 5.500 euro, sipas kontratës së huas datë 12.3.2008, të marra nga Banka Emporiki, sot e njohur si ABI; (ii) Diferenca prej 20.000 euro është paguar me para në dorë,*

⁸ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1 janë deklaruar 50.000 lekë.

e ndarë në 3 këste (respektivisht 10.000 euro në 2008, 5.000 euro në vitin 2011, 5.000 euro në vitin 2014), nga kursimet e familjes; (iii) Shuma prej 5.000 euro e shlyer në vitin 2011 është paguar për llogarinë time nga kunati im L. D. dhe i është shlyer atij prej meje me anë të kursimeve të familjes në vitin 2012. Vlera e asetit: 50.000 euro. Pjesa takuese: 100%”.

Në lidhje me balancën negative të vitit 2008

30. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se subjekti ka argumentuar bindshëm të kundërtën e konstatimeve të Komisionit në lidhje me mundësinë financiare të pagesës 40.000 euro dhe balancën negative të rezultuar paraprakisht për vitin 2008. Duke trajtuar në mënyrë të përmbledhur deklaratimet e subjektit, Komisioni arsyeton se:

a. Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar apartamentin me sip. ndërtimi 90.8 m², Selitë, Tiranë, prenotuar sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.1.2008, e pahipotekuar, në shumën 50.000 euro, me pjesë takuese 100%. Si burim krijimi ka deklaruar 2 kredi në Emporiki Bank në shumën totale 30.000 euro + 1.250.000 lekë, nga gjendja *cash* e deklaruar më parë, e konvertuar në euro. Firmës ndërtuese deri më 31.12.2008 i është shlyer shuma 40.000 euro dhe detyrimi i mbetur ishte 10.000 euro. Në DIPP-të e viteve 2009 dhe 2010, në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, subjekti nuk ka deklaruar detyrimin ndaj shoqërisë “G. C” sh.p.k., por në DPV-në për vitin 2011 ka deklaruar pagesë të shumës 5.000 euro nga kunati i tij, shtetasi L. D. dhe në DPV-në e vitit 2014 ka deklaruar shlyerje edhe të shumës 5.000 euro.

b. Sa i takon mënyrës së likuidimit të shumës 40.000 euro, është vërtetuar se:

- Shuma 5.000 euro është paguar ditën e nënshkrimit të kontratës, pra më 31.1.2008, në arkën e shoqërisë, sikundër përcaktohej edhe në nenin 3 të kontratës, me burim kursimet ndër vite. Kjo pagesë është konfirmuar edhe nga shoqëria “G. C” sh.p.k. sipas vërtetimit të datës 11.10.2023.

- Në datën 10.4.2008, nëpërmjet transfertës bankare është paguar në llogarinë e shoqërisë shuma prej 24.500 eurosh, siguruar nëpërmjet kontratës së kredisë hipotekore.

- Po në këtë datë, me qëllim pagimin e këstit të apartamentit, subjekti ka tërhequr pranë bankës shumën prej 4950 euro, të miratuar nga kredia konsumatore e disbursuar nga Emporiki Bank (sot ABI Bank) dhe e ka derdhur atë në arkën e shoqërisë.

- Subjekti ka deklaruar: *“Shumave të mësipërme u kam shtuar gjithashtu vlerën 5.000 euro nga kursimet ndër vite dhe 550 euro nga kursimet e mia të atij viti dhe, në total, vlera e saj shkoj 10.500 euro. Këtë shumë brenda ditës e kam arkëtuar cash pranë shoqërisë “G. C”. Pra, në total, pagesa e tyre shkon në vlerën 35.000 euro, vlerë e cila përputhet qartësisht me modalitetet e kësteve të pagesës të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes të datës 31.1.2008”.* Deklarimet e subjektit në çdo rast janë në koherencë të plotë me provat shkresore të administruara dhe deklaratimet e mëparshme të tij.

c. Me të drejtë subjekti vijon të këmbëngulë se si në DPV-në e vitit 2008, ashtu dhe në deklaratën *Vetting*, dokumente këto që konsiderohen si prova bazuar në ligjin nr. 84/2016, neni 32, pika 5, ka deklaruar se si burim për prenotimin e apartamentit kanë shërbyer dy kreditë e marra në Emporiki Bank (dhe pakësimin e kursimeve *cash*), si dhe argumenton logjikshëm faktin përse nuk ka marrë kredi në shumën totale 35.000 euro, sikurse ishte përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes me qëllim pagimin e këstit në këtë vlerë, por ka marrë dy kredi në vlerën 30.000 euro. Konkretisht, subjekti parashtron se: *“Në kushtet kur, bazuar në nenin 3 të kontratës së sipërmarrjes së datës 31.1.2008 duhej të paguaja si këst të dytë vlerën prej 35.000 euro (ndërkohë që banka, për shkak të vlerësimit të kolateralit, më miratoi vetëm shumën*

30.000 euro, e ndarë në dy lloje kredish – hipotekore dhe konsumatore), më 10.4.2008, nëpërmjet transfertës bankare, kam paguar në llogarinë e shoqërisë shumë prej 24.500 euro.

- Dy kreditë janë marrë në të njëjtën datë, një kredi hipotekore dhe tjetra kredi konsumatore. Kontratat e kredisë mbajnë numër repertori dhe koleksioni të njëpasnjëshëm midis tyre dhe janë disbursuar në llogarinë time në të njëjtën datë. Vlera e kredive ka qenë për kredinë hipotekore 24.500 euro dhe për kredinë konsumatore 5.500 euro, për të plotësuar të dyja së bashku shumë 30.000 euro të kërkuar nga unë për financimin e blerjes së apartamentit. Vlerat e dy kredive kanë plotësuar njëra-tjetrën, për të pasur si financim vlerën totale 30.000 euro.

- Pra, qëllimi i marrjes së kredive ka qenë vetëm një, për shlyerjen e vlerës së apartamentit sipas kontratës së sipërmarrjes. Pamundësia për të marrë kredi për apartamentin në një shumë të vetme, më detyroi të plotësoja vlerën me kredi konsumatore. Nëse do të kisha pasur mundësi të merrja kredi hipotekore në shumë 30.000 euro, do të kisha marrë këtë shumë dhe jo shumë 24.500 euro. Nuk ka logjikë ekonomike se pse duhet të merrja kredi konsumatore me një normë më të lartë interesi, të paguaja dy këste të ndryshme, nëse do të kisha pasur mundësi të kreditohesha në një shumë të vetme prej 30.000 euro. Në këtë mënyrë, sipas versionit të përgatitur nga Komisioni se 4950 euro të kredisë së disbursuar 5,500 euro janë përdorur për arredim, do të kisha mundësi të përballoja koston e arredimit me kursimet në cash dhe pagesën e apartamentit ta përballoja me kredinë 30.000 euro.

- Nëse kreditë do të kishin qëllime të ndryshme përdorimi, së pari nuk do të ishin nënshkruar në të njëjtën datë, pasi nevoja për shlyerjen e shoqërisë së ndërtimit prevalonte përpara nevojës hipotetike të “mobilimit të shtëpisë”. Gjithashtu, fakti i marrjes së dy kredive vërteton qartësisht se unë kam pasur vështirësi në kreditimin e një shume të vetme. Nuk kishte arsye pse unë duhet të merrja kredi konsumatore nëse do të isha financuar nga banka për prenotimin e apartamentit në shumë 30.000 euro. Në këtë mënyrë do të kisha të gjitha mundësitë financiare të përballoja shpenzimet e tjera, qoftë dhe për mobilim me kursimet në cash.

- Plani i pagesave i përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes tregon se kësti i dytë prej 35.000 euro do të likuidohej me marrjen e kredisë bankare pranë Emporiki Bank. Prej momentit të lidhjes së kontratës së sipërmarrjes kam pasur qëllim të financohesha me 35.000 euro kredi dhe jo 30.000 euro, sikundër mora, pasi mendoja të ruaja kursimet në cash. Por kushtet e bankës kërkonin që duhet të paguaja me vetëfinancim më shumë se 5.000 euro, për këtë arsye kam kërkuar financim në shumë 30.000 euro, duke paguar me vetëfinancim shumë 10.000 euro”.

ç. Duke iu referuar modaliteteve të pagesës sipas nenit 3 të kontratës së sipërmarrjes: “Kësti i parë prej 5.000 euro do të likuidohej në momentin e nënshkrimit të kontratës. Kësti i dytë prej 35.000 euro do të likuidohej brenda një muaji nga momenti i nënshkrimit të kontratës së kredisë me Emporiki Bank. Kësti i tretë prej 10.000 euro do të likuidohej në fund të nënshkrimit të kontratës së shitjes...”, subjekti argumenton gjerësisht arsyet përse shumë 10.500 euro e ka paguar cash, duke iu referuar orientimit që ka pasur nga specialisti i bankës, i cili i bëri me dije se transferimi i shumës 4950 euro, përfituar me kredi konsumatore, nuk mund të kryhet nga ai (subjekti) drejtpërdrejt nga llogaria e tij në llogarinë e shoqërisë, pasi kjo kontratë huaje kishte për objekt financimin për mobilim dhe banka nuk do mund të transferonte dot këtë shumë në llogari të shoqërisë me këtë përshkrim. Për këtë arsye, subjekti deklaroi se: “M’u sugjerua që shumë ta tërheq nga llogaria bankare ku ishte transferuar, për të paguar pjesë të mbetur të këstit të pagesës për shoqërinë ndërtuese, të kryer cash në arkën e saj, sikurse vërtetohet edhe nga “kartela e llogarisë kontabël”, e cila evidenton datën e pagesës dhe mandatarkëtimet e mbajtura nga shoqëria...”. Më tej, subjekti deklaroi se: “...pranë Emporiki Bank unë kam kërkuar të plotësoja/shtoja gjendjen e llogarisë me dy shumat e disbursuara, duke shtuar shumë 5.000 euro, që kishte burim kursimet në cash, për të pasur mundësi të transferoja

drejtpërdrejt në llogarinë e shoqërisë shumë 35.000 euro sipas parashikimeve kontraktuale. I detyruar të pranoja orientimin e bankës, kam vepruar sipas këtyre kufizimeve...”.

Po kështu, në mënyrë të arsyeshme i referohet faktit se pagimi *cash* i çmimeve të kontratave të shitblerjes nuk ka qenë një fenomen i pazakontë në shoqërinë shqiptare dhe se një pjesë e madhe e kontratave të sipërmarrjes, që kanë qenë objekt i hetimit të pasurisë për subjekte të caktuara rivlerësimi, kanë pasur një mënyrë të ngjashme të kryerjes së pagesave kundrejt shoqërive sipërmarrëse, pra nëpërmjet kryerjes *cash* të pagesave.

d. Subjekti me të drejtë kundërshton vlerësimin e Komisionit që shuma prej 4.950 euro të pasqyrohet në analizë për blerje mobiliesh, duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjit me vendimin nr. 34/2019, paragrafi 74. Në vijim, subjekti parashtron arsyet përse rrethanat e tij nuk përputhen me rastin e vendimit nr. 34 (JR)/2019 të Kolegjit që Komisioni i është referuar, pasi: *“Në rastin e subjektit E. P., pagesat lidheshin me situacione punimi që domosdoshmërisht kërkojnë lëshimin e faturave tatimore dhe dokumentacionit përkatës justifikues ekonomiko-ligjor (sikurse do trajtoj në vijim, paragrafi nr. 34 e vijues të këtyre parashtrimeve), ndërsa, në rastin konkret, shuma e kredisë bankare që u tërhoq nga ana ime, shërbeu posaçërisht për plotësimin e shumës së mbetur të këstit të pagesës, e cila iu bashkua shumës së kredisë së parë hipotekore që më ishte akorduar nga Banka, me qëllim që të respektoja modalitetet dhe planet e kësteve të pagesave të kontratës së sipërmarrjes, në respektim të nenit 3 të kësaj kontrate, dhe kjo s’mund të ketë asnjë dyshim për sa kohë e kam pasur detyrim kontraktor të asaj periudhe”.*

Po kështu, subjekti i referohet një rasti të trajtuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, i cili ka mbajtur qëndrim në rastin e ndryshimit të përdorimit dhe destinacionit të kredisë. Në vendimin nr. 35/2022 për subjektin e rivlerësimit E. Sh.⁹, përdorimi i kredive të marra nga Fondacioni B., të cilat kishin objekt financimi për aktivitet privat, kishin shërbyer si burim krijimi për ndërtimin e objektit për subjektin e rivlerësimit E. Sh. dhe personin e lidhur. Për këto arsye, subjekti kërkon që të përfshijë tërheqjen e shumës 4.950 euro si pjesë të pagesës së kryer *cash* në shumën 10.500 euro, në datën 10.4.2008, duke shlyer dy këstet e përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes, për të cilat ishte rënë dakord me shoqërinë e ndërtimit.

dh. Subjekti kundërshton konstatimin e Komisionit se referuar nenit 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar¹⁰, shkresa e paraqitur nga

⁹ Paragrafët 39, 42 dhe 57.

Komisioni nuk u bind me shpjegimet e dhëna nga subjekti në lidhje me përdorimin e kredive për ndërtimin e shtëpisë, pasi qëllimi i marrjes së tyre ishte për biznes. Kontratat e kredive, nënshkruar nga subjekti dhe bashkëshorti, janë akte ligjore referuar nenit 690 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të cilat kanë fuqinë e ligjit për palët. Në objektin e kontratave dhe në aktet bashkëlidhur përcaktohet qartësisht qëllimi i marrjes së këtyre kredive për aktivitet tregtar...Ndërkohë që, sa i takon konkluzionin për deklaram të pamjaftueshëm të kësaj pasurie në drejtim të mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e saj, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar analizën financiare të Komisionit të kryer për këtë qëllim, në drejtim të: (i) vlerësimit të kredive të marra pranë Fondacionit B. në vitet 2000 – 2001; subjekti pretendoi se përdorimin e kredive të marra nga Fondacioni B. e ka deklaruar si burim për ndërtimin e banesës 3-katëshe në deklaratat periodike vjetore (në vijim DIPPV) të viteve 2003 dhe 2004, dhe kërkoi nga Kolegji që këto deklarime periodike t’i vlerësojë si provë. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, argumentoi si provë të faktit që kreditë e marra për arsye biznesi nga bashkëshorti i saj janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve të ndërtimit, përbëjnë edhe të dhënat e bilancit të personit fizik F. Sh., me NIPT {***}. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjyqësor i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. E. Sh., lidhur me përdorimin e kredive të marra prej saj dhe personit të lidhur me të, z. F. Sh. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) pranë Fondacionit B në vitet 2000 dhe 2001, në vlerën totale 1.800.000 lekë, si burim për financimin e punimeve të ndërtimit të pasurisë objekt kontrolli. Për rrjedhojë, trupi gjyqësor e gjeti të pabazuar konkluzionin e Komisionit për mosvlerësimin si burim të ligjshëm për krijimin e pasurisë objekt kontrolli të vlerës prej 1.800.000 lekësh të përfutur nga kreditë e marra pranë Fondacionit B. në vitet 2000 dhe 2001, duke mos i marrë në konsideratë këto vlera monetare si të hyra në analizën financiare të viteve respektive.

¹⁰ Në nenin 6 përcaktohet se: *“Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Evidenca mbështetëse mbahet si provë dokumentare gjatë*

shoqëria e titulluar “Kartela e llogarisë së klientit”, e cila vërteton pagimin *cash* të shumës 10.500 euro (nga të cilat 4.950 euro, përfituar me kredinë konsumatore) në arkën e shoqërisë, nuk jep një paraqitje të saktë të veprimeve/ngjarjeve financiare dhe veprimeve kontabël në vitin 2008. Kundërshtimet e tij subjekti i mbështet në argumentet si vijojnë:

- Kartela e llogarisë është dokument kontabël i paraqitur nga programi financiar i shoqërisë që mban datën e veprimit kontabël, si dhe datën e regjistrimit të veprimit në programin financiar.

- Shoqëria ka përdorur programin kontabël “Alpha”, program financiar që vazhdon të jetë edhe sot në treg duke u shërbyer klientëve¹¹.

- Kartela e llogarisë mban të dhëna kronologjike e të pamanipulueshme dhe në kartelë rezulton se veprimi kontabël i datës 31.1.2008 është regjistruar në programin e kontabilitetit në datën 18.2.2008. Gjithashtu, veprimet e datës 10.4.2008 janë regjistruar në kontabilitet në datën 29.4.2008. Kartela e llogarisë tregon të dhëna për datën e pagesës, numrin e mandatit, bankën nga është kryer veprimi, datën e veprimit, përshkrimin e veprimit, si dhe çdo të dhënë tjetër që gjendet në dokumentet kontabël, të cilat regjistrohen në programin financiar “Alpha”.

- Nëse i referohemi ligjit nr. 9228, në nenin 3 “Përkufizime” përcaktohet se:

1. *“Mbajtja e kontabilitetit” është regjistrimi në ditar dhe në llogari i të gjitha veprimeve dhe fakteve ekonomike, që i përkasin një njësie ekonomike.*

2. *“Sistem kontabël” është sistemi që përdoret për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarisë së një njësie ekonomike.*

3. *“Evidenca mbështetëse” është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar ose në bartës informatikë. a) dokumentet bazë përmbajnë regjistrimet fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik; b) dokumentet plotësuese janë bartës të informacionit të marrë nga dokumentet bazë; c) regjistrat (librat) kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve ekonomike të kryera, të marra nga dokumentet bazë ose dokumentet plotësuese.*

4. *“Bartësi informatik” është çdo dokument i evidencës mbështetëse, i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.*

- Baza ligjore e përdorur nga Komisioni, që i referohet nenit 6 të ligjit nr. 9228, tregon qartësisht se kartela e llogarisë e paraqitur nga shoqëria e ndërtimit është një provë e pakundërshtueshme. Neni 6 përcakton se regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse në formë informatike, sikundër është kartela e llogarisë, e cila krijon besueshmëri për shkak se programi financiar është i pamanipulueshëm, data e regjistrimit kontabël është data kur ky veprim është regjistruar në kontabilitet dhe që përbën një të dhënë të pamanipulueshme.

30.1. Bazuar në sa më sipër, Komisioni nuk mund dhe nuk ka asnjë arsye përse të konsiderojë informacionin e vënë në dispozicion nga shoqëria “G. C.” sh.p.k. si një akt shkresor pa vlerë provuese, sidomos në kushtet kur të dhënat e kësaj karteje përkrijnë me të dhëna të administruara gjatë procesit të rivlerësimit.

30.2. Në përfundim të procesit, Komisioni i çmoi bindëse pretendimet e subjektit të rivlerësimit si të bazuara në ligj dhe në prova. Për rrjedhojë, vlerësoi se pavarësisht se kredia e dytë formalisht është marrë me qëllim mobilimi, është vërtetuar se kjo kredi, pasi është tërhequr nga subjekti, është përdorur për pagimin e një pjese të çmimit të shitjes së pasurisë objekt

gjithë periudhës kohore, të përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji. 2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes”.

¹¹ Referojuni link-ut të shoqërisë IMB <https://imb.al/rreth-nesh>

verifikimi. Për më tepër, shuma e përfituar me kredinë e dytë në vlerën 5.000 euro është deklaruar si burim për blerjen e pasurisë në kohë reale, që në DPV-në e vitit 2008, e, në vijim, deklaratimet e subjektit janë koherente, në përputhje me njëra-tjetrën dhe dokumentet shkresore të administruara. Në analizën financiare të rishikuar, shuma 4950 euro u konsiderua si pagesë kësti për blerjen e apartamentit.

31. Sa i takon pretendimit se në analizën financiare për vitin 2008 duhet të përfshihen të ardhurat e deklaruara që lidhen me punësimin e bashkëshortes F. P., subjekti ka dhënë në mënyrë të detajuar parashtrime e argumente në lidhje me konsiderimin e këtyre të ardhurave si ligjore, duke iu referuar dokumenteve shkresore të administruara, disa dispozitave ligjore dhe qëndrimeve të mbajtura nga Kolegji.

31.1. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti ka parashtruar si vijon:

Së pari, fillimisht i referohet faktit që të ardhurat e bashkëshortes që janë krijuar nga punësimi pranë shoqërisë “P. C.” janë deklaruar që në momentin e parë kur bashkëshortja mori cilësinë e subjektit deklarues në kuptim të ligjit, dhe konkretisht që në DPV-në e vitit 2008, ku në rubrikën “Të ardhura dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private” ka deklaruar: “Paga e bashkëshortes sime si kryeredaktore e revistës “T.” 420.000 lekë” dhe, në vijim, në po të njëjtën rubrikë të DPV-në së vitit 2009, ka deklaruar lidhur me të ardhurat për periudhën 1.1.2009 – 1.7.2009 në shumën 300.000 lekë. Po kështu, në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura nga puna si gazetare dhe kryeredaktore e revistës “T.” me punëdhënësin A. R., me emër tregtar “P. C.”, në shumën 860.000 lekë, për periudhën 1.5.2007 – 1.7.2009. Si pjesë e dokumentacionit të dorëzuar në deklaratën *Vetting*, ka qenë dhe vërtetimi i marrë pranë shoqërisë, nëpërmjet të cilit është vërtetuar se për vitin 2007 janë përfituar të ardhura në shumën 140.000 lekë, për vitin 2008 në shumën 420.000 lekë dhe për vitin 2009 në shumën 300.000 lekë.

Së dyti, subjekti i referohet faktit që bashkëshortja ka qenë në cilësinë e dorëzueses në kreditë e marra në Emporiki Bank, duke plotësuar kushtin e përfitimit të të ardhurave në kohën e marrjes së kredive, vërtetuar me vërtetimin e datës 1.2.2008 [vërtetim ku është dhënë informacioni se paga e bashkëshortes ka qenë 50.000 lekë (bruto)]. Pra, sipas subjektit, bashkëshortja ka përfituar shumën 420.000 lekë neto, duke marrë në konsideratë edhe faktin se gjatë periudhës që ka qenë në SHBA, është shkëputur nga puna pa të drejtë page për këtë periudhë, fakt i vërtetuar me shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 15.11.2022, dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, e cila informon se në dosjen nr. *** dhe NIPT *** emri i bashkëshortes nuk figuron në listëpagesë për periudhën janar 2007 – dhjetor 2009.

Së treti, subjekti parashtron se pasi është njohur me hetimin e kryer nga Komisioni, është vënë në dijeni të faktit që shoqëria punëdhënëse nuk ka deklaruar si punonjëse bashkëshorten dhe nuk ka derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Subjekti argumenton se bashkëshortja e ka përfituar pagën *cash* duke iu referuar Kodit të Punës, që e lejonte pagesën e pagës *cash*, që është ndryshuar nëpërmjet ligjit nr. 136/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995”, në nenin 53 të të cilit normohet se paga jepet vetëm nëpërmjet sistemit bankar.

Së katërti, subjekti i referohet kërkesës me datë 23.11.2023, nëpërmjet së cilës i ka kërkuar informacion dhe dokumentacion justifikues ligjor shoqërisë për punësimin dhe pagesën e bashkëshortes. Me përgjigjen e datës 24.11.2023 është informuar se listëpagesat mujore janë përgatitur prej tyre në bazë të marrëdhënies së punës dakordësuar midis palëve. Listëpagesa në momentin e tërheqjes së pagës neto firmosej nga çdo punonjës, përfshirë dhe bashkëshorten. Pagesa e pagave neto është bërë *cash* në fillim të çdo muaji për pagën neto të muajit paraardhës. Bazuar në ligjin nr. 9228/2004, neni 17, afati maksimal për ruajtjen e dokumentacionit është 10 vjet, për këtë arsye shoqëria nuk disponon listëpagesat e tërheqjes së pagës neto të punonjësve të punësuar pranë shoqërisë. Ndër të tjera, subjekti deklaron se: “Unë kam pasur

bindjen dhe nuk mund të imagjinoja se bashkëshortja ime në funksionin e punës si kryeredaktore reviste, e cila kishte një tirazh të madh dhe shitje në atë kohë, të mos deklarohej si punonjëse në listëpagesë dhe të mos i mbaheshin si tatimi mbi të ardhurat personale, ashtu dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, duke rrezikuar (punëdhënësi) pasojat e këtij veprimi të njëanshëm në shkelje të ligjit nga ana e tij! Bashkëshortja, por edhe unë nuk kemi asnjë dyshim dhe asnjë mundësi objektive (për arsye se marrëdhënia e punës zgjati deri në fund të muajit qershor 2009) të viheshim në dijeni të këtij fakti...”. Subjekti ka paraqitur tri revista të ruajtura nga shoqëria, që u përkasin muajve korrik 2008, tetor 2008 dhe maj 2009. Në të tria revistat rezultoi se kryeredaktore e revistës është znj. F. P. dhe bashkëlidhur ka paraqitur aktin e ekspertimit teknik.

Së pesti, në lidhje me njohjen e të ardhurave nga pagat e bashkëshortes si të ardhura të ligjshme, subjekti parashtron se ligjvënësi ka normuar në disa dispozita të ligjeve të ndryshme të legjislacionit tatimor dhe fiskal detyrimin për pagesën e detyrimit tatimor nga të ardhurat nga paga, si dhe pagesën e sigurimeve shoqërore nga ana e punëdhënësit. Subjekti bën një analizë të hollësishme ligjore të këtij detyrimi, duke iu referuar konkretisht:

i) Nenit 13 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

ii) Ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në kohën e ekzistencës së marrëdhënies e punës së bashkëshortes, konkretisht nenit 6, të titulluar “Detyrimet e personave që paguajnë kontributet”, si dhe nenit 11 të tij, ku parashikohet se: “Kontributet në fondin e sigurimeve shëndetësore paguhen çdo muaj. Afati i pagimit të kontributeve është jo më vonë se data 25 e muajit pasardhës. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga kontributin për të punësuarin dhe ta derdhë atë së bashku me kontributin e vet në organet tatimore ose në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ose Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas rastit, është përgjegjës për transferimin e kontributeve në Institutin e Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor”.

iii) Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar në nenin 8/a;

iv) Udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, të ministrit të Financave “Për tatimin mbi të ardhurat”, i dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, ku në pikën 2.6.1 përcaktohet se: “Në zbatim të nenit 10, çdo punëdhënës që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në shkronjën “a” të nenit 8 të ligjit, është i detyruar të llogarisë dhe të mbajë në burim tatimin mbi të ardhurat personale (të ardhurat nga punësimi), në përputhje me paragrafin e parë të nenit 9 të ligjit. Tatimi i mbajtur nga punëdhënësi duhet të derdhet në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës. Deklarimi dhe pagesa e këtij tatimi do të bëhet duke përdorur deklaratën “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, që i bashkëngjitet udhëzimit të ministrit të Financave për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Kjo deklaratë, e cila është njëkohësisht edhe deklaratë për efekte të detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dorëzohet në administratën tatimore sipas mënyrës së parashikuar në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.” Më tej, në pikën 2.6.2, parashikon se: “Punëdhënësit detyrohen të bëjnë ndalesat në borderotë e pagave (listëpagesat) për efekt të tatimit mbi të ardhurat personale për pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me të ardhurat nga punësimi për çdo punonjës dhe llogaritja dhe mbajtja e tatimit pasqyrohen në formularët përkatës që i bashkëngjiten këtij udhëzimi dhe udhëzimit të ministrit të Financave në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar”.

Së gjashti, subjekti parashtron se në momentin që ka marrë dijëni për mungesën e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ai dhe bashkëshortja kanë kontaktuar menjëherë punëdhënësin, shtetasin A. R., duke i paraqitur këtë fakt, të cilin punëdhënësi e ka pranuar si të tillë, duke deklaruar se kështu ka vepruar për të gjithë punëmarrësit e tij dhe duke pohuar se nuk ka dokumentacion për periudhën e kërkuar, pasi kishte kaluar afati detyrues për ruajtjen e tyre. Subjekti pretendon se punëdhënësi, si agjent tatimor i detyruar nga ligji, në keqbesim nuk ka paguar shumat e ndalesave të kryera nga paga, ndërkohë që ai dhe bashkëshortja në çdo moment nuk kanë pasur dijëni në lidhje me këtë veprim të kryer prej tij.

Së shtati, subjekti u referohet disa vendimeve të Kolegjit, si vijojnë:

- Vendimit nr. 20, datë 14.7.2021: *“32. Trupi gjykues çmoi se sa më sipër përforcohet edhe nga fakti se pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme rezulton të jetë kryer nga vetë subjekti i rivlerësimit, znj. V. D., në dhjetor të vitit 2005. Ky fakt hedh poshtë gjithashtu edhe pretendimet e vetë subjektit të rivlerësimit se vlera prej 2.000.000 lekësh në kontratën e dytë të shitblerjes ka qenë një gabim i noterit, duke qenë se sipas saj përkonte me vlerën e këstit të dytë prej 1.000.000 lekësh dhe jo me çmimin e plotë të blerjes së pasurisë dhe se është nënshkruar prej saj në mirëbesim, rast ky në të cilin subjekti, i ndodhur në mirëbesim, do duhej të kishte paguar pranë ZVRPP-së vlerën e tatimit për çmimin e shitjes prej 4.500.000 lekësh, dhe jo atë sipas përcaktimit në kontratën e dytë noteriale, referuar të ardhurave nga shitja prej 2.000.000 lekësh. Pretendimet për pagesë të mëvonshme gjatë procesit të rivlerësimit të detyrimit tatimor, sipas vlerës së plotë të të ardhurave të realizuara, u gjykua nga ana e trupit gjykues pa efekt në vlerësimin e çështjes konkrete, për sa kohë nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit nuk u konstatua asnjë fakt, i cili të provonte se mospagesa e tatimit për vlerën e plotë të përfituar nga shitja e pasurisë së paluajtshme ishte “jo për faj të subjektit të rivlerësimit”.*

- Vendimit nr. 14, datë 15.6.2021, ku për analogji, në rastin e pagimit të tatimit në burim nga qiraja, në rastin e një marrëdhënieje të krijuar përmes një personi juridik dhe një individ, detyrimin për pagimin e tatimit në burim e ka personi juridik, i cili ia mban individit. Nga ana e Kolegjit, në pikat 71 dhe 72 të vendimit është vlerësuar se të ardhurat nga qiraja janë konsideruar të ligjshme, pavarësisht se nuk ishte provuar pagimi i detyrimeve tatimore për sa kohë përgjegjësinë për pagimin e këtyre të ardhurave e kishte personi juridik.

- Vendimit nr. 14, datë 15.6.2021, të Kolegjit, i cili parashikon se: *“70. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerësoi se pavarësisht se në dy kontratat e lidhura me subjektet “{***}”sh.p.k. dhe “{***}”sh.p.k., në përmbajtje të tyre përcaktohet rregulli i përgjithshëm që qiradhënësi i nënshtrohet detyrimit për të paguar tatimin mbi të ardhurën e përfituar nga qiraja, e cila me të drejtë, referuar parashikimit të nenit 8 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale, përbën një burim të tatueshëm të ardhurash, ky parashikim nuk mund të interpretohet se detyrimin për të kryer pagesën e tatimit në buxhetin e shtetit, në masën e përcaktuar nga ligji mbi vlerën bruto të qirasë, e ka qiradhënësi, për sa kohë, referuar kuadrit të sipërcituar ligjor, ky përbën një detyrim ligjor të të dyja shoqërive qiramarrëse në rastin objekt gjykimi, të cilat ligji i ka përcaktuar si agjentë të mbajtjes së tatimit në burim dhe u ka ngarkuar detyrimin ligjor për të llogaritur në mënyrë të saktë masën e detyrimit tatimor dhe mbajtjen e këtij detyrimi në burim, si dhe pagimin e tij në buxhetin e shtetit, në afatin e përcaktuar me ligj. Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues, nga verifikimi i akteve të fashikullit të çështjes, konstatoi se pagesat e qirave nga shoqëria “{***}”sh.p.k., për periudhën prill 2011 – prill 2013, janë derdhur në vlera që u korrespondojnë secila pagesave mujore ekuivalente me vlerën neto të çmimit të qirasë, përveç një pagese të derdhur në tetor të vitit 2011 (me përshtetimin “shtator 2011”), e cila përkon me vlerën bruto të qirasë... Të mosprovuarit e pagesës së tatimit të mbajtur nga kjo shoqëri tregtare në llogarinë e buxhetit të shtetit, referuar korrespondencës me organin tatimor, sipas shkresës së cituar edhe në vendimin e Komisionit, në vlerësimin e trupit gjykues nuk sjell asnjë efekt në vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave*

të krijuara nga subjekti i rivlerësimit me burim qiranë, për sa kohë e ardhura prej kësaj të fundit, e përfituar nga qiramarrësi, është zvogëluar me vlerën e detyrimit tatimor që përcakton ligji dhe për sa kohë pagimi i kësaj shume në buxhetin e shtetit nuk është detyrim i tij....”.

- Vendimit nr. 15, datë 18.6.2021, të Kolegjit, i cili referuar një qëndrimi orientues sipas nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të mundësojnë legjitimitimin e të ardhurave të krijuara, ku Kolegji çmon se vlerësimi i tyre do të duhet të bëhet duke konsideruar disa rrethana, si vërtetimi i të ardhurave në kohën e krijimit të tyre dhe sjellja e subjektit dhe personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre.

- Vendimit nr. 6, datë 17.3.2022, të Kolegjit, ku analizon se: *“17.4. Përtej kësaj rrethane, Komisioni nuk i ka konsideruar këto të ardhura si të ligjshme në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, duke qenë se nuk është provuar nga komunikimi me organet tatimore pagimi i detyrimeve tatimore për këto të ardhura. Kolegji, në analizë të parashikimeve ligjore të nenit 33, pika 1, shkronja “ë” e ligjit nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, çmon se, referuar faktit se pala qiramarrëse ka qenë person juridik në kohën e ekzistencës së marrëdhënies dhe përfitimit të këtyre të ardhurave, ajo ka pasur edhe detyrimin për mbajtjen në burim të vlerës së tatimit mbi të ardhurat. Në këto rrethana, për sa kohë që detyrimi i përket një personi tjetër dhe jo subjektit të rivlerësimit dhe nuk ka dyshime për ekzistencën/përfitimin e këtyre të ardhurave nga një burim i ligjshëm, ngarkimi me përgjegjësi i subjektit sipas ligjit nr. 84/2016, edhe në rast të mosshlyerjes së detyrimeve tatimore nga subjekte të tjera të së drejtës, nuk duket se vjen në harmoni me qëllimin dhe kërkesat e ligjit, i cili konsideron të ardhura të ligjshme ato të deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, kur këto detyrime i takojnë subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur apo të tjerë të lidhur me të. Kolegji konfirmon qëndrimin e tij mbajtur edhe në çështje të mëparshme¹², që për sa kohë që të ardhurat janë deklaruar rregullisht në deklaratën e pasurisë Vetting dhe në ato periodike dhe provohet se ekzistojnë dhe vijnë pikërisht nga burimi i deklaruar si i tillë prej subjektit, në rast se mosprovueshmëria e pagimit të detyrimeve tatimore i përket një subjekti tjetër, dhe se subjekti nuk ka dijeni apo një sjellje bashkëpunuese në këtë drejtim, duhet të kalojnë testin e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Nga rasti konkret, qiramarrësi duket se ka vepruar si entitet më vete me elemente të huaja dhe gjithashtu nuk rezulton asnjë e dhënë që të krijon dyshime që në eventualitetin e mospagimit të detyrimeve tatimore subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni apo miratim për këtë sjellje”.*

Së teti, subjekti parashtron se: *“Në momentin e parë që kam marrë dijeni për mosdeklarimin në ISSH nga punëdhënësi i bashkëshortes, kemi kontaktuar menjëherë me punëdhënësin, i cili e ka pranuar këtë fakt dhe i jemi drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm për përmbushjen e detyrimit nga punëdhënësi, duke vënë në dispozicion kopje të kërkesëpadisë”.*

31.2. Në përfundim, subjekti çmon se trupi gjykues nuk mund ta ngarkojë me përgjegjësi për mospagesat e detyrimeve përkatëse nga një ish-punëdhënës i bashkëshortes së tij dhe se Komisioni duhet t’i përfshijë si të ardhura të ligjshme, pasi të ardhurat nga paga e bashkëshortes duhet të vlerësohen në analizën financiare në përputhje me kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

32. Në analizë të të gjitha parashtrimeve dhe dokumenteve shkresore të administruara gjatë hetimit dhe pas kalimit të barrës së provës, Komisioni vlerësoi të bazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes gjatë viteve 2008 dhe 2009, në DPV-të e të cilave ka deklaruar të ardhura duke i konsideruar ato si të ligjshme,

¹² Vendimi nr. 15/2021, datë 18.6.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit K. S.; vendimi nr. 14, datë 15.6.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. I. B.

bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 84/2016, neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe orientimit të Kolegjit, arsyetuar si vijon:

- Së pari, është provuar ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre. Është e vërtetë që nuk ka një kontratë punësimi midis bashkëshortes së subjektit dhe kompanisë punëdhënëse, e cila të vërtetojë *de jure* punësimin e saj apo listëpagesa që të vërtetojnë të ardhurat e përfituara. Gjatë hetimit janë vërtetuar përpjekjet maksimale të subjektit për të siguruar informacion dhe dokumentacion provues nga subjekti punëdhënës, po për shkak të kohës mjaft të largët dhe mungesës së informatizimit vlerësohet i bazuar pretendimi i subjektit se është tërësisht jashtë mundësive dhe kontrollit të tij të vërtetojë me dokumentacion të plotë punësimin dhe të ardhurat e ligjshme të personit të lidhur, duke qenë në kushtet e parashikuara në paragrafin nr. 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016¹³. Por, nga ana tjetër, Komisioni nuk mund të anashkalojë, përkundrazi, sipas paragrafit nr. 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, i konsideron si prova shkresore DPV-të e viteve 2008 dhe 2009, të cilat datojnë 15 vite më parë, në të cilat subjekti ka deklaruar të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes, që përputhen me ato të deklaratës *Vetting*. Madje, ekzistenca e të ardhurave nga punësimi i bashkëshortes së subjektit si gazetarë në revistën "T." vërtetohet edhe me pasqyrimin e tyre në deklaratat periodike vjetore të pasurisë për vitet 2006 dhe 2007, të plotësuara nga babai i bashkëshortes së subjektit, shtetasi Sh. B., në cilësinë e deklaruesit të pasurisë, të cilat po ashtu kanë vlerën e provës, kur bashkëshortja e subjektit ishte pjesë e familjes së saj të origjinës¹⁴. Po kështu, nuk mund të mohohet vlera provuese e vërtetimit të datës 1.2.2008, administruar nga Emporiki Bank, ku bashkëshortja ka qenë në cilësinë e dorëzantës në kreditë e marra, duke plotësuar kushtin e punësimit dhe përfitimit të të ardhurave në kohën e marrjes së kredive, i cili është dokument i kohës, i marrë jashtë procesit të rivlerësimit dhe kur nuk mendohej se mund të kishte një të tillë. Për më tepër, nëse bashkëshortja e subjektit nuk do të ishte e punësuar, nuk do të mund të merrte as cilësinë e dorëzantës në praktikën bankare të Emporiki Bank, ku ajo ka nënshkruar në cilësinë e dorëzantës për qëllime të garantimit të kredisë bankare të marrë për blerjen e apartamentit.

Më tej, edhe kopjet e përmuajshme të revistës "T.", që u përkasin muajve korrik 2008, tetor 2008 dhe maj 2009, ku rezulton se kryeredaktore e revistës është F. P., si dhe vërtetimet e lëshuara nga shoqëria jashtë procesit të rivlerësimit, por edhe në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*, janë prova që hedhin dritë mbi pretendimet e subjektit në lidhje me punësimin e bashkëshortes së tij sipas vërtetimit të datës 1.2.2008, si dhe vërtetimit të datës 24.10.2016.

Sa i takon mënyrës së përfitimit të të ardhurave nga punësimi, subjekti ka vërtetuar bindshëm se në periudhën në fjalë kalimi i pagave nuk bëhej nëpërmjet sistemit bankar.

- Së dyti, sa i takon legjitimitetit të të ardhurave nga punësimi i bashkëshortes, është e vërtetë që nuk është provuar pagimi i detyrimeve tatimore nga ana e subjektit punëdhënës. Por, referuar bazës ligjore të referuar dhe analizuar hollësisht nga subjekti, rezulton se përgjegjësia ligjore për përlllogaritjen, mbajtjen dhe pagimin e taksave/tatimeve bie mbi punëdhënësin dhe bashkëshortja e tij nuk kishte asnjë mundësi për të paguar vetë detyrimin tatimor. Me të drejtë subjekti argumenton se vetë ligjvënësi ka përcaktuar se për: (i) deklarin e listëpagesës; (ii) deklarin e formularit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore; (iii) plotësimin e formularit për deklarin e tatimit mbi të ardhurat personale, është vetëm detyrimi i drejtpërdrejtë i punëdhënësit dhe se këto veprime kryhen me baza mujore për të gjithë punëmarrësit e tij. Edhe

¹³ Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor.

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 22.11.2022, e ILDKPKI-së, që përcjell në Komision deklaratat e pasurisë së deklaruesit Sh. B..

nëse i referohemi Kodit të Punës, e gjithë fryma e ligjvënësit është mbrojtja e punëmarrësit në raport me punëdhënësin e tij. Ndryshe nga pagimi i tatimit në burim në kontratat e shërbimit/qirasë, ku mund të përcaktohet se kush e ka detyrimin për pagesën e detyrimit tatimor, në kontratën e punës, si dhe legjislacionin e zbatueshëm, është parashikuar në mënyrë eksplicite që detyrimin, si të deklarimit në listëpagesë, por edhe të pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, e ka vetëm punëdhënësi.

32.1. Nga ana tjetër, sikurse dhe Kolegji orienton, në konsideratë të organeve të rivlerësimit duhet të mbahet sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin detyrimeve tatimore. Në një analizë të rrethanave që kanë shkaktuar mosvërtetimin e pagimit të detyrimeve tatimore nga ana e subjektit punëdhënës dhe deklarimeve periodike vjetore të bashkëshortes së subjektit, nuk ka asnjë të dhënë që të hedhë dritë mbi faktin se ka kjo qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo një qëllimi për t'u arritur nga ana e subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortes së tij.

32.2. Bazuar në sa më sipër, në vlerësimin përfundimtar të çështjes, Komisioni vlerëson se nëpërmjet provave të dorëzuara si gjatë hetimit administrativ, ashtu dhe në këtë parashkrim, rezulton e provuar tejet çdo dyshimi marrëdhënia e punës së bashkëshortes me shoqërinë "P. C." dhe përfitimi i të ardhurave prej saj, duke kaluar kështu testin e provueshmërisë së marrëdhënies së punësimit. Sa i takon ligjshmërisë së të ardhurave nga kjo marrëdhënie punësimi, në kushtet kur detyrimi për pagesën e kontributeve dhe tatimit mbi të ardhurat nga paga është detyrimi ekskluziv vetëm i punëdhënësit dhe nuk u evidentuan sjellje apo qëndrime të vesuara të subjektit apo/dhe bashkëshortes së tij, mosvërtetimi i pagimit të këtyre detyrimeve nuk mund t'i bëjë të ardhurat të paligjshme, duke penalizuar subjektin e rivlerësimit. Në këto kushte, të ardhurat nga paga e bashkëshortes pranë subjektit tregtar "P. C.", të deklaruar në DPV-të 2008 dhe 2009, në shumën 860.000 lekë, duhet të përfshihen në analizën financiare të rishikuar në përputhje me kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Sa u takon të ardhurave të përfituara nga pagat e bashkëshortes për vitin 2007 (në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura për periudhën 1.5.2007 – 1.7.2009), të deklaruar nga babai i bashkëshortes në DPV-në për vitin 2007, ato nuk ndikojnë në analizën financiare të rishikuar për vitin 2007, e cila është me balancë pozitive të fondeve.

33. Në lidhje me financimin e shpenzimeve të kredisë nga vjehri Sh. B., subjekti ka parashtruar se: *"Në përgjigje të pyetjes nr. 4 të pyetësorit standard, kur jam pyetur nëse kam marrë ndonjë dhuratë me vlerë më të lartë se 500 euro apo më ka financuar ndokush shpenzime në këtë shumë apo më të lartë se kjo shumë, kam deklaruar se vjehri më ka financuar pagesën e kësteve të kredisë për vitin 2008 në shumën 2.800 euro, në vitin 2009 në shumën 3.200 euro dhe në vitin 2010 në shumën 2.750 euro. Këto financime janë kryer prej vjehrit për të ardhur në ndihmë të ekonomisë familjare dhe si rrjedhojë e traditës zakonore. Prindërit e bashkëshortes me rastin e martesës nuk i kanë dhënë bashkëshortes ndonjë shumë monetare (qoftë dhe pajë sipas traditës), por kanë mbuluar financimet e kësteve të kredisë në këto tri vite sipas shumave të deklaruar"*.

33.1. Po kështu, subjekti i referohet faktit se në përgjigjet e pyetësorit standard ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e familjes së bashkëshortes në periudhën 2007 – 2010, bazuar në të cilat evidentohet mundësia financiare e familjes së bashkëshortes për të mbuluar shpenzimet e kësteve të kredisë¹⁵, pasqyruar edhe në formë tabelare, ku vërehet se për vitet 2007 – 2010 mundësia për kursim e familjes së bashkëshortes ka qenë 2.532.000 lekë.

33.2. Sikurse edhe gjatë hetimit administrativ, subjekti parashtron që mosdeklarimi i financimit nga vjehri në DPV ka qenë për shkak se gjatë plotësimit të deklaratave nuk është kërkuar burimi i kësteve të kredisë (fakt i cili është i vërtetë) dhe se ka qenë vullneti i tij i plotë për të

¹⁵ Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur për 4 persona (bashkë me bashkëshorten) në vitin 2007 dhe për 3 persona për periudhat në vijim (shikoni faqen 21 të prapësimeve të subjektit).

paguar disa këste të kredisë. Për të mbështetur këtë fakt, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.12.2023, lëshuar nga kunati, shtetasi E. B., si dhe deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 6.12.2023, lëshuar nga vjehri, shtetasi Sh. B.. Subjekti kërkon që pagesat për shlyerjen e kredive të mos konsiderohen si shpenzime të tij, sikundër nga ana e Komisionit përlllogariten dhe shpenzime të ndryshme të tjera që nuk janë deklaruar më parë në DPV.

33.3. Subjekti me të drejtë i referohet qëndrimit të Kolegjit, i cili ka pranuar deklaratimet e subjekteve të rivlerësimit për mbulimin e shpenzimeve të deklaruara në pyetësin standard nga persona të tjerë, por nuk ka pranuar mbulimin e shpenzimeve të pretenduara rishtas gjatë procesit të prapësimeve në Komision ose në Kolegj. Konkretisht, subjekti i referohet një rasti të ngjashëm të trajtuar në Kolegj me vendimin nr. 2, datë 2.2.2023, ku ndër të tjera, në paragrafin 19.6 arsyetohet se: *“...Kolegji nuk përfshiu në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit shpenzimet për ato udhëtime që gjenin pasqyrim nga të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS, për të cilat vetë subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar që në përgjigjet e para të dhëna, gjatë hetimit administrativ, se kostot e tyre ishin mbuluar nga personat e detajuar si më lart, duke i konsideruar të besueshme deklaratimet e tij lidhur me to. Kolegji nuk konsideroi si të besueshme deklaratimet për mbulimet e shpenzimeve të udhëtimit nga shtetasi A. Gj., për të cilin subjekti kishte bërë deklarime rishtas në Kolegj, si dhe për një udhëtim të mbuluar prej shtetasit L. S., për të cilin nuk kishte deklarime në përgjigjet e pyetësorit të parë”*.

33.4. Siç vërehet, Kolegji ka mbajtur qëndrim pozitiv në lidhje me pretendimet për mbulimin e shpenzimeve në rastin kur subjektet kanë deklaruar se si janë mbuluar kostot e tyre që në fillim të procesit, në përgjigje të pyetësorit standard, ndonëse rasti i referuar lidhet me shpenzime të udhëtimit, ndërsa rasti i subjektit lidhet me mbulimin/financimin e shpenzimeve të kësteve të kredisë. Po kështu, subjekti i rivlerësimit i referohet edhe vendimit nr. 281, datë 27.7.2020 (i paankimuar nga Komisioneri Publik), të Komisionit, për financimin e prindërve të subjektit lidhur me shkollimin, udhëtimet dhe mjekimin e djalit, të deklaruara nga ana e subjektit në pyetësin standard, shpenzime këto të marra në konsideratë si të mbuluara nga ana e prindërve, pasi u vërtetua mundësia e tyre financiare për përballimin e këtyre shpenzimeve me të ardhura të ligjshme.

33.5. Në analizë të të gjitha parashtrimeve dhe dokumenteve që subjekti ka paraqitur, si dhe qëndrimit të mbajtur në Kolegj/Komision në raste të ngjashme, në përfundim të procesit Komisioni vlerësoi që në analizën financiare të rishikuar kështu për pagimin e kredisë të mos konsiderohen si shpenzime të subjektit, për sa kohë: (i) këto pagesa të kryera nga vjehri i tij janë deklaruar që në përgjigje të pyetësorit standard; (ii) bazuar në dokumentacionin ligjor të depozituar nuk mund të konkludohet që familja e bashkëshortes nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për pagesat e kësteve të kredisë.

34. Në parashtrimet e veta, subjekti kërkon të rishikohet analiza financiare dhe të korrigjohen shpenzimet e jetesës në SHBA, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

- Në analizën financiare për vitin 2008 janë llogaritur shpenzimet e udhëtimit në shumën 481.892 lekë. Komisioni për 40 ditë qëndrim ka llogaritur koston e qëndrimit në shumën 4.000 USD. Në lidhje me këtë llogaritje, subjekti kundërshton mënyrën e përlllogaritjes, pasi Komisioni nuk ka marrë në analizë dhe nuk ka përfshirë shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur në përgjigje të pyetësorit standard, por i është referuar metodologjisë së aplikuar nga Kolegji¹⁶.

- Kolegji në përcaktimin e metodologjisë për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit ka përcaktuar se këto shpenzime llogariten 50 euro/USD për çdo ditë qëndrimi, kur subjekti i rivlerësimit nuk provon kostot e udhëtimit. Por, në rastet kur nga subjekti i

¹⁶ Vendim nr. 11, datë 22.5.2019.

rivlerësimin provohet se shpenzimet e qëndrimit për të dhe/ose personat e lidhur me të janë mbuluar nga persona të tretë, atij/atyre do t'u llogaritet vetëm sasia e të hollave të xhepit prej 5 euro/USD.

- Metodologjia e përcaktuar nga Kolegji nuk e lidh mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit me faktin nëse subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë apo nuk kanë deklaruar në të dhëna konfidenciale (dhurata dhe trajtime preferenciale) shuma dhe/ose trajtime të tjera preferenciale në lidhje me shpenzime udhëtimi dhe/ose qëndrim jashtë vendit të mbuluara nga të tretë. Këtë qëndrim Kolegji e ka mbajtur jo vetëm në vendimin nr. 11/2019, por edhe në vendimin nr. 2/2023, trajtuar gjerësisht më lart.

- Komisioni në aneksin shpjegues të analizës paraprake të treguesve financiarë, kur ka shpjeguar llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, ka përcaktuar se: *“Shpenzimet për udhëtimet jashtë vendit (shpenzime transporti dhe qëndrimi) janë pasqyruar/llogaritur mbi bazë të dokumentacionit ligjor të disponuar, deklarimeve të subjektit të rivlerësimit¹⁷, si dhe referuar metodologjisë së aplikuar nga KPA”*. Gjithashtu, Komisioni ka vlerësuar të marrë në konsideratë deklarimin e bërë nga subjekti në procesverbalin e ILDKPKI-së në datën 9.3.2016, se shpenzimet për daljet private jashtë vendit janë mbuluar nga të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes. Subjekti shprehet se: *“Sa i përket shpjegimeve që kam dhënë pranë ILDKPKI-së, dua të shpjegoj se pyetjes së bërë në ILDKPKI se sa kanë qenë shpenzimet për daljet private (pyetja nr. 10), përgjigjja ime ka qenë se shpenzimet janë mbuluar nga të ardhurat familjare. Pyetje drejtuar nga inspektori i ILDKPKI-së në lidhje me shpenzimet e udhëtimit/daljes dhe jo me shpenzimet e qëndrimit. Këtë deklaram kam bërë edhe në pyetësorin standard, ku të gjitha biletat e udhëtimit ku unë dhe familja ime kemi udhëtuar privatisht, kam deklaruar mbulimin e shpenzimeve të biletave të udhëtimit (përveç udhëtimit të datës 18.7.2008 – 27.8.2008, ku bileta e udhëtimit është financuar nga vjehri im, si më sipër sqaruar), ndërsa në lidhje me qëndrimin në SHBA apo udhëtime të tjera kam shpjeguar më saktësi rastet kur në këto udhëtime unë me familjen kemi qëndruar tek banesa e miqve dhe të afërmve, të cilat kanë qenë pa kosto, sikurse kam shpjeguar edhe më lart. Pra, në procesverbalin e ILDKPKI-së kam deklaruar përballimin e shpenzimeve të udhëtimit/daljeve dhe jo shpenzimet e qëndrimit. Trupat e rivlerësimit me metodologjinë e përdorur në vendimin nr. 11/2019 kanë përcaktuar kostot e qëndrimit para kësaj periudhe dhe gjatë pyetjeve në ILDKPKI nuk është kërkuar kostoja e qëndrimit jashtë vendit.*

- Komisioni në metodologji, ndonëse i referohet llogaritjes edhe mbi bazën e deklarimeve të mia si subjekt rivlerësimi, në analizën financiare për kostot e qëndrimit jashtë vendit ka zbatuar vetëm përcaktimet referuar metodologjisë së aplikuar nga KPA”.

- Subjekti kërkon që Komisioni të korrigjojë shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit për të gjitha udhëtimet, të cilat janë deklaruar në pyetësorin standard¹⁸ se janë mbuluar nga persona të tretë, për shkak se janë akomoduar dhe kanë qëndruar në banesat e tyre pa paguar për strehim dhe ushqim. Sipas subjektit, është fakt i njohur se të gjithë qytetarët shqiptarë që udhëtojnë në SHBA, qëndrojnë në shtëpitë e të afërmve dhe jo në hotel apo vende të tjera alternative dhe, si kusht si për marrjen e vizës, ashtu dhe për lotarinë amerikane, nga ambasada kërkohet garanci ose ftesë nga të afërm që jetojnë në SHBA dhe kanë të ardhura të mjaftueshme që mund t'i presin dhe t'i akomodojnë në banesë.

¹⁷ Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 9.3.2016, në përgjigje të pyetjes nr. 10, konkretisht për pyetjen *“Sa kanë qenë shpenzimet për daljet private”*, subjekti ka deklaruar se: *“...për qëllime private, me sa mbaj mend, kam qenë një herë në Itali me bashkëshorten, kam qenë në SHBA rreth 10-11 herë, duke u nisur edhe nga fakti që ka jetuar dhe punuar bashkëshortja ime, shpenzimet janë mbuluar nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes”*. Gjithashtu, në DIPPV-të e viteve 2008 – 2016, subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar në të dhëna konfidenciale (dhurata dhe trajtime preferenciale) shuma dhe/ose trajtime të tjera preferenciale në lidhje me shpenzime udhëtimi dhe/ose qëndrim jashtë vendit të mbuluara nga të tretë.

¹⁸ Korrigjimi i shpenzimeve të udhëtimit të bëhet jo vetëm për vitin 2008, por edhe për të gjitha vitet vijuese.

- Në vijim, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara për udhëtimin ndërmjet datave 18.7.2008 – 27.8.2008, për të cilin ka deklaruar se kanë qëndruar tek djali i hallës së bashkëshortes, shtetasi T. (K.) M., me adresë *** M. Ct, G., OH *** dhe numër telefoni ***. Shtetasi T. M. ka deklaruar në datën 1.8.2020 përpara noterit publik A. C. B. se: *“Valentin Z. Preçi dhe gruaja e tij F. Sh./P. kanë qëndruar në shtëpinë time, në adresën *** M. Ct, G., OH ***, pa qira dhe asnjë shpenzim tjetër nga data 8.7.2008 – 27.8.2008. F. dhe V. P. kanë qëndruar në shtëpinë time pa qira dhe pa shpenzime të tjera nga data 10.10.2011 deri më nëntor, derisa morën me qira një apartament. F. është kushërira ime, vajza e dajës tim”*. Subjekti deklaroi se krahas deklaratës do të vëre në dispozicion të Komisionit të ardhurat e z. T. M. dhe bashkëshortes për vitin 2008 dhe 2011, si dhe fotokopje të pasaportës amerikane të këtij shtetasi. Gjithashtu, në përgjigje të pyetjes nr. 11 të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se: *“Nga data 18.7.2008 – 27.8.2008 kam udhëtuar bashkë me bashkëshorten për në SHBA, ku kemi qëndruar tek djali i hallës së bashkëshortes sime, KujT. M., në banesën e tij, në adresën *** M. Ct, G., OH ***. Kemi ndenjur në banesën e tij me strehim dhe ushqim të mbuluar nga ai. Shpenzimet tona për këtë udhëtim kanë qenë vetëm biletat e udhëtimit, të cilat janë financuar nga vjehri im, z. Sh. B.. Gjithashtu, nuk duhet të përfshihen shpenzimet e biletave të udhëtimit të datës 18.7.2008 – 27.8.2008 të financuara nga vjehri im, z. Sh. B. dhe të deklaruara në pyetësorin standard nga ana ime”*.

- Subjekti kërkon që shpenzimet për 40 ditë qëndrimi në SHBA të përlllogariten në shumën 400 USD dhe të korrigjohet vlera 4.000 USD, përlllogaritur nga Komisioni.

- Gjithashtu, subjekti pretendon se shpenzimet e udhëtimit për vitin 2008 duhet të rishikohen dhe të korrigjohen, duke iu referuar përgjigjeve të pyetësorit standard (pyetjes nr. 12), ku ka deklaruar se: *“21.11.2008 – 24.11.2008, bashkëshortja ka udhëtuar për në Itali me traget e shoqëruar nga prindërit e saj. Kanë fjetur një natë në hotel dhe janë kthyer po me traget ditën tjetër. Qëllimi ka qenë që ajo të shkelte një vizë “Shengen”, të cilën nuk e kishte përdorur dhe ishte drejt përfundimit. Shpenzimet i kanë mbuluar prindërit e bashkëshortes, të cilët edhe e organizuan këtë udhëtim. Në këtë rrethana, kërkoj të mos konsiderohet si shpenzim udhëtimi shuma prej 200 euro”*.

34.1. Bazuar në sa më sipër, sipas subjektit, analiza financiare e vitit 2008 për familjen do të rezultonte me mundësi financiare dhe balancë pozitive në shumën +489.798 lekë, duke paraqitur një tabelë, që pasqyron analizën paraprake të treguesve financiarë për periudhën 1.1.2008 – 31.12.2008, e cila tregon një balancë pozitive prej 489.798,00 lekësh.

34.2. Në përfundim të procesit, në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve shkresore që subjekti ka paraqitur, Komisioni vlerësoi se subjekti ka argumentuar bindshëm pretendimet e tij në lidhje me shpenzimet e jetesës në Amerikë, duke përfshirë këto shpenzime në analizën financiare të rishikuar sipas përlllogaritjeve të subjektit të rivlerësimit.

35. Subjekti gjithashtu kërkon të rishikohet analiza financiare për metodologjinë e ndjekur në përlllogaritjen e likuiditeteve cash. Sipas subjektit, qëndrimi i Komisionit që shuma e likuiditeteve cash të deklaruara të kursyera gjatë vitit 2008 të mos përfshihet në analizën financiare për pasuritë e krijuara më vonë, që kanë si burim të deklaruar kursimet cash të mbartura gjatë viteve, për sa kohë nga analiza financiare rezultoi balancë negative në vitin 2008, në shumën -1.336.380 lekë, është në kundërshtim me metodologjinë e kryerjes së analizës financiare në procesin e rivlerësimit dhe i pabazuar në asnjë jurisprudencë të Kolegjit.

35.1. Subjekti ka deklaruar se: *“Mospërfshirja e gjendjes cash për të mbuluar shtimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve në vitet e tjera pasardhëse, rëndon dy herë dhe në mënyrë të padrejtë analizën financiare, pasi nga njëra anë ato llogariten si pasuri në fund të vitit dhe prodhojnë një balancë negative dhe, nga ana tjetër, mospërfshirja në vitet vijuese sjell dublikim të padrejtë të situatës ekonomiko-financiare. Në këtë rast, e njëjta vlerë kursimi e ngarkon minimalisht dyfish me balancë negative subjektin e rivlerësimit”*.

35.2. Subjekti sjell në vëmendje të Komisionit vendimin nr. 27, datë 22.10.2020, të Kolegjit, për subjektin e rivlerësimit D. P., i cili orienton Komisionin që në rastet kur në fund të vitit analiza financiare rezulton me balancë negative, gjendja e likuiditeteve *cash* të përfshihet në analizën financiare sipas DIPP-së së deklaruar nga subjektet e rivlerësimit.

35.3. Pavarësisht pretendimeve të subjektit, gjatë vlerësimit përfundimtar të çështjes, në një vëzhgim të analizës financiare të kryer nga Komisioni, vërehet se në tabelën përfundimtare të analizës financiare shuma e likuiditeteve *cash* prej 400.000 lekësh gjatë vitit 2008 është përfshirë si burim për pasuritë e krijuara më vonë.

36. Sa i takon burimit të të ardhurave për pagesën e shumës 5.000 euro nga personi tjetër i lidhur, L. D., subjekti ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit, i cili nuk e ka konsideruar këtë hua si burim për kryerjen e pagesës për shkak të mosvërtetimit të të ardhurave të mjaftueshme të tij ligjore. Komisioni ka hetuar në lidhje me burimin e të ardhurave të huadhënësit L. D. për pagesën 5.000 euro dhe, referuar dokumentacionit të paraqitur, të ardhurat për periudhën 1.9.2001 – 1.5.2011 janë në shumën 60.700 euro dhe shpenzimet e jetesës për një person janë përlllogaritur në shumën 57.000 euro. Komisioni ka evidentuar faktin se në tri vitet e fundit personi tjetër i lidhur nuk ka arritur me të ardhurat totale të dokumentuara të mbulojë shpenzimet e jetesës dhe jo më të ketë mundësi kursimi.

36.1. Sipas subjektit në parashtrime, nëse analizohen të ardhurat e paraqitura nga shteti grek, rezulton se për muajin shkurt, mars dhe prill të vitit 2011 nuk janë paraqitur të ardhurat. Për vitin 2010 mungojnë të ardhurat në muajin dhjetor, gusht dhe qershor. Për vitin 2009 mungojnë të ardhurat për muajin gusht. Nëse të ardhurat për këta muaj do të përlllogariten me një mesatare të të ardhurave mujore për periudhat e tjera, do të rezultonte se të ardhurat në tri vitet e fundit mbulonin shpenzimet e jetesës. Më tej, subjekti vijon se për vitin 2007 kunati ka qëndruar më shumë se 90 ditë në Shqipëri për shkak të një fatkeqësie familjare, vërtetuar me shkresën nr. *** prot., datë 30.11.2023, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku është kthyer përgjigje për hyrje-daljet e kunatit L. D.. Sipas informacionit, rezulton se gjatë vitit 2007 ky shtetas ka hyrë në datën 7.4.2007 dhe ka dalë në datën 17.5.2007, duke qëndruar 40 ditë në Shqipëri. Gjithashtu, rezulton dalje në datën 9.11.2007, por nuk rezulton data e hyrjes, si dhe rezulton hyrja në datën 12.10.2007, por nuk rezulton data e daljes. Në vijim, subjekti argumenton se: *“Dokumentacioni i paraqitur për kunatin L. D. është llogari personale e sigurimit, sikundër është në vendin tonë ekstrakti historik i punësimit. Në këtë dokumentacion nuk jepen të dhëna për shpërblimet e marra për Vitin e Ri, Pashkë etj. Për të ardhurat nga shpërblimet nuk mbahen kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë arsye këto të ardhura nuk paraqiten në këtë dokumentacion. Për shpërblimet, sikurse rezulton dhe tek ne, mbahet vetëm tatim për të ardhurat personale. Për këtë arsye, të ardhurave të shtetasit L. D. u mungojnë një deri në dy paga çdo vit që lidhen me shpërblimet e përfituara. Vërtet është përdorur si standard për matjen e shpenzimeve jetike të personit tjetër të lidhur standardi i nivelit të varfërisë për një shtetas grek, por jo domosdoshmërisht ky është i njëjti me standardin e përdorur për të jetuar nga një shtetas shqiptar, emigrant, i cili kulturalisht dhe objektivisht, për shkak të historisë së vendit të tij, nuk mund të prezumohet se ka të njëjtin nivel jetese apo të njëjtat shpenzime për zëra të ndryshëm të paketës që mat shpenzimet jetike si një shtetas grek. Qoftë nevojat, pritshmëritë apo edhe aspiratat dhe stili i jetesës së një emigranti nuk janë natyrshëm si ato të një vendasi, të paktën në vitet e para të jetesës në një vend të huaj”*.

36.2. Në përfundim të procesit, referuar raportit të shumës totale të të ardhurave të dokumentuara të shtetasit L. D. në shumën 60.700 euro me huan 5.000 euro, si dhe faktit që ky shtetas të paktën që prej vitit 2001 është punësuar në mënyrë të rregullt dhe deklaroi të ardhurat e tij para organeve fiskale të shtetit grek, duke treguar një lloj stabiliteti financiar të tij, të paktën që prej kësaj kohe, marrë në konsideratë mungesën e informacionit për një ose disa muaj specifikë brenda një viti të caktuar kalendarik, ndërkohë kur është vërtetuar punësimi para, si

edhe pas këtyre muajve, çka do të thotë se kemi të bëjmë me një punësim në vazhdimësi të këtij personi, marrë në konsideratë edhe faktin e qëndrimit të kumatit në Shqipëri për më shumë se 90 ditë në vitin 2007, çka reflektohet në shpenzime më të ulëta jetese se ato në shtetin grek, Komisioni vlerëson të konsiderojë të bazuara argumentet e subjektit të rivlerësimit, duke përfshirë në analizën financiare të rishikuar shumën 5.000 euro si pagesë e kryer nga personi tjetër i lidhur L. D. për blerjen e apartamentit në Tiranë. Për më tepër, në jurisprudencën si të Kolegjit, ashtu dhe të Komisionit, është vlerësuar se për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhuruar apo dhënë hua dhe, sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, sikurse është arsyetuar në vendimin nr. 2, datë 2.2.2023, të Kolegjit, për subjektin e rivlerësimit E. T. (paragrafi 17.12.), si dhe në vendimin nr. 15/2021 (paragrafi 24/2).

36.3. Bazuar në sa më sipër, në analizën financiare të rishikuar të vitit 2012, duhet të përfshihet kthimi i shumës 5.000 euro kumatit L. D.. Sa u takon likuiditeteve *cash* të deklaruara si shtesë në vitin 2011, në shumën 2000 USD, kjo shumë është konsideruar si burim për pasuritë e krijuara më vonë që në analizën financiare, sipas tabelës përfundimtare të dërguar subjektit me rezultatet e hetimit.

37. Në parashtrimet e veta, subjekti ka paraqitur një analizë të gjatë pretendimesh në lidhje me përllogaritjet e disa prej shpenzimeve në analizën financiare, duke pretenduar që Komisioni duhet t'i rishikojë dhe të korrigojë përllogaritjet për vitin 2011, si vijojnë:

37.1. Duhet të rishikohen shpenzimet e telefonit, të cilat janë përllogaritur nga Komisioni në bazë të pagesave të kryera në bankë. Për këtë arsye, shpenzimet e telefonit, të cilat janë deklaruar në pyetësonin standard, publikohen me shpenzimet e llogaritura. Për rrjedhojë, shpenzimi në shumën 15.000 lekë në vitin 2011 nuk duhet të përfshihet në analizën financiare, pasi ai ka përdorur numrin e telefonit të punës dhe jo numrin tjetër.

37.2. Duhet të rishikohen shpenzimet mesatare të jetesës në SHBA¹⁹, të cilat janë vlerësuar të pasqyrohen nga Komisioni duke filluar nga data 10.10.2011 (pa përfshirë qiratë), referuar numrit të personave dhe kohës së qëndrimit si rezident në SHBA²⁰. Subjekti ka bërë një panoramë tepër të detajuar të shpenzimeve të jetesës për këtë periudhë, duke iu referuar legjislacionit amerikan, si dhe qëndrimeve të Kolegjit në raste të ngjashme. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti parashtron se:

- Shpenzimet janë përllogaritur nga Komisioni sipas indeksit të pragut të varfërisë ose kufirit të varfërisë, i cili është niveli minimal i të ardhurave për të jetuar sipas të dhënave të tabelës 1 - *Weighted average poverty thresholds for families of specified size: 1959 to 2021*, marrë nga faqja zyrtare <https://www.census.gov/data/tables/time-series/demo/income-poverty/historical-poverty-thresholds.html>²¹.

- Sipas të dhënave të tabelës *Threshold component shares for bls-dpinr research supplemental poverty measure (spm) thresholds for consumer units with two adults with two children*, marrë nga faqja zyrtare e të dhënave statistikore të punës për SHBA (U.S. Bureau of Labor Statistics), <https://www.bls.gov/pir/spmhome.html>, komponentët përbërës të indeksit për kategorinë e familjeve që jetojnë me qira, janë: (i) ushqim (*food*); (ii) veshje (*clothing*); (iii) shpenzime për strehim/qira (*shelter*); (iv) shpenzime utilitare (*utilities*); (v) të tjera (*others*).

¹⁹ Referuar "Weighted average poverty thresholds for families of specified size: 1959 to 2021".

²⁰ Mbështetur edhe në jurisprudencën e Kolegjit, vendimin nr. 8/2023.

²¹ *Table 1. Weighted average poverty thresholds for families of specified size: 1959 to 2021*, population in thousands. Population as of March of the following year. Information on confidentiality protection, sampling error, nonsampling error, and definitions is available at <<https://www.census.gov/programs-surveys/cps/techdocs/cpsmar22.pdf>>

- Nga përllogaritja e peshës specifike që zënë shpenzimet për qira në totalin e shpenzimeve (sipas *poverty threshold*), rezultojnë të jetë në intervalin 35% - 36%²². Sikurse konstatohet, shpenzimet për qira dublikohen, duke u ngarkuar dy herë me shpenzimin e qirasë së banesës, ku ka jetuar familja e tij. Përveç shpenzimit për qira në shumën 638 USD/muaj, deklaruar prej meje për periudhën shtator 1.11.2011 – 30.4.2012 dhe 500 USD/muaj për periudhën 1.5.2012 – 31.1.2014, përllogaritur në analizën e Komisionit si zë më vete, më është përllogaritur i njëjti shpenzim edhe në përbërje të indeksit *poverty threshold*, i cili duhet të korrektohet duke i zbritur 35 - 36% të peshës specifike që zë ky shpenzim në këtë indeks, ilustruar në tabela që janë pjesë përbërëse e parashtrimeve të subjektit.

- Shpenzimet jetike për një person që jeton i vetëm për vitin 2007, kanë qenë në vlerën 10.787 USD/vit.

- Nga analizimi i rritjes së shpenzimeve jetike me shtimin e një anëtari në familje, rezultojnë shpenzimet jetike shtohen vetëm me 29%, jo 100%, pra shpenzimet jetike nuk janë rritur në 21.574 USD me shtimin e një anëtari (10.787 USD x 2 anëtarë), por vetëm me 3.167 USD. Duket se diferenca prej 7.620 USD e kostos së jetesës së një anëtari 10.787 USD me kosto jetese të një anëtari të shtuar 3.167 USD konsiston në shpenzime fikse (qira, telefon, utilitare, etj). Po kështu, shpenzimet jetike për shtim të familjes me tre anëtarë (4 anëtarë në përbërje të familjes) rriten në shumën 10.416 USD, pra më pak se shpenzimet e një anëtari që jeton i vetëm.

- Subjekti sjell në vëmendje se: *“Taksimi i pasurive të paluajtshme në SHBA është zë kryesor në bilancin e konsumit familjar, për këtë arsye fakti se apartamenti është në pronësi apo me qira, ndryshon pak në vlerë monetare. Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF) nuk ka si element të saj taksën mbi pronën, pasi deri aktualisht ne nuk kemi një tatim të tillë. Por, nëse do të vendoset ky tatim, sikurse pritet të fillojë zbatimin ligji për tatimin mbi pronësinë e paluajtshme, atëherë dhe ABF do të ndryshojë komponentët e indeksit”*.

- Subjekti vijon të parashtrorë në mënyrë shumë të detajuar se: *“Kolegji në vendimin nr. 8/2023 nuk ka arsyetuar nëse indeksi përmbante dhe shpenzimet e qirasë ose jo dhe nuk ka provuar të kundërtën, që ky indeks nuk përmban në llogaritjen e këtij komponenti të qirasë. Për sa përçaktohet në indeksin *Weighted average poverty threshold* (provuar më lart, në të dhënat zyrtare të përllogaritjes së indeksit), komponenti qira/pronësi/kredi e një pasurie të paluajtshme është një nga pesë komponentët e indeksit. Kolegji, sikurse dhe Komisioneri Publik, nuk ka pranuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, për sa kohë ky pretendim nuk ka qenë kërkuar në parashtrimet e paraqitura në Komision”*.

37.3. Si përfundim, për sa kohë u provua nga të dhënat e bëra prezent në parashtrime se shpenzimet jetike në SHBA nuk rriten në mënyrë përpjesëtimore me rritjen e numrit të anëtarëve, ndryshe nga shpenzimet jetike që përllogarit INSTAT dhe përdorur nga trupat e rivlerësimit, shpenzimet e qirasë në SHBA duhet të përfshihen si pjesë përbërëse të shpenzimeve jetike deri në masën e përcaktuar në indeks, ashtu sikurse subjekti pretendon.

37.4. Po kështu, subjekti pretendon se Komisioni nuk i është drejtuar në pyetësor në lidhje me shpenzimet jetike në SHBA dhe, pasi është njohur me analizën financiare, në të cilën evidentohet se shpenzimet e qirasë janë llogaritur si zë më vete, kundërshton këtë metodologji analize të kryer.

37.5 Sa u takon shpenzimeve të qirasë për muajt nëntor dhe dhjetor 2011, me të drejtë subjekti kërkon të përfshihen në analizë si pjesë e shpenzimeve të jetesës, duke i konsideruar në masën 35 % të tyre. Bashkëshortja dhe vajza nga data 10.10.2011 deri në fillim të muajit nëntor kanë

²² Për vitin 2005, shpenzimet për qira zënë 35.7 % nga 100 % total shpenzime, për vitin 2006 zënë 35.3 %, për vitin 2007 zënë 36.3 %, për vitin 2007 zënë 35.4 % për vitet 2008, 2009, 2010 zënë 36 %, për vitin 2011 zënë 35.3 % dhe për vitin 2012 zënë 36.2%.

qëndruar në apartamentin e kushëririt të saj, T. M., vërtetuar me deklaratën noteriale pranë noterit publik A. C. B., lëshuar në datën 1.8.2020, ku ai deklaroi se nga data 10.10.2011 deri në nëntor bashkëshortja dhe vajza kanë qëndruar në banesën e tij, derisa bashkëshortja ka gjetur apartamentin me qira, prandaj i kërkoi Komisionit të llogarisë me 5 USD dita/person periudhën e qëndrimit tek banesa e shtetasit T. M., pretendim që vlerësohet i drejtë gjithashtu.

37.6 Në analizën financiare për vitin 2011, subjekti kërkon të korrigjohet dhe zëri “Të ardhura nga rimbursimet nga taksat në SHBA”. Sipas tij, Komisioni për vitin 2010 ka përlllogaritur taksat e kthyera në shumën 227 USD, por, referuar deklaratës së të ardhurave për vitin 2010, rezultoi se përveç kësaj shume janë rimbursuar dhe 1.892 USD²³. Nga verifikimi i dokumenteve pas riçeljes së hetimit administrativ, edhe ky pretendim rezultoi i bazuar (trajtuar hollësisht në vijim).

37.7. Subjekti kërkon të korrigjohet dhe të përfshihet në analizë financiare paga e bashkëshortes për vitin 2011. Sipas subjektit, paga neto e bashkëshortes për vitin 2011 është përlllogaritur nga Komisioni në shumën 5203.03 USD, ndërkohë, nëse i referohemi dokumentit të të ardhurave vjetore “Form W-2 Wage and tax statement”, rezultoi se paga bruto është 6.882,4 USD dhe janë paguar të gjitha taksat, duke rezultuar në të ardhura neto në shumën 5.480,73 USD. Përveç të ardhurave neto nga paga, subjekti pretendon se bashkëshortja ka përfituar dhe 478 USD²⁴ të ardhura nga përkthimi, deklaruar në deklaratën e të ardhurave vjetore për vitin 2011.

Përshkrimi	Shuma
Gross wages	6,882.40
Federal income tax	675.05
Social security	289.06
Medicare tax withheld	99.80
State income tax	200.11
Local income tax	137.65
Net income (I)	5,480.73
Other income/Access to interpreters (II)	478.00
Paga në analizën financiare (III)	5,203.03
Diferenca më pak I-II-III	755.70

37.8. Pas verifikimit të dokumenteve shkresore, u konstatua se qëndron pretendimi në lidhje me të ardhurat vjetore sipas dokumentit “Form W-2 wage and tax statement”, sipas të cilit paga bruto është 6.882,4 USD, ndërsa të ardhurat neto në shumën 5.480,73 USD, fakt që u pasqyrua në analizën financiare të rishikuar (ku u përfshinë edhe të ardhurat nga përkthimi, të deklaruara në DPV-në e vitit 2011).

38. Sa i takon burimit të të ardhurave për pagesën e shumës 5.000 euro në vitin 2014, si këst i fundit i çmimit të blerjes së apartamentit dhe garazhit në S., Tiranë, subjekti ka kundërshtuar konstatimin: *“Duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare nga burime të deklaruara të ardhurash për pagesën e këstit të fundit të çmimit të blerjes së apartamentit dhe garazhit në Selitë, Tiranë, në vlerën 5.000 euro, në datën 26.9.2014, shtesën në likuiditet në bankë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën 1.1.2014 – 26.9.2014 (balanca negative paraprake në vlerën - 93.965 lekë)”*. Në parashtrimet e veta, subjekti në mënyrë të përmblodhur u referohet fakteve:

- Në DIPP-në e vitit 2014 ka deklaruar pagesën e shumës 5.000 euro si pjesë e detyrimit të shoqërisë “G. C” sh.p.k., gjithashtu në rubrikën detyrime ka deklaruar shlyerjen e detyrimit

²³ Form 1040A (2010) F. & Valentin Preçi, faqja 2, rubrika 46 a “Amount of line 45 you want refunded to you. If form 8888 is attached, check here”.

²⁴ Form 1040, faqja e parë, rubrika nr. 21.

ndaj kësaj shoqërie dhe pagesën plotësisht të porositjes dhe blerjes së pasurive të paluajshme apartament + garazh.

- Në DIPP-në e vitit 2014 nuk ka deklaruar burimin e krijimit për pagesën 5.000 euro likuiduar shoqërisë së ndërtimit. Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktësisht se pagesa 5.000 euro e kryer në vitin 2014 ka si burim kursimet familjare.

- Sipas subjektit, Komisioni nuk duhet të analizojë vetëm deklarinin periodik të vitit 2014, duke arritur në konkluzione në mospërfshirjen e kursimeve të disponueshme bazuar vetëm në këtë deklaratë, pasi në këtë mënyrë Komisioni i largohet qëllimit dhe objektit të kontrollit të pasurisë sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, të cilat kanë përcaktuar qartësisht se procesi i rivlerësimit fillon nga deklarinimet e subjektit të rivlerësimit për efekt të procesit *Vetting* për secilin prej kritereve, në rastin konkret në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Për me tepër u vërtetua që si burim krijimi për pagesën e kryer, sikundër ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, kanë shërbyer kursimet familjare. Në fund të vitit 2013, kursimet familjare të disponueshme kanë qenë 22.700 USD dhe 650.000 lekë, të cilat tejkalojnë disa herë pagesën e kryer. Përveç kursimeve gjendje nga viti 2013, subjekti ka pasur dhe kursime të krijuara gjatë vitit 2014.

- Subjekti i referohet dhe qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit, sipas të cilit pasaktësitë në deklarime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi. Konkretisht:

a. Kolegji në vendimin nr. 37/2021 shprehet si më poshtë vijon në një situatë të ngjashme me situatën time të trajtuar më lart: *“Pavarësisht deklarimeve jo të plota të subjektit në vitet 2003 – 2004 për pasurinë likuiditet, nga leximi dhe analiza logjike e deklarimeve të bëra prej tij, qoftë në DPV-në e vitit 2004, qoftë në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, në çdo rast subjekti justifikon me burime të ligjshme pasurinë e deklaruar prej tij edhe në versionin e pranuar prej Komisionerit Publik se ai zotëron me bashkëshorten të gjithë shumën. Në lidhje me këtë çështje, Kolegji nënvizon qëndrimin e tij të konsoliduar tashmë se pasaktësitë në deklarime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi”.*

b. Kolegji ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në vendimin nr. 4, datë 16.2.2023, ku shprehet si më poshtë vijon:

*“49. [...] Në analizë të deklarinimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave private të vitit 2011, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, znj. E. O. (Xh.), megjithëse nuk ka deklaruar sipas detyrimit ligjor pakësimin e kursimeve në cash, ajo ka deklaruar se burimi i krijimit të pasurisë “apartament banimi në {***}, Kavajë” dhe “automjet, tip “Audi A2” janë të ardhurat dhe kursimet. Në interpretim të burimit të krijimit të pasurive, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, burim krijimi i cili është konfirmuar nga subjekti i rivlerësimit edhe në deklarinimet mbi burimet e krijimit për këto pasuri në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se ndonëse shuma e akumuluar e kursimeve në cash nuk është deklaruar e pakësuar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2011, rezultoni të jetë identifikuar në të njëjtin deklarinim si burim krijimi për pasuritë objekt kontrolli. Edhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit është saktësuar se kursimet në cash të krijuara nga të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj janë përdorur si burim krijimi për pasurinë apartament banimi, në {***}. Nga transaksionet e kryera për krijimin e pasurive objekt kontrolli në fillim të tremujorit të dytë të vitit kalendarik e në distancë kohore shumë të shkurtër, prej 7 ditësh, nga njëra-tjetra, deduktohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur arsye për të përdorur kursimet në cash si burim për krijimin e tyre. Në këtë kuptim, mosdeklarimi i*

pakësimi të kursimeve në cash në shumën 1.000.000 lekë në fund të vitit 2011, konsiderohet nga trupi gjykues një pasaktësi në deklaram, që nuk përfaqëson realisht ecurinë e situatës financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur për këtë vit. Në këtë arsyetim, trupi gjykues u mbështet edhe në rezultatin e analizës financiare të kryer në Kolegj, i cili tregoi se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi që të krijonte kursimet në cash të deklaruara në fund të vitit pararendës 2010 e, për rrjedhojë, t'i përdorte ato për krijimin e pasurive objekt kontrolli. Në konkluzion, në vlerësimin e trupit gjykues, kjo shumë duhet të përfshihet në të ardhurat e përdorura për blerjen e pasurive në vitin 2011”.

- Në analizën financiare të kryer deri në datën e pagesës, 26.9.2014, por edhe në analizën financiare për të gjithë vitin 2014, subjekti vlerëson se disa nga zërat e analizës duhet të rishikohen dhe të korigjohen bazuar në shpjegimet e dhëna më sipër e gjithashtu në parashtrimet si më poshtë vijon:

a. Zëri të ardhurat nga “Assitance Group” për vitin 2014 është përlloritur në shumën 1913 USD. Ndërkohë, nga informacioni përcjellë Komisionit, këto të ardhura janë në vlerë më të lartë. Për disa muaj, konkretisht ndërmjet 1.2.2014 – 30.9.2014, për 8 (tetë) muaj, familja ka përfituar 632 USD/muaj, për muajin tetor ka përfituar 649 USD dhe për muajin janar 2014 ka përfituar 632 USD, pasqyruar në mënyrë të detajuar në një tabelë të vënë në dispozicion me parashtrimet.

b. Në shpenzimet e përlloritura nga Komisioni në vitin 2014, shpenzimet e qirasë të njohura në shumën 57.615 lekë nuk duhet të përfshihen në analizë. Referuar indeksit për vitin 2014, shpenzimet e qirasë kanë peshë specifike 36.4 % të totalit të shpenzimeve jetike, për këtë arsye përlloraritja e shpenzimeve të jetesës në SHBA, në shumën 223.234 lekë, përfshin edhe shpenzimet e qirasë në shumën 57.615 lekë, të cilat zënë një peshë prej 26 % të totalit të shpenzimeve. Për këtë arsye, shpenzimi i qirasë në shumën 57.615 lekë është pjesë përbërëse e shpenzimit të jetesës në SHBA në shumën 223.234 lekë dhe, si i tillë, nuk duhet të përfshihet në analizë.

c. Shpenzimet e udhëtimit për në SHBA janë përlloritur në masën 50 USD/ditë, referuar jurisprudencës së Kolegjit dhe nuk është marrë në konsideratë deklarimi im në pyetësonin standard, ku citoj : *“11/10/2014 – 20.10.2014. Unë dhe bashkëshortja kemi udhëtuar në SHBA me qëllim që të përmbushnim detyrimin e shkeljes së kartës jeshile. Kemi qëndruar natën e parë dhe të fundit në hotel, në Connecticut, nga ku kishim edhe fluturimin, ndërsa pjesën tjetër kemi ndenjur tek shtëpia e mikut tim A. D., me adresë *** B. St., ***, NY ***, pa qira e shpenzime ushqimi. Hoteli ka kushtuar rreth 45,000 lekë për të dyja netët”.*

Për të vërtetuar qëndrimin në apartamentin e mikut A. D., subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale të datës 8.6.2020 pranë noterit publik R. S., nëpërmjet së cilës deklaroi se subjekti ka qëndruar ndërmjet datave 12 – 19 tetor 2014 në shtëpinë e tij dhe ka përballuar të gjitha kostot e qëndrimit aty. Së bashku me deklaratën noteriale ka depozituar dokumentin e pronësisë së banesës, blerë prej vitit 2004, si dhe të ardhurat e këtij shtetasi për vitin 2014. Referuar dokumentit *Form 1040*, rezultoi se të ardhurat bruto për vitin 2014 janë në shumën 97.284 USD. Për këtë arsye, sipas subjektit, shpenzimet e udhëtimit për ditët e qëndrimit në banesën e tij duhet të konsiderohen 5 USD/dita.

38.1. Në analizë të të gjitha parashtrimeve dhe provave të administruara, në përfundim të procesit Komisioni vlerësoi se subjekti ka kundërshtuar barrën e provës në lidhje me mundësinë financiare për pagesën e shumës 5.000 euro në vitin 2014. Vlen të theksohet se edhe në rast të moskundërshtimit të barrës së provës balanca negative prej -93.965 lekësh nuk është domethënëse dhe, si e tillë, nuk ndikon në analizën financiare të rishikuar.

39. Në përfundim të procesit, në lidhje me pasurinë apartament dhe garazh, Komisioni duke pasur parasysh deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin

kalimtar *Vetting*, raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion, provat shkresore të administruara sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, vlerësoi se burimet e përdorura për financimin e pasurisë janë në harmoni me deklaratimet e subjektit në deklaratën e pasurisë *Vetting* dhe me deklaratimet dhe logjikën e përdorur gjatë procesit të rivlerësimit dhe se, referuar analizës financiare të rishikuar, subjekti ka justifikuar blerjen e pasurisë me të ardhura të ligjshme.

Lidhur me një situatë të mundshme konflikti interesi

40. Duke qenë se si kolateral për kredinë e dhënë me kontratën e huas datë 12.3.2008 nga Banka Emporiki subjektit Valentin Preçi, në shumën 24.500 euro, është vendosur një dyqan me sip. 75 m², i ndodhur në katin përdhe të godinës *** kate në ***, komuna Dajt, Tiranë, në pronësi të shoqërisë “***” sh.p.k., Komisioni i kërkoi subjektit sqarime për marrëdhënien e tij të pronësisë me pasurinë e paluajtshme të sipërcituar, arsyet/qëllimin e krijimit të marrëdhënies, si dhe për marrëdhënie të mundshme shoqërore/familjare apo të çfarëdolloji, përfshirë konfliktin e mundshëm të interesave me administratorin dhe/ose ortakët e shoqërisë “***” sh.p.k. Nga hetimi administrativ rezultoi se:

40.1. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaron se: *“Për sa i përket pasurisë së lënë kolateral, deklaroj me përgjegjësi të plotë se unë nuk gëzoj asnjë të drejtë pronësie lidhur me këtë pasuri, sikundër rezulton edhe nga aktet që ndodhen në praktikën e kredisë. Shoqëria “***” sh.p.k. në atë kohë ka pasur si ortak të saj shtetasin B. C., i cili ka zotëruar në atë kohë 50% të kuotave të shoqërisë, referuar dhe ekstraktit të QKB-së. Me këtë shtetas jam njohur rreth viteve 2000 dhe që nga ajo kohë kam ruajtur marrëdhënie miqësore. Në atë periudhë kërkoja një apartament për banim. Një ndër kushtet që banka kërkonte me qëllim lidhjen e kontratës së kredisë, ishte caktimi i një kolaterali që do të lihej me garantimin e shumëve të dhënë hua nga banka. Në atë kohë nuk disponoja asnjë pasuri në emrin tim. Apartamenti objekt shitiqeje nuk ishte i regjistruar pranë regjistrave hipotekore dhe nuk mund të shërbente për hipotekim, ndaj dhe banka nuk ma pranoi një propozim të tillë. Për këtë arsye, miku im B. C., i cili pasi pa domosdoshmërinë për lënien garanci të një pasurie, vendosi të vetafrohej, duke më thënë që shoqëria ku ai është ortak (pronar i saj), ka pasuri të lira për të lënë kolateral. Në këtë mënyrë, ai bëri të mundur që shoqëria “***” sh.p.k. të lidhte një kontratë hipotekore për qëllime të garantimit të pagimit të shumëve të kredisë që do të lëvrohej për mua pranë ish-Emporiki Bank (sot ABI Bank sh.a.). Lidhur me marrëdhëniet e mundshme shoqërore familjare të shtruar si pyetje nga ana Juaj, sqaroj se të vetmen marrëdhënie miqësore që kam, është ajo me z. B. C.. Personat e tjerë të përfshirë, z. R. B., e njoh vetëm në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të shoqërisë, dhe kam njohje vetëm prej z. C.. Ndërsa ortakun tjetër të shoqërisë nuk e kam takuar asnjëherë dhe nuk kam pasur asnjë njohje konkrete personale me të. Nga verifikimi i regjistrave të njoftimeve të veprave penale pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë (“Indekset e kallëzimeve dhe statistikave elektronike të procedimeve penale”) për periudhën 2004 – 2022, rezulton se nga ana ime si prokuror është trajtuar kallëzimi penal nr. ***, i vitit 2014, me të kallëzuar shtetasin M. B. dhe kallëzues D. Q.. Në përmbajtje të fashikullit rezulton gjithashtu që kam paraqitur një kërkesë për heqje dore nga kallëzimi penal me nr. ***, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë së asaj kohe, ku kam kërkuar heqjen dorë nga hetimi i këtij kallëzimi penal, për shkak të faktit që ky person ka qenë ortak dhe administrator me 50% të aksioneve në shoqërinë “***” sh.p.k., shoqëri e cila më ka lënë në vitin 2008 kolateral një dyqan për një kontratë huaje të lidhur me Emporiki Bank për blerjen e apartamentit. Drejtuesi i Prokurorisë në atë kohë vendosi të mos e pranojë kërkesën time, ndaj dhe referuar dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale në atë kohë, vendimmarrja, urdhrat dhe udhëzimet e drejtuesit të prokurorisë kanë qenë të detyrueshme për zbatim nga ana e prokurorëve. Gjithashtu, dua të shtoj faktin se marrëdhënien e kolateralit e kam pasur me shoqërinë “***”*

sh.p.k. dhe jo me ortakët e saj. Ky ortak është larguar nga shoqëria që prej vitit 2011 me kontratën e shitjes datë 7.3.2011, i cili i ka kaluar kuotat e tij të shoqërisë ortakut tjetër, B. C., dhe po kështu, në po të njëjtin vit, është larguar edhe në cilësinë e administratorit të shoqërisë. Deklaroj me përgjegjësi të plotë që këtë shtetas nuk e kam takuar asnjëherë në jetën time, por për të mos krijuar asnjë dyshim në zgjidhjen në mënyrë objektive të materialit që kisha për të trajtuar, kam paraqitur kërkesën e sipërcituar, të cilën Drejtuesi i Prokurorisë nuk e ka pranuar. Lidhur me dy shtetasit e tjerë, z. B. dhe C., deklaroj se nuk kam pasur asnjë çështje apo procedim penal me kallëzues apo të kallëzuar këta shtetas”.

40.2. Në mbështetje të shpjegimeve, subjekti depozitoi: (i) deklaratën noteriale nr. *** rep. dhe *** kol., datë 5.12.2022, të z. B. C., i cili deklaroi se ka miqësi me subjektin, e, për këtë arsye, shoqëria ku ai është ortak, vendosi t'i jepte për kolateral pasurinë. Gjithashtu, subjekti nuk e njeh dhe nuk e ka takuar asnjëherë ortakun tjetër të shoqërisë, shtetasin M. B.; (ii) shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. *** prot., datë 18.11.2022, që konfirmon se nga verifikimet e kryera në regjistrat elektronikë nuk rezultoi që subjekti të ketë hetuar, mos filluar apo pushuar çështje në ngarkim ose në cilësinë e kallëzuesve (R. B., M. B. dhe B. C.); (iii) shkresën nr. *** prot., datë 21.11.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që konfirmon se nga verifikimet e kryera në regjistrat elektronikë rezultoi që subjekti të ketë ndjekur material kallëzues vetëm për shtetasin M. B., ndaj të cilit është regjistruar kallëzimi penal nr. *** i vitit 2014, për të cilin është marrë vendim mosfillimi në datën 9.4.2014 nga subjekti i rivlerësimit.

40.3. Komisioni i ka kërkuar informacion edhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me çështje penale të hetuara me shoqërinë “****” sh.p.k. apo ortakun (ët)/administratorin(ët)/përfaqësuesin e administratorit për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe, nga përgjigjet²⁵, për shtetasin M. B. (në cilësinë e personit të kallëzuar) ka rezultuar të jetë regjistruar kallëzimi penal nr. ***, viti 2014, për veprën penale të mashtrimit, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal, për të cilin në datën 9.4.2014 është marrë vendim mosfillimi nga subjekti i rivlerësimit.

40.4. Komisioni në pyetësin nr. 3 i kërkoi sërish subjektit depozitim e kërkesës për heqje dorë nga hetimi i çështjes penale, si dhe vendimin e Drejtuesit të Prokurorisë për miratimin e kërkesës dhe subjekti ka sqaruar se: *“Sqaroj trupin gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit se mbi bazën e këtij kallëzimi është regjistruar materiali kallëzues nr. ***, datë 21.3.2014 dhe, referuar ciklimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ky material i ka kaluar për vlerësim z. N., zëvendësdrejtues i kësaj Prokurorie. Referuar formularit përkatës për trajtimin e këtij materiali kallëzues, zëvendësdrejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shprehur mendim me shkrim se në lidhje me këtë material duhet të procedohet me mosfillimin e procedimit penal, pasi fakti nuk parashikohet si vepër penale, njëkohësisht është caktuar prokurori, z. Sh. G., për ndjekjen e çështjes. Në të njëjtin formular është bërë caktimi nëpërmjet ciklimit të datës 4.4.2014 për zëvendësimin e këtij prokurori me z. V. Preçi. Pas marrjes në dorëzim të këtij materiali kallëzues i jam drejtuar me kërkesën për heqjen dorë Drejtuesit të Prokurorisë dhe, referuar ciklimit në kokën e kësaj kërkesë, pasqyrohet shënimi se kërkesa ime nuk pranohet. Nuk disponoj kopje të vendimit të dhënë nga Drejtuesi i Prokurorisë Tiranë në lidhje me refuzimin e kërkesës sime për heqje dorë, pasi në praktikën e punës në ato vite ciklimi i titullarit në vetvete ishte urdhër nga prokurori më i lartë, i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët vartës të tij, referuar neni 24.4 të Kodit të Procedurës Penale në fuqi”.* Subjekti në mbështetje të shpjegimeve ka depozituar një kopje të kërkesës së heqjes dorë.

40.5. Komisioni i kërkoi informacion edhe ABI Bank në lidhje me pasurinë e paluajtshme të vendosur si kolateral për pagimin e kredisë dhe ABI Bank me shkresën nr. *** prot., datë

²⁵ Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 1.12.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

13.10.2023, konfirmoi se bazuar në të dhënat për subjektin, si dhe në raportin e kolateralëve të bankës, rezulton se kontrata e kredisë së klientit vijon të sigurohet nga i njëjti kolateral dhe nuk ka ndryshime përkatëse.

40.6. Ndodhur para këtyre fakteve, në kushtet kur subjekti: (i) ka hetuar në vitin 2014 administratorin/si dhe ortakun e shoqërisë “****” sh.p.k., z. M. B., në cilësinë e të kallëzuarit për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit në datën 9.4.2014 nga subjekti i rivlerësimit; (ii) rezulton se në kohën e regjistrimit të procedimit penal në vitin 2014 dhe kryerjes së veprimeve hetimore nga ana e subjektit të rivlerësimit, vazhdonte marrëdhënia e interesit pasi pasuria e sipërcituar vazhdonte e vendosur si kolateral (të drejta dhe detyrime pasurore të çdolloj natyre); (iii) subjekti me ortakët e shoqërisë “****” sh.p.k. ka pasur një natyrë marrëdhënie, e cila i ka mundësuar vendosjen në kolateral të pasurisë së sipërcituar, e cila vazhdon të shërbejë si garanci për kontratën e kredisë; (iv) kërkesa për heqje dorë e paraqitur nga subjekti duket se nuk plotëson kushtet formale, pasi nuk përmban datë për të vlerësuar/provuar nëse subjekti e ka paraqitur kërkesën në kohë apo është paraqitur me vonesë nga momenti që subjekti ka pasur dijëni për palët, duket se subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 17, pika 1, shkronja “ë” dhe neni 26, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, që parashikon heqjen dorë nga çështja kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 17.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

41. Lidhur me konfliktin e interesit për shtetasin M. B. subjekti parashtron fillimisht se ka dhënë sqarime të plota dhe akte shpresore provuese gjatë hetimit administrativ. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti në parashtrime i referohet faktit se ka paraqitur një kërkesë për heqje dorë nga kallëzimi penal nr. ***, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë së asaj kohe, z. P. F., e cila nuk u pranua prej tij. Sipas subjektit, konstatimi se *kërkesa për heqje dorë e paraqitur nga subjekti duket se nuk plotëson kushtet formale, pasi nuk përmban datë për të vlerësuar/provuar nëse subjekti e ka paraqitur kërkesën në kohë apo është paraqitur me vonë*, nuk është i drejtë, pasi mungesa e një elementi formal si data në aktin e dorëheqjes, i cili është një element që nuk plotësohet nga ana e prokurorit të çështjes, por nga administrata/sekretaria e Prokurorisë, nuk përbën element të pavlefshmërisë së aktit procedural, në kuptim të nenit 100 të Kodit të Procedurës Penale, për sa kohë aktet që ndodhen brenda në dosje, sikundër është siglimi/nënshkrimi me shënimin “Refuzohet kërkesa” nga Drejtuesi i kohës i Prokurorisë, konfirmojnë një fakt të tillë. Kjo dosje është vënë në dispozicion si fashikull i plotë nga ana e Prokurorisë së Rrethit Tiranë, e plotë, dhe nuk rezulton asnjë mangësi në dokumentacionin e saj.

41.1. Lidhur me marrëdhënien e kolateralit, subjekti vijon të këmbëngulë se kjo marrëdhënie ka qenë drejtpërdrejt me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe jo me ortakët e kësaj shoqërie. Subjekti parashtron se: *“Ortaku dhe shoqëria kanë identitet juridik të ndryshëm nga njëra-tjetra. Ky ortak (M. B.) është larguar nga shoqëria, që prej vitit 2011, me kontratën e shitjes datë 7.3.2011 (sikundër rezulton nga ekstrakti historik i kësaj shoqërie), i cili i ka kaluar kuotat e tij të shoqërisë, ortakut tjetër B. C. dhe po kështu, në po të njëjtin vit, është larguar me vendimmarrje të ortakëve të shoqërisë edhe në cilësinë e administratorit të shoqërisë. Dua të theksoj faktin se unë këtë shtetas as nuk e kam takuar ndonjëherë në jetën time dhe, pavarësisht kësaj, për të garantuar besimin në zgjidhjen sa më të drejtë të çështjes, dhe për të mos krijuar asnjë dyshim në paanësinë time, kam paraqitur kërkesën e sipërcituar, të cilën Drejtuesi i Prokurorisë i asaj kohe, nuk e ka pranuar”*.

41.2. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se në datën 7.12.2023 i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për të verifikuar nëse kallëzuesi ka

ushtruar ankim ndaj vendimit të mosfillimit nr. ***, datë 21.3.2014. Me shkresën nr. *** prot., datë 7.12.2023, është kthyer përgjigje se për periudhën 2014 – 2023 nuk rezulton që ndaj kallëzimit penal nr. *** të jetë ushtruar ankim.

42. Në përfundim të procesit Komisioni çmon se subjekti argumentoi në mënyrë bindëse të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, të cilat dukeshin se e çonin atë në situatën e parashikuar nga neni 17 i Kodit të Procedurës Penale, duke arsyetuar se:

42.1. Mungesa e datës në aktin e heqjes dorë është një pasaktësi formale që nuk e bën atë të pavlefshëm në kuptimin material të tij, pasi ky akt gjendet dhe është pjesë integrale e fashikullit të hetimit, është administruar në dosje që në momentin e paraqitjes së saj dhe është nënshkruar nga Drejtuesi i Prokurorisë së asaj kohe, i cili ka refuzuar kërkesën e paraqitur nga subjekti. Në këto kushte, nuk mund të ketë asnjë dyshim apo indicie që kjo kërkesë të jetë paraqitur më vonë, e aq më tepër për efekt të procesit të rivlerësimit. Qartësisht rezulton se dhe kërkesa për dorëheqje e subjektit (i cili ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i këtij kallëzimi penal, për shkak të faktit që ky person ka qenë ortak dhe administrator me 50% të aksioneve në shoqërinë “****” sh.p.k., shoqëri e cila më ka lënë në vitin 2008 kolateral një dyqan për një kontratë huaje të lidhur me Emporiki Bank për blerjen e apartamentit), në korrektësi të plotë me ligjin dhe respektimin e paanësisë si prokuror, i referohet marrëdhënies juridiko-civile dhe ka pasur qëllim evitim të një konflikti në dukje të interesit, e cila sikurse me të drejtë subjekti pretendon në thelb lidhjen vetëm për arsye të njohjes se tij me shtetasin B. C. dhe jo me shtetasin M. B., i cili ka qenë aksioner i kësaj shoqërie.

42.2. Për më tepër, në kohën kur shtetasi M. B. ka qenë i kallëzuar dhe materiali penal është marrë në shqyrtim nga ana e subjektit, ai nuk ka pasur cilësinë e aksionerit/administratorit të shoqërisë, pra, nuk gëzonte më asnjë cilësi, për pasojë nuk ka pasur asnjë lidhje/interes pasuror mbi kolateralin me shoqërinë “****” sh.p.k. Por, pavarësisht kësaj, për të shmangur çfarëdo dyshimi se ekzistojnë shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, subjekti ka paraqitur kërkesën për dorëheqje që në momentin kur ka konstatuar identitetin e këtij personi, e cila është refuzuar nga ana e Drejtuesit.

42.3. Gjithashtu vlerësohet se nuk qëndron konstatimi se *subjekti me ortakët e shoqërisë “****” sh.p.k. ka pasur një natyrë marrëdhënieje, e cila i ka mundësuar vendosjen në kolateral të pasurisë së sipërcituar, e cila vazhdon të shërbejë si garanci për kontratën e kredisë.* Kjo pasi nuk ka asnjë pengesë ligjore që me një shtetas të njohur që ishte shtetasi B. C. (me të cilin nuk u vërtetua të jetë në një situatë konflikti interesi), subjekti të ketë bërë një marrëveshje me qëllim vënien e një pasurie si kolateral për marrjen e kredisë. Sa i përket shtetasit M. B., nuk u vërtetua që subjekti të ketë pasur njohje apo marrëdhënie të çdo lloji.

43. Automjet tip “Skoda Fabia”, me targë *, blerë me kontratën nr *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2016, me shitës A. B. me shumë prej 3.200 USD, me burim: kursimet cash të familjes.**

43.1. Në lidhje me këtë mjet, nga hetimi administrativ rezultoi se:

- Në DPV-në e vitit 2016, subjekti e ka deklaruar këtë mjet me *burim kursimet cash të familjes; pakësuar gjendja cash e deklaruar më parë në shumën 130.000 lekë; pakësuar gjendja cash e deklaruar në vlerën 12.500 USD.*

- Në pyetësin standard, subjekti, në përgjigje të pyetjes për shpenzime të kryera me vlerë më të madhe se 2.500 euro, ka deklaruar: *“Ka blerë ndër të tjera edhe automjetin tip “Skoda Fabia”, me targë ***, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2016, në vlerën 3.200 USD. Pajesa është kryer cash”.*

- AMF-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2020, ka konfirmuar mbulimin me sigurim të automjetit në fjalë nga ana e subjektit nga data 26.8.2017 deri në datën 25.8.2018.

- DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 25.6.2020, vendosi në dispozicion kopje të dosjes së automjetit me targë ***, nga ku rezulton se: (i) me kontratën e shitblerjes datë 18.10.2016, subjekti ka blerë një automjet tip “Skoda Fabia”, viti 2011, me targë ***, me çmim 3.200 USD nga shitësi A. B.; (ii) me kontratën e shitblerjes datë 18.10.2016, Landeslease sh.a. në vijim të kontratës së mëparshme të qirasë financiare lidhur në datën 7.6.2011 i ka shitur shtetasit A. B. automjetin tip “Skoda Fabia”, me targë ***, viti i prodhimit 2011, me çmim 10.000 euro; (iii) certifikata e pronësisë së mjetit rrugor vërteton se automjeti tip “Skoda Fabia”, vit prodhimi 2011, ka kaluar në pronësi të Landeslease sh.a. më 2.6.2011. Sipas zhdoganimit datë 8.3.2011, vlera e automjetit është deklaruar 7.304 euro nga Porsche Albania.

- Nisur nga fakti se nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni rezulton se shtetasi A. B. e ka blerë këtë automjet me kontratë *leasing* në datën 8.3.2011, me çmim total 10.000 euro, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime për gjendjen e automjetit në momentin e blerjes nga ana e tij, si dhe të deklarojë marrëdhënien e tij me shitësin. Në pyetësin nr. 2, subjekti sqaroi se: *“Shtetasi A. B. është kushëriri i parë i bashkëshortes. Në momentin e blerjes automjeti ka qenë i aksidentuar më parë dhe i pamirëmbajtur (gërvishje të bojës dhe dëmtime në disa vende). Blerja e automjetit është bërë në monedhën dollar, për shkak se kursimet i kisha të ruajtura në këtë monedhë. Vlera e blerjes është e barabartë me vlerën neto të automjetit në bazë të shkronjës (b) të pikës 5 të nenit 22 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, amortizimi i aktiveve të tjera të veprimtarisë, ku përfshihen edhe automjetet është 20 % në vit. Nëse paraqesim në formë tabelare vlerën kontabël neto të automjetit sipas metodës së amortizimit të parashikuar në ligj, do të rezultonte që vlera e automjetit në fund të muajit shtator 2016 ka qenë 2.959 euro ose 3.122 USD. Ndërsa ky automjet në datën 18.10.2016 është blerë nga ana ime në vlerën 3.200 USD (më shumë se vlera kontabël e tij)”*.

Analizë e burimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie dhe mundësia financiare

44. Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2016, subjekti, si në DPV-në e vitit 2016, ashtu edhe në deklaratën *Vetting* ka deklaruar *“kursimet cash të familjes”*. Gjithashtu, në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar edhe *pakësim të gjendjes cash, e deklaruar më parë në shumën 130.000 lekë, pakësuar gjendja cash e deklaruar në vlerën 12.500 USD*.

44.1. Në lidhje me mundësinë financiare të subjektit për krijimin, shtimin dhe ecurinë e gjendjeve *cash* në banesë për periudhën 2009 – 2016, si burim të deklaruar për blerjen e autoveturës tip “Skoda”, me targë ***, me kontratë në datën 18.10.2016, nga Komisioni është vlerësuar që të pasqyrohet më poshtë në analizë të kursimeve *cash* dhe të pasurive të tjera me të njëjtin burim të ardhurash të deklaruara në deklaratën *Vetting*. Konkretisht, në deklaratën *Vetting* subjekti i ka deklaruar këto vlera monetare *cash* me pjesë takuese 100%, me burim të ardhurat e familjes: (i) kursimet *cash* në shumën 10.200 USD; (ii) kursimet *cash* në shumën 70.000 lekë.

44.2. Referuar deklarimeve të interesave privatë periodikë, subjekti, përveç sa është analizuar më sipër (deri në vitin 2008), ka deklaruar ndër të tjera:

Në DPV-në e vitit 2009: *“Pakësuar gjendja cash gjatë vitit 2009 në shumën 400.000 lekë”*.

Në DPV-në e vitit 2010: *“Kursime nga të ardhurat familjare cash dhe në bankë (kartë gold e bashkëshortes në SHBA) shuma rreth 3.700 USD dhe 50.000 lekë”*.

Në DPV-në e vitit 2011: *“Kursyer nga të ardhurat familjare cash gjatë vitit 2011 në shumën 2.000 USD”*.

Në DPV-në e vitit 2012: “Gjendje likuiditetet në lekë të kursyera për vitin 2012 në shumën 200.000 lekë (në pjesë 100%); gjendja cash në shtëpi nga kursimet e familjes në SHBA, shuma 6.000 USD”.

Në DPV-në e vitit 2013: “(i) gjendje likuiditetet në lekë të kursyera për vitin 2013 në shumën 250.000 lekë (në pjesë 100%); (ii) gjendje cash në shtëpi nga kursimet e familjes në SHBA për vitin 2013, shuma 11.000 USD”.

Në DPV-në e vitit 2014, subjekti nuk ka deklaruar shtesa/pakësim/gjendje likuiditete cash në banesë:

Në DPV-në e vitit 2015: “Pakësuar gjendja cash në shumën 400.000 lekë”.

Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: (i) Blerë nga bashkëshortja në SHBA, New York, automjetin tip “Volkswagen Jetta”, në datën 6.10.2016, në shumën 3.250 USD, me të ardhurat cash të familjes; (ii) autoveturë tip “Skoda Fabia”, me targë ***, blerë me kontratë datë 18.10.2016, në vlerën 3.200 USD, burimi kursimet cash të familjes; (iii) pakësuar gjendja cash e deklaruar më parë në shumën 130.000 lekë; (iv) pakësuar gjendja cash e deklaruar në vlerën 12.500 USD.

44.3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaron ndër të tjera se: “...DIPP-në e vitit 2010 kam deklaruar, kursyer nga të ardhurat familjare cash dhe në bankë-kartë gold e bashkëshortes në SHBA, sqaroj se shuma prej 3.700 USD ka qenë fillimisht gjendje në kartën Gold të disponuar nga bashkëshortja dhe është tërhequr në fund të vitit prej saj, duke e disponuar atë cash. Në DIPP-në e vitit 2010, gjendja cash është shtuar në shumën 50.000 lekë, duke disponuar gjithsej 200.000 lekë cash dhe 3.700 USD, tërhequr nga karta rimbushëse Gold”.

44.4. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar, në mënyrë të veçantë në deklarin e interesave periodikë vjetorë të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, përcaktimeve në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit²⁶, ka pasqyruar ecurinë e likuiditeteve cash deri në datën 31.12.2016, duke përllogaritur edhe shumën gjendje në fund të çdo viti, referuar këtyre deklarimeve si në tabelën më poshtë:

Viti	Likuiditet cash deklaruar		Gjendje në banesë datë 31 dhjetor	
	Në lekë	Në USD	Në lekë	Në USD
	Dekl. DPV		Ref. DPV	
2004			0	
2005	200000	0	200000	0
2006	500000	0	700000	0
2007	700000	0	1400000	0
2008	-850000	0	550000	0
2009	-400000	0	150000	0
2010	50000	3700	200000	3700
2011	0	2000	200000	5700
2012	200000	300	400000	6000
2013	250000	11000	650000	17000
2014	0	0	650000	17000
2015	-400000	0	250000	17000
2016	-130000	-12500	120000	4500

²⁶ Vendim nr. 20/2019; nr. 20/2020; nr. 13/2021; nr. 28/2021.

44.5. Sa më sipër, gjendja e likuiditeteve *cash* në datën 31.12.2016, referuar deklarimeve të subjektit periodikisht, llogaritet në vlerat 120.000 lekë dhe 4.500 USD. Në deklaratën *Vetting*, të dorëzuar në datën 25.1.2017, subjekti ka deklaruar gjendje kursime *cash* shumat 70.000 lekë dhe 10.200 USD (me një ulje të shumës së likuiditeteve në lekë prej 50.000 lekësh dhe rritje të kursimeve në dollar në shumën 5.700 USD, nga llogaritjet referuar deklarimeve të tij deri në vitin 2016).

Analizë e burimit të të ardhurave për krijim të këtyre likuiditeteve dhe mundësia financiare

45. Nga Komisioni është analizuar ecuria e gjendjeve *cash*, mundësia e krijimit dhe destinacioni i tyre deri në datën 31.12.2008, nga ku ka rezultuar në dukje se për vitin 2008, subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për kursimin e shumës 400.000 lekë në vitin 2008, shumë e cila nuk do të përfshihet në përlllogaritje të kursimeve të mbartura, deklaruar nga subjekti si burim për krijim të pasurive të mëvonshme.

45.1. Referuar edhe deklaramit të subjektit, në DIPPV-në e vitit 2009, në të cilin deklaroi pakësim të gjendjes *cash* të akumuluar deri në datën 31.12.2008, rezulton se gjendja *cash* në fund të vitit 2008, duket se është 0, pra për vitin 2009 nuk mund të pakësohet likuiditeti *cash*, për rrjedhojë, në këtë vit të gjitha pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera nga Komisioni janë vlerësuar me burim të vetëm të ardhurat e këtij viti.

45.2. Nga analiza paraprake e treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, duket se për vitin e mbyllur 2009, subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur pamundësi financiare për krijim të pasurive (blerje e automjetit tip “Opel” në datën 19.12.2009), si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për këtë vit (balanca negative paraprake në vlerë -1.252.914 lekë).

45.3. Në vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013, në të cilat subjekti i rivlerësimi ka deklaruar shtesa në kursime *cash* në vlerë totale 500.000 lekë dhe 17.000 euro²⁷, referuar analizës paraprake të Komisionit rezulton në dukje me balanca negative, përkatësisht në vlerat -427.492 lekë; -1.384.680 lekë; -374.109 lekë dhe -719.299 lekë.

45.4. Duke iu referuar logjikës dhe analizës ligjore dhe financiare, në vitin 2010, mundësia për kursim duket se ka qenë në vlerën 7.308 lekë [(50.000 lekë + 3.700 USD)-427.492 lekë]. Në vitin 2011, nga balanca negative paraprake e rezultuar duket se përveç se nuk ka arritur të kursejë ka shpenzuar edhe kursimet paraardhëse. Edhe në vitin 2012 nuk ka pasur mundësi kursimi, ndërsa në vitin 2013, nga shumat e deklaruara të kursyera 250.000 lekë dhe 11.000 USD, mundësia për kursim duket se ka qenë në vlerën 651.161 lekë [(11.000 USD*101.86 lekë/USD + 250.000 lekë)-719.299] ose rreth 6.000 USD dhe 40.000 lekë.

45.5. Në vitin 2014 nuk janë deklaruar shtesa pakësime të gjendjes *cash*.

45.6. Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “*Pakësuar gjendja cash në shumën 400.000 lekë*”. Në bazë të analizës paraprake financiare, rezultati të ardhura/shpenzime për vitin 2015 duket se ka rezultuar me një balancë negative të llogaritur në vlerën 372.974 lekë.

45.7. Sa më sipër, në fund të vitit 2015, mundësia për gjendje të kursyer në banesë (gjendjet *cash* të llogaritura më 1.1.2014, pakësuar me 400.000 lekë, reduktuar me balancën negative të vitit në vlerën 372.974 lekë), duket se është 21.766 lekë [(6.000 USD*125.79 lekë/USD+40.000 lekë)- 400.000 lekë]-372.974 lekë. Kjo është vlera e likuiditeteve *cash*, që Komisioni ka vlerësuar të përfshijë në analizën paraprake financiare, në çelje të vitit 2016.

45.8. Sa më sipër, mbështetur në dokumentacionin e administruar dhe në deklaramet e subjektit nga Komisioni u krye analiza paraprake financiare për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016, për

²⁷ Në vitin 2010 (50.000 lekë dhe 3.700 USD); në vitin 2011 (2.000 USD); në vitin 2012 (shtesë 200.000 lekë dhe gjendje 6.000 USD, pra shtuar 300 USD); në vitin 2013 (shtesë në lekë 250.000 dhe 11.000 USD).

të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për blerje të pasurive dhe mbulim të shpenzimeve për këtë periudhë, nga ku duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare nga burime të deklaruara të ardhurash për blerjen e dy automjeteve, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016 (balanca negative paraprake në vlerën -1.812.203 lekë).

45.9. Gjithashtu, nga Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, deklaramet e subjektit, si dhe në vazhdim të analizave paraardhëse, u krye një analizë paraprake financiare për periudhën 1.1.2017 – 25.1.2017, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për krijim/gjendje të kursimeve *cash* në vlerat 70.000 lekë dhe 10.200 USD, të deklaruara në deklaratën *Vetting*, si dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë periudhë, nga ku duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare nga burime të deklaruara të ardhurash për krijim të gjendjeve *cash* në shumën 70.000 lekë dhe 10.200 USD, të deklaruara në deklaratën *Vetting* datë 25.1.2017. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

46. Sa i takon ecurisë së likuiditeteve *cash* deri në datën 31.12.2016, pasqyruar nga Komisioni, duke përllogaritur edhe shumën gjendje në fund të çdo viti, subjekti deklaroi se është dakord me analizën e kryer nga Komisioni për shtesat dhe pakësimet e deklaruara çdo vit, përveç deklaramet të vitit 2012. Duke cituar deklarametin e tij në DPV-në për vitin 2012: “*Gjendje likuiditetet në lekë të kursyera për vitin 2012 në shumën 200.000 lekë (në pjesë 100%); gjendja cash në shtëpi nga kursimet e familjes në SHBA, shuma 6.000 USD, subjekti parashtroi se: “Për këtë vit kam pasur shtesë të kursimeve cash në shumën 6.000 USD dhe jo se gjendja e të gjitha kursimeve ka qenë 6.000 USD. Komisioni ka konsideruar se shtesa e kursimeve cash për këtë vit ka qenë 300 USD, duke konsideruar se të gjitha kursimet kanë qenë në fund të vitit 2012 në shumën 6.000 USD. Në DIPP-në e vitit 2012 kam deklaruar gjendje cash në shtëpi nga kursimet e familjes në SHBA, duke iu referuar kursimeve cash të pasura nga bashkëshortja në SHBA gjatë këtij viti. Referuar përcaktimeve në ligjin nr. 9049 dhe jurisprudencës së Kolegjit, deklarimi në rubrikën “Ndryshimi i pasurive dhe burimit të krijimit” të kursimeve cash është konsideruar si shtesë gjatë vitit”*. Duke ndryshuar shtesën e kursimeve *cash* për vitin 2012, ecuria e likuiditeteve *cash* deri në datën 31.12.2016 do të ishte në tabelën si në vijim.

Likuiditet <i>cash</i> deklaruar gjendje në banesë datë 31 dhjetor				
	Në lekë	Në USD	Në lekë	Në USD
Viti	Dekl. DPV		Ref. DPV	
2004			0	
2005	200,000	-	200,000	0
2006	500,000	-	700,000	0
2007	700,000	-	1,400,000	0
2008	- 850,000	-	550,000	0
2009	- 400,000	-	150,000	0
2010	50,000	3,700	200,000	3700
2011	-	2,000	200,000	5700
2012	200,000	6,000	400,000	11,700
2013	250,000	11,000	650,000	22,700
2014	-	-	650,000	22,700
2015	- 400,000	-	250,000	22,700
2016	- 130,000	- 12,500	120,000	10,200

46.1. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, në përfundim të procesit Komisioni vlerësoi se me të drejtë subjekti pretendon se shtesa e likuiditeteve *cash*, deklaruar sipas ligjit në fund të

vitit 2012 ka qenë 6.000 USD dhe jo 300 USD. Ky deklaram jo vetëm që është konform ligjit, i cili kërkon deklaram të shtesës së likuiditeteve, por është në harmoni në gjendjen në fund të vitit 2016, ku kursimet *cash* të disponuara kanë qenë në shumën 10.200 USD dhe 120.000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar kursime *cash* në shumën 10.200 USD dhe 70.000 lekë ose 50.000 lekë më pak, shumë e cila ka logjikë që të jetë pakësuar gjatë muajit janar 2017. Në këtë mënyrë, sikurse me të drejtë subjekti pretendon, deklarimi i gjendjes *cash* në deklaratën *Vetting* përputhet me deklarimin e gjendjes *cash*, deklaruar në DPV-në e vitit 2016. Më tej, gjatë vitit 2016 subjekti ka pasur pakësim të gjendjes *cash* në shumën 12.500 USD dhe 130.000 lekë.

47. Donacione në Credins Bank si vijojnë:

47.1. Balancë kreditore në llogarinë e hapur në euro në vitin 2016, pranë Credins Bank në vlerën 1.500 euro. Në deklaratën *Vetting*, subjekti e ka deklaruar këtë llogari në pjesë takuese 100%, me burim krijimi “sponsorizim për djalin e sëmurë”. Gjithashtu, në seksionin “Të dhëna konfidenciale” e ka deklaruar këtë donacion nga shtetasi T. A., me të cilin deklararon ekzistencën e lidhjes shoqërore. Nga hetimi administrativ në lidhje me këtë llogari rezultoi se:

- Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “Balancë kreditore në llogarinë e hapur për donacion pranë Credins Bank në vlerën 70.000 lekë dhe 1.500 euro”. Në rubrikën “Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari private dhe/ose publike, ndër të tjera, ka deklaruar të ardhura të depozituara në llogarinë e djalit për donacion në Credins Bank në shumën 2.000 euro, ndërsa në seksionin “Dhurata dhe trajtime preferenciale”, pjesë të kësaj deklarate ka deklaruar ndër të tjera “Donacion në Credins Bank nga T. A. shuma 2.000 euro”.

- Referuar të dhënave nga Credins Bank, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.10.2020, rezulton se në datën 20.4.2016 është transferuar në llogari në emër të subjektit në euro në këtë bankë shuma 2.005 euro nga T. A.. Në këtë llogari në datën 31.12.2016, gjendja ka qenë 1.500 euro.

- Në lidhje me burimin e të ardhurave të dhuruesit/personit tjetër të lidhur subjekti në pyetësorin standard ka deklaruar se *burimi i të ardhurave janë kursimet e realizuara nga të ardhurat e pagës*, duke bashkëlidhur dokumente për të vërtetuar të ardhurat e këtij shtetasi për kohën që ka bërë donacionin.

- Në bazë të të dhënave nga QKB-ja (faqja *online*), shtetasi T. D. A. ka qenë ortak dhe administrator i shoqërisë “****” sh.p.k. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.11.2022, informon se shoqëria “****” sh.p.k., regjistruar me NIPT ***, ka shpërndarë dividend në prill 2016, në shumën 9.473.719 lekë.

Sa më sipër, duket se shtetasi T. D. A., në cilësinë e personit tjetër të lidhur, ka pasur të ardhura të dokumentuara për dhënie e shumës 2.000 euro subjektit të rivlerësimit.

- Komisioni ka kërkuar informacion edhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me çështje penale të hetuara me shtetasin T. D. A. apo në cilësinë e ortakut/administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k. për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet²⁸ nuk ka rezultuar që ndaj shtetasit apo personit juridik të sipërcituar të jenë regjistruar procedime penale në ngarkim apo të hetuara nga subjekti i rivlerësimit.

47.2. Balancë kreditore në Credins Bank, vlera 30.000 lekë. Në deklaratën *Vetting*, në seksionin “Të dhëna konfidenciale”, subjekti deklaroi: “Donacion në Credins Bank për djalin e sëmurë shuma e derdhur nga M. N. Gj. në llogari në vlerën 30.000 lekë. Lidhja me subjektin shoqërore”. Nga hetimi administrativ në lidhje me këtë llogari rezultoi se:

²⁸ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.12.2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Në DPV-në e vitit 2016, subjekti deklaroi: *“Donacion në Credins Bank për djalin e sëmurë, shuma e derdhur nga M. N. Gj.j në llogari në vlerën 30.000 lekë. Lidhja me subjektin shoqërore”*.

- Credins Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2020, konfirmon se në datën 4.5.2016, në llogarinë e subjektit është derdhur *cash* shuma 30.000 lekë nga shtetasi M. Gj..

- Komisioni ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me çështje penale të hetuara nga subjekti me shtetasin M. Gj., si shtetas apo në cilësinë e ortakut/administratorit/ të shoqërisë “****” për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet²⁹ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka hetuar procedimin penal nr. ***, viti 2015, me shoqërinë “****” (në cilësinë e palës së dëmtuar) për veprën penale “Vjedhje”, hetim i pezulluar nga subjekti më 14.10.2015.

47.3. Sa më sipër, në kushtet kur subjekti: (i) ka hetuar një procedim penal me palë të dëmtuar shoqërinë “****” sh.p.k., çështje penale e cila është ende nën hetim pasi sipas informacionit të administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezultoi e pezulluar; (ii) në DVP ka konfirmuar marrëdhënien e miqësisë me shtetasin M. Gj. në cilësinë e ortakut të vetëm/administratorit të shoqërisë “****”; (iii) ka pranuar donacion/dhuratë në vlerën 30.000 lekë, duket se subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 5, pika 1, shkronjat “c” dhe “dh/v” të ligjit nr. 9367/2005 dhe në bazë të nenit 17, shkronja “ë” dhe neni 26/1 të Kodit të Procedurës Penale, ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga hetimi i çështjes për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë argumente në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

48. Lidhur me gjendjen e konfliktit të interesit me shtetasin M. Gj., subjekti parashtroi se ky konstatim nuk qëndron drejt në raport me faktet, rrethanat dhe referencat ligjore përkatëse.

48.1. Fillimisht, subjekti i referohet rrethanave dhe arsyeve të çeljes së llogarisë në Credins Bank, me përshkrimin “Llogari e hapur për donacione për djalin e sëmurë” (shkresa nr. *** prot., datë 20.1.2017) për shkak se në vitin 2016, nga konsulta me një mjek me shtetësi dhe kombësi turke në Tiranë, u konstatua se djali i subjektit kishte disa nevoja të veçanta shëndetësore, të cilat mund të diktonin nevojën për të kryer në një të ardhme të afërt një ndërhyrje nëpërmjet një procedure terapie të qelizave staminale, procedurë që ishte tepër e kushtueshme. Për këtë arsye, me sugjerimin e bashkëshortit të kushërirës së babait, z. T. A., është çelur llogaria e posaçme me nr. *** pranë Credins Bank, në monedhën lekë, llogaria nr. ***, në monedhën dollar dhe llogaria nr. *** në monedhën euro, me përshkrimin e veçantë: *“Llogari e hapur për donacione për djalin e sëmurë”*. Sipas subjektit, *një ndër shtetasit që ka dhuruar pranë llogarisë me nr. ***, ka qenë edhe z. M. Gj., i cili ka pasur marrëdhënie njohjeje dhe miqësore me të afërmin tim T. A.. Këtë shtetas e kam takuar vetëm një herë (rreth dy-tre muaj pasi është bërë donacioni nga ana e atij) në vitin 2016, për ta falënderuar për zemërsisht për gjestin e tij dhe nuk e kisha njohur asnjëherë më parë apo të kem pasur marrëdhënie miqësore përpara këtij dhurimi. Lidhja shoqërore që kam cilësuar në deklaratë (është fjala për DPV-në e vitit 2016), ka të bëjë vetëm me njohjen e përbashkët, mikun tonë T. A., njohje e cila për herë të parë u prezantua në vitin 2016”*.

48.2. Subjekti, në vijim i referohet çështjes penale të vitit 2015 mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga një punonjëse e kësaj shoqërie “****” sh.p.k., ardhur nga Drejtoria e Policisë Qarku Tiranë, Komisariati i Policisë nr. ***, për të cilën ka regjistruar më 6.2.2015 procedimin

²⁹ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.12.2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

penal nr. *** për veprën penale “Vjedhje”, parashikuar nga neni 134 i Kodit të Procedurës Penale. Subjekti ka parashtruar në mënyrë të detajuar dinamikën e këtij procedimi, si vijon:

- Në datën 21.1.2015 është marrë njoftim se në fshatin P. është vjedhur kasaforta e firmës “****” “**** & ****”. Policia gjyqësore ka shkuar në vendin e ngjarjes ku ka rezultuar se në fshatin M. është vjedhur kasaforta e firmës “****” “**** & ****”, ku janë vjedhur në ambientin e brendshëm të kësaj firme një sasi eurosh dhe lekësh.

- Nga këqyrja e vendit të ngjarjes dhe pamjeve filmike të kamerave të sigurisë ka rezultuar se rreth orës 02:30 – 02:50, dy persona kanë hyrë nga muri rrethues, më pas njëri ka hyrë në ambientet e brendshme nga dritarja e tualetit, ku në sallon ka lëvizur pozicionin e kamerës me qëllim që të mos identifikohet. Ka hyrë tek zyra e financës dhe ka vjedhur një sasi prej 4.571 euro dhe 600.000 lekësh.

- Në vendin e ngjarjes janë marrë në cilësinë e provës materiale tri gjurmë papilare, si dhe disa objekte, ku një gjurmë është marrë në vendin pranë ku ishte montuar kamera e sigurisë. Gjurmët e gjetura dhe objektet e marra në cilësinë e provës materiale janë dërguar për ekspertime të mëtejshme laboratorike.

- Në lidhje me ngjarjen janë marrë deklarime nga shtetasja K. L. me detyrë recepsioniste dhe menaxhere për hyrjet dhe daljet e vlerave monetare të firmës “****”. Ajo deklaroi se rreth orës 07:30 e ka marrë në telefon shtetasi R. S. dhe i ka thënë të shkojë në punë menjëherë. Kur ka shkuar atje ka parë se i kishin hapur zyrat e punës së saj dhe se tek ambienti ku mban vlerat monetare i kishin vjedhur 4.575 euro dhe 600.000 lekë të rinj, të cilat ajo i kishte lënë brenda në dhomën e arkës sipër kasafortës.

- Në lidhje me ngjarjen janë pyetur si persona të dyshuar shtetasit R. M., J. K., M. R., H. D., G. S., S. I., S. K. dhe R. S., të cilët kanë deklaruar se nuk kanë lidhje me këtë ngjarje apo dijeni për autorët e saj.

- Është administruar akti i ekspertimit vlerësues i provave materiale nr. ***, datë 28.1.2015, nga i cili është konkluduar se në gjurmëkopjuesin, shënuar me shkronjat A dhe B janë gjurmë pëllëmbë të vlefshme për identifikim, gjurmët nuk mund të përcaktohen se nga cila pëllëmbë është formuar dhe se janë të vlefshme për krahasim me rreth të kufizuar personash. Në gjurmëkopjuesin objekt ekspertimi, shënuar me shkronjën C, nuk ka gjurmë papilare të vlefshme për identifikim.

- Është administruar akti i ekspertimit daktiloskopik nr. ***, datë 4.9.2015, ku u konkludua se gjurmët papilare të shënuara me shkronjat A e B, objekt ekspertimi të fiksuara në vendin e ngjarjes, nuk janë formuar në gjendjen që paraqiten kartelat daktiloskopike nga duart e shtetasve A. Ç. dhe A. D..

- Është administruar akti i ekspertimit daktiloskopik nr. ***, datë 11.9.2015, ku u konkludua se gjurmët papilare të shënuara me shkronjat A e B, objekt ekspertimi të fiksuara në vendin e ngjarjes, nuk janë formuar në gjendjen që paraqiten kartelat daktiloskopike nga duart e shtetasit K. L..

48.3. Megjithëse janë kryer të gjitha veprimet e mësipërme, subjekti parashtron se nuk është bërë i mundur zbulimi dhe identifikimi i autorëve të kësaj vepre penale dhe, për pasojë, është vlerësuar nga ana e tij që bazuar në nenin 326/1 të Kodit të Procedurës Penale, ky procedim duhej të pezullohej, duke dërguar aktet pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, Komisariati i Policisë nr. ***, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore për zbulimin e autorit.

48.4. Ndër të tjera, subjekti citon se: “*Vendimmarrja për pezullimin e hetimit dhe veprimet e mësipërme hetimore janë kryer kohë përpara se shtetasi M. Gj. të kryente donacionin për djalin tim, në vlerën 30.000 lekë. Në momentin që kam bërë hetime dhe kam vendosur për pezullimin*”

*e hetimeve në lidhje me këtë procedim penal, unë nuk kam pasur asnjë lloj njohjeje me shtetasin M. Gj., në këto rrethana nuk kam pasur asnjë shkak ligjor për të hequr dorë nga hetimi dhe vendimmarrja në lidhje me këtë procedim. Duke qenë se nuk kisha asnjë lloj njohjeje me këtë shtetas, vendimi i pezullimit ishte marrë kohë më parë, unë edhe pasi jam prezantuar me të nuk më është kujtuar që kam hetuar një çështje me të dëmtuar shoqërinë “***” “*** & ***”, ku ky shtetas është ortak dhe administrator. Momenti i parë që kam rënë në dijeni është pasi jam njohur me rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit”.*

48.5. *Më tej, subjekti sqaron se pasi është marrë vendimi i pezullimit të hetimeve në datën 14.10.2015 dhe dosja i është dërguar Komisionit të Policisë nr. ***, kjo dosje bashkë me aktet hetimore qëndron pranë Komisionit të Policisë dhe është oficeri i policisë gjyqësore pranë komisionit që nëse del ndonjë e dhënë e re që ka të bëjë me nevojën për kryerje të veprimeve të tjera hetimore me qëllim identifikimin e autorit/autorëve të kësaj ngjarjeje, i referon prokurorit duke sugjeruar rifillimin e hetimeve me qëllim kryerjen e këtyre veprimeve hetimore. Pasi prokurori vlerëson se duhen rifilluar hetimet, merr vendim për rifillim të hetimeve dhe urdhëron policinë gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore. Nuk rezulton se oficeri i policisë t’i ketë referuar subjektit asnjëherë ndonjë akt për rifillimin e hetimeve të kësaj çështjeje penale. Ndërkohë në vitin 2016, ky procedim vijonte të ishte i pezulluar dhe jo nën hetim, për sa kohë referuar nenit 326/1 të Kodit të Procedurës Penale, aktet i kaluan Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, e cila në rast të evidentimit të provave të reja, referon rifillimin e hetimeve për këtë procedim, fakt i cili nuk ka ndodhur. Fashikulli është dërguar pranë Prokurorisë nga Komisioni i Policisë Vorë, më 24.3.2020, për parashkrim të ndjekjes penale. Dosjet penale me objekt parashkrimin e ndjekjes penale, në bazë të urdhrit të Drejtuesit të Prokurorisë për ndarjen e seksioneve, i kalojnë drejtpërdrejt seksionit të ekzekutimeve penale të formës së prerë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe ju caktohet për veprime dhe trajtimin e materialit prokurorëve të këtij seksioni. Unë në seksionin e ekzekutimeve penale të formës së prerë nuk kam ushtruar funksionin e prokurorit. Nga dokumentacioni që do vë në dispozicion, rezulton se për trajtimin e këtij materiali është caktuar prokurori pranë seksionit të ekzekutimeve të vendimeve penale të formës së prerë z. E. B (bashkëlidhur praktika e vendimmarrjes).*

48.6. *Pra, siç vërehet, subjekti argumenton se nuk ka vepruar në shkelje të ligjit, duke iu referuar Kodit të Procedurës Penale që trajton konfliktin e interesit, konkretisht neneve 26 dhe 17 të tij, e duke pretenduar se nuk ndodhet në asnjë prej pikave të parashikuara në këto dispozita ligjore.*

48.7. *Po kështu, subjekti i referohet edhe nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, që përcakton llojin e interesave privatë të zyrtarit, duke pretenduar se nuk është në asnjë nga rastet e parashikuara në këtë dispozitë ligjore.*

48.8. *Në përfundim, duke deklaruar me përgjegjësi të plotë që unë këtë shtetas (M. Gj.) as nuk e njihja personalisht, dhe aq më pak të kisha dijeni që ai ishte ortak/administrator i shoqërisë “***” sh.p.k., subjekti pretendon se nuk ka pasur asnjë shkak ligjor për të kërkuar dorëheqjen dhe se ka përmbushur plotësisht detyrën e prokurorit duke urdhëruar dhe kryer veprimet e domosdoshme hetimore, si për çdo çështje tjetër, dhe më pas ka vendosur pezullimin për shkak të mosidentifikimit të autorit, pa u ndikuar në vendimmarrjen e tij nga asnjë rrethanë e caktuar që do të përbënte konflikt të mundshëm interesi. Sipas subjektit, vendimmarrja e tij në lidhje me këtë procedim penal ka qenë ligjore, profesionale, objektive, por jo në interes të shoqërisë “***” sh.p.k. apo z. M. Gj.. Për të mbështetur këto deklaratime, subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë noteriale të lëshuar nga z. M. Gj., në të cilën deklaroi momentin e njohjes dhe rrethanat e kryerjes së donacionit.*

48.9. Në përfundim të procesit, Komisioni, në analizë të çdo parashtrimi e dokumentacioni të administruar, vlerësoi se subjekti vërtetoi bindshëm të kundërtën e konstatimit të Komisionit: *Duket se subjekti ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 5, pika 1, shkronjat “c” dhe “dh/v” të ligjit nr. 9367/2005 dhe në bazë të nenit 17, shkronja “ë” dhe 26/1 të Kodit të Procedurës Penale, ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga hetimi i çështjes për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, arsyetuar si vijon:*

- Nga hetimi nuk kanë rezultuar të dhëna që të vërtetojnë se subjekti njëhej me shtetasin M. Gj. në kohën e trajtimit të procedimit penal (viti 2015) me të dëmtuar shoqërinë “*** & ***” sh.p.k, ku ky shtetas është ortak dhe administrator.

- Nuk u vërtetua asnjë arsye apo motiv që tregon njëanshmëri të subjektit në trajtimin e procedimit në fjalë, si për shkaqe ligjore, ashtu edhe për shkaqe personale apo të ndonjë interesi të mundshëm. Për më tepër, shoqëria “*** & ***” sh.p.k. ka qenë në cilësinë e palës së dëmtuar. Për rrjedhojë, vendimi i pezullimit të hetimeve i marrë nga subjekti i rivlerësimit, duket qartazi që nuk është një vendim në favor të shoqërisë apo shtetasit M. Gj., ortak dhe administrator i saj.

- Nga verifikimi i veprimeve hetimore të kryera rezulton se subjekti ka përmbushur plotësisht detyrën e prokurorit, duke urdhëruar sipas ligjit kryerjen e veprimeve hetimore të nevojshme, të cilat janë përpara se shtetasi M. Gj. të kryente donacionin për djalin e tij në vlerën modeste prej 30.000 lekësh dhe më pas ka vendosur pezullimin për shkak të mosidentifikimit të autorit, pa u ndikuar në vendimmarrje nga asnjë rrethanë e caktuar kohore që do të përbënte konflikt të mundshëm interesi.

- Nga aktet në dosje nuk rezulton që ky procedim penal t’i jetë vënë në dispozicion subjektit pas momentit që ai ka vendosur pezullimin e hetimeve. Përkundrazi, rezulton se ky fashikull është dërguar për herë të parë pranë Prokurorisë nga Komisariati i Policisë *** në datën 24.3.2020, *për parashkrim të ndjekjes penale.*

49. Balancë kreditore në Credins Bank, vlera 100.000 lekë për të cilën në deklaratën Vetting, në seksionin “Të dhëna konfidenciale”, subjekti deklaroi: “Donacion në Credins Bank për djalin e sëmurë nga shtetasi G. Xh. S.. Vlera: 100.000 lekë. Lidhja me subjektin shoqërore”. Nga hetimi administrativ në lidhje me këtë llogari rezultoi se:

- Në DVP-në e vitit 2016, subjekti deklaroi: *“Donacion në Credins Bank për djalin e sëmurë nga shtetasi G. Xh. S.. Vlera: 100.000 lekë. Lidhja me subjektin shoqërore”.*

- Në pyetësin standard, subjekti deklaroi: *“Sponsorizim në shumën 100,000 lekë, për djalin e sëmurë, e kryer nëpërmjet transfertës bankare nga z. G. Xh. S., në datën 18.4.2016, në llogarinë e hapur, në të njëjtën monedhë, pranë Credins Bank; burimi i të ardhurave: kursimet e realizuara nga të ardhurat e pagës”.*

- Credins Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2020, konfirmon se në datën 18.4.2016, në llogarinë e subjektit është transferuar nga shtetasi G. Xh. S., shuma 100.000 lekë, me përshkrimin “Sponsorizim”.

- Sa i takon burimit të të ardhurave të shtetasit G. Xh. S.:

a. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësit nr. 1, ka depozituar: (i) një vërtetim të shoqërisë “***” sh.p.k. që deklaroi se punonjësi G. Xh. S., i punësuar si jurist për periudhën janar 2014 – maj 2016 është paguar me pagë mujore 50.000 lekë dhe për periudhën qershor 2016 – mars 2019 është paguar me pagë mujore 100.000 lekë.

b. Me vërtetimin nr. *** prot., datë 15.11.2022, dega e Arkivit Tiranë informon Komisionin se për subjektin “***” sh.p.k. në periudhën prill 2015 – prill 2016 nuk administrojnë asnjë dokumentacion.

c. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.11.2022, informon se shoqëria “****” sh.p.k., regjistruar me NIPT *** (në të cilën shtetasi G. S. ka zotëruar 70% të kuotave) ka realizuar fitim pas tatimit për vitet 2014 dhe 2015, përkatësisht 261.556 lekë dhe 403.968 lekë (në total 665.524 lekë), nuk ka shpërndarë dividend, ndërsa referuar dokumentacionit bashkëlidhur shkresës në vitin 2016 kjo shoqëri rezulton me humbje, ndërsa në periudhën tatimore (1607) është shpërndarë dividend shuma 121.190 lekë dhe është llogaritur tatim në masën 18.179 lekë.

ç. Referuar kuotave zotëruese të kapitalit të kësaj shoqërie, shtetasi S. ka përfituar 72.108 lekë (121.190 lekë -18.179 lekë*70%). Shpenzimet jetike sipas standardit të INSTAT-it dhe ILDKPKI-së, për një person për vitet 2014 dhe 2015, llogariten përkatësisht 219.998 lekë dhe 224.276 lekë.

49.1. Sa më sipër, në përfundim të hetimit, nga Komisioni u vlerësua që ky dhurim/donacion të pasqyrohet me rezervë në analizën paraprake financiare, por subjekti i rivlerësimit duhet të vërtetojë burimin e deklaruar të të ardhurave të personit të lidhur për dhënien e shumës 100.000 lekë në datën 18.4.2016.

49.2. Në parashtrimet e veta për të provuar me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e shtetasit G. S., subjekti ka vënë në dispozicion vërtetimin për bazën e vlerësuar, lëshuar në datën 24.11.2023, ku rezulton se nga viti 2012 ka përfituar të ardhura bruto nga paga në shumat mbi pagën maksimale (në vërtetim është paga maksimale për të cilat është paguar kontributi). Të ardhurat në vitet 2015 dhe 2016 janë 50.000 lekë çdo muaj. Bashkëshortja e tij, sipas vërtetimit për bazën e vlerësuar, lëshuar në datën 24.11.2023 nga muaji janar 2016 ka përfituar pagë mbi kufirin e pagës maksimale. Bazuar në vërtetimet e gjeneruara për të ardhurat, rezulton se sikurse subjekti pretendon, shtetasi G. S. ka pasur mundësi financiare që me të ardhura të ligjshme të dhurojë shumën 100.000 lekë.

Likuiditete cash në vlerën 7.451 euro nga lojërat e fatit

50. Në DVP-në e vitit 2011 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se: “*Ka fituar nga lotari sportive tek shoqëria “****” më 6.11.2010 (bileta me seri ***, *** dhe ***) vlerën 7,451 euro.* Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* ka depozituar: (i) vërtetim datë 7.11.2010, lëshuar nga kompania “****” sh.a. që vërteton se shtetasi Valentin Preçi i identifikuar me kartë identiteti nr. *** ka fituar neto pranë kompanisë “****” në datën 6.11.2010, gjithsej shumën 7.451 euro, nga biletat me numër serie ***, ***, *** dhe ***.

50.1. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga lotot sportive gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

- Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 9.3.2016, subjekti deklaroi se konfirmon shumën e fituar në lotari dhe paraqet vërtetimin datë 7.11.2010, të lëshuar nga administratori i kompanisë “****” sh.a.

- Subjekti nuk ka deklaruar ndër vite destinacionin e shumës 7.451 euro. Nga leximi i deklaratave periodike rezultoi se të ardhurat nga lojërat e fatit nuk janë deklaruar si gjendje *cash* në DIPP-të për vitet 2012, 2013 e në vijim (shtesa apo pakësime).

- Në pyetësin nr. 2, subjekti i pyetur në lidhje me destinacionin e shumës 7.451 euro, sqaron se: “*Lidhur me pyetjet e parashtruara nga ana juaj, sqaroj se në datën 6.11.2010 kam qenë së bashku me vëllain tim, shtetasin A. P., për të pirë një kafe pranë një bar-kafeje, ndodhur tek Rruga e *** (me sa më kujtohet e ka pasur emrin sallon ***). Vëlla im, i apasionuar në sport, vendosi që të tentonte fatin e tij, duke vendosur këto bileta dhe duke përzgjedhur disa ndeshje, duke më kërkuar dhe mua që merrja pjesë në këto bileta. Me sa më kujtohet, shuma që kam vendosur është 50 euro për të gjitha biletat dhe të nesërmen më njoftojnë që i kisha fituar të pesta, duke i tërhequr ato në pikën e ambientit ku mora edhe biletat. Për të konfirmuar këtë*

fakt, paraqes vërtetimin e lëshuar nga administratori i shoqërisë dhe menaxheri i saj, ku kam tërhequr shumat. Kjo është hera e parë dhe e fundit që kam vendosur bileta. Lidhur me detyrimet tatimore, pasi jam interesuar për pagimin e tyre, më informuan se vlera e detyrimeve tatimore më është mbajtur në burim nga vetë shoqëria (shuma e deklaruar është shuma neto e përfitur), pasi këto detyrime i ka paguar vetë shoqëria. Për të ardhurat neto të përfituara, shoqëria përllogariste të ardhurat bruto dhe shumën e tatimit që duhej paguar në burim. Shoqëria ka zhveshur të ardhurën nga tatimi dhe shuma e përfitur nga mua përfaqësonte shumën neto të të ardhurave. Lidhur me destinacionin e shumës, deklaroj se me sa kujtoj, duke qenë se pjesëmarrës në këto bileta ishte edhe vëllai, një pjesë e tyre ia kam dhënë atij dhe unë kam mbajtur një shumë të përafërme prej 4.000 euro, të cilën e kam shpenzuar po atë vit për shpenzime jetike. Lidhur me pyetjen e fundit, deklaroj se nuk kam marrë pjesë asnjëherë tjetër në lojërat e fatit, përveçse në këtë rast të deklaruar nga ana ime”.

50.2. Në mbështetje të shpjegimeve, subjekti ka depozituar vërtetim datë 7.11.2010, lëshuar nga kompania “****” sh. a., administruar më parë nga Komisioni.

50.3. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit duket se: (i) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për fitimin e shumës 7.451 euro, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit; (ii) ka deklarime kontradiktore për personin që ka blerë biletat dhe shumën e përfitur nga subjekti, pasi në deklarin periodik vjetor 2011 dhe në procesverbalin e ILDKPKI-së datë 9.3.2016 është deklaruar e përfitur shuma 7.451 euro, ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 2 është deklaruar një shumë e përafërme prej 4.000 euro; (iii) nuk provohet përfitimi i kësaj shume dhe subjekti nuk ka deklaruar në deklarin e interesave periodikë privatë destinacionin e shumës 7.451 euro të tërhequr nga kompania; (iv) subjekti deklaroi se destinacioni i të ardhurave, shuma prej 7.451 euro, u përdor vetëm për shpenzime jetike po në vitin 2011, për një periudhë disamujore, të cilat nëse do të ishin të tilla duhet të deklaroheshin si shpenzime referuar parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003.

50.4. Të ardhurat e deklaruara të fituara në lotari sportive pranë kompanisë “****” sh.p.k., në datën 6.11.2010, në shumën 7.451 euro, është vlerësuar të mos përfshihen në analizën paraprake të treguesve financiarë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

51. Subjekti i nis parashtrimet e veta me faktin se të ardhurat nga lotot sportive nuk janë përdorur nga ana e tij për krijimin e ndonjë pasurie të caktuar. Sipas subjektit, këto të ardhura janë deklaruar në DPV-në e vitit 2011, saktësisht sikundër ka ndodhur, duke u munduar të jetë i sinqertë dhe korrekt me detyrimin ligjor për çdo të ardhur të ligjshme që mund të përfitohej në rrethana të caktuara. Në vijim, sikurse edhe gjatë hetimit administrativ, subjekti shpjegon rrethanat në të cilat ka fituar shumën 7.451 euro nga lotot sportive. Subjekti kundërshtoi faktin që ka qenë kontradiktor në deklarime, duke pretenduar se ky fakt nuk është i vërtetë, pasi shuma e përfitur nga biletat e fituara është saktësisht 7.451 euro, por, sikurse ka sqaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka mbajtur vetëm shumën 4.000 euro, të cilën e ka përdorur për shpenzime e atij viti, ndërsa pjesën tjetër ia ka dhënë vëllait, meqenëse ishte ai shkaku i vënies së biletave. Subjekti nënvizon se në përgjigje të pyetjes nr. 11 të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar qartë që vetëm shuma prej 4.000 euro është përdorur për shpenzime jetike, ndërsa pjesa tjetër i është dhënë vëllait të tij.

51.1. Lidhur me mosdeklarimin e shpenzimeve referuar parashikimeve ligjore të ligjit nr. 9049/2003, subjekti sqaroi se një deklarim i tillë nuk është bërë pasi ligji specifik nuk kërkonte deklarimin e këtyre shpenzimeve, pavarësisht vlerës së tyre. Deklarimi i pasurive është bërë në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, neni 4 i të cilit parashikon objektin e deklarimit. Nga përmbajtja e kësaj dispozite është lehtësisht e

konstatueshme se subjektet kishin detyrim vetëm deklarimin e pasurive të paluajshme dhe të luajshme të regjistrueshme në regjistrat publikë, si dhe sendeve me vlerë të veçantë mbi 5.000 USD. Edhe për sa i përket deklarimeve periodike vjetore, zyrtari publik kishte detyrimin për deklarimin e atyre shpenzimeve që passillnin ndryshime (shtesa apo pakësime) pikërisht për këto pasuri. Subjekti vijon të parashtroje se ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, ka pësuar ndryshime lidhur me objektin e deklarimit, me ligjin nr. 85/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, konkretisht në nenin 3 të tij, ku u vendos detyrimi për deklarimin e shpenzimeve me vlerë mbi 500.000 lekë.

51.2. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi administrativ, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, në përfundim të procesit Komisioni nuk mund të arrijë në konkluzionin se shuma e deklaruar si e përfituar nga lotot sportive është një shumë e përfituar nga ndonjë veprim i kundërligjshëm i subjektit të rivlerësimit, arsyetuar si vijon:

- Nuk qëndron konstatimi se ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për fitimin e shumës 7.451 euro, përderisa kjo shumë është vërtetuar me një dokument shkresor të përpiluar dhe paraqitur në kohë reale, vërtetimin e datës 7.11.2010, lëshuar nga kompania “****” sh.a. Po kështu, subjekti e ka deklaruar përfitimin e kësaj shume që në DVP-në e vitit 2011 e, në vijim, sa herë sipas ligjit i është dashur të japë deklarime.

- Nuk qëndron konstatimi se subjekti ka kryer deklarime kontradiktore për shumën e përfituar pasi në DVP-në e vitit 2011 dhe në procesverbalin e ILDKPKI-së datë 9.3.2016 është deklaruar e përfituar shuma 7.451 euro, ndërsa në pyetësit nr. 2 është deklaruar një shumë e përafërme prej 4.000 euro. Kjo për shkak se subjekti në DVP-në e vitit 2011 ka deklaruar saktësisht faktin real që ka ndodhur, shumën e përfituar nga loto sportive në shumën 7.451 euro, vërtetuar me një dokument shkresor të përpiluar dhe paraqitur në kohë reale. Për më tepër, subjekti nuk e ka deklaruar shumën 7.451 euro si burim për krijimin e ndonjë pasurie apo ndonjë likuiditeti *cash* e, për rrjedhojë, nuk ka pse të mos konsiderohet i besueshëm deklarimi i tij gjatë procesit se nga kjo shumë vetëm 4.000 euro e ka përdorur për shpenzime jetike gjatë vitit 2011, ndërsa pjesën tjetër ia ka dhënë vëllait. Sa i takon konstatimit se shpenzimet duhet të deklaroheshin si shpenzime, pretendimi i subjektit qëndron pasi për herë të parë detyrimi për deklarimin e shpenzimeve të deklarueshme ka lindur me ndryshimet që pësoi ligji nr. 9049/2003 me ligjin nr. 85/2012.

- Nuk qëndron konstatimi se nuk provohet përfitimi i kësaj shume dhe subjekti nuk ka deklaruar në deklarimin e interesave periodikë privatë destinacionin e shumës 7.451 euro të tërhequr nga kompania, pasi: (i) përfitimi i shumës është vërtetuar me një dokument shkresor dhe praktikisht kalimi i shumave të përfituara nga lotot sportive nuk bëhet në rrugë bankare; (ii) nuk ka qenë detyrim ligjor deklarimi i destinacionit të shumës, përderisa në vitin 2011 subjekti nuk ka pasur as detyrimin për ta deklaruar shpenzimin.

- Sa i takon legjitimitetit të të ardhurës së përfituar nga loto sportive, është e vërtetë që nuk ka një provë konkrete që të vërtetojë pagimin e detyrimeve tatimore por, nga ana tjetër, detyrimi ligjor për pagimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e përfituara nga loto sportive ka qenë i kompanisë sportive që është shitëse e biletave sportive dhe shuma 7.451 euro është fitim neto i përfituar nga subjekti pasi është mbajtur tatimi në burim mbi të ardhurën e përfituar nga kompania shitëse sipas ligjit nr. 8438, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

51.3. Në këto kushte, Komisioni, duke i vlerësuar bindëse provat dhe shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit, vlerësoi që në analizën financiare të rishikuar, shumën 4.000 euro ta konsiderojë si të ardhur për vitin 2010. Por edhe në rastin e mosmarrjes së tyre në konsideratë të këtyre të ardhurave analiza financiare për vitin 2010 nuk afektohet, pasi në analizën financiare të rishikuar ky vit rezulton me një balancë pozitive prej 178.289 lekësh.

Gjetje të tjera

52. Në lidhje me përdorimin e një apartamenti

52.1. Gjatë hetimit administrativ nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni rezultoi se më 8.7.2015 subjekti ka nënshkruar një kontratë huapërdorje me shtetasin D. M. tek noterja M. Sh. .

52.2. Nga hetimi administrativ në lidhje me këtë pasuri rezultoi se:

- Komisioni, në pyetësonin nr. 2, pyeti subjektin në lidhje me qëllimin e huas, i cili sqaroi se: *“Pikësëpari dua të theksoj se kontrata e nënshkruar nuk është kontratë huaje bankare, por huapërdorje, me qëllim kërkimin e një shtëpie me qira në zonën afër shkollës “***”. Kjo kontratë është hartuar për arsye të distancës së afërme me shkollën “***”, ku do regjistronim vajzën tonë Vivienne në klasën e parë, për të krijuar kushte sa më të afërme me familjen. Por, nga kërkimet tona në atë zonë për një banesë me qira ndodhi që nuk arrita dot të gjeja një shtëpi të përshtatshme dhe që të na përshtatej për kushtet familjare. Kur po afrohej afati i regjistrimit, i kam kërkuar shtetasit D. M. , i cili është miku im, nëse kishte ndonjë njohje me ndonjë person, apo kishte dijeni që dikush donte të lëshonte një shtëpi me qira në atë zonë, dhe nëse po, të më lajmëronte, duke i treguar dhe arsyen përse doja të lëvizja me qira. Ky shtetas më ofron mundësinë që derisa të gjej këtë banesë të përshtatshme, të qëndroj në banesën e tij për një periudhë njëvjeçare, duke hartuar këtë kontratë të përkohshme për këtë banesë, në formën e huapërdorjes (pra, pa kundërshtim). Ndërkohë, rezultoi që pas disa kohësh kur ne nënshkruam kontratën, pak ditë përpara se vajza të fillonte procesin mësimor, bashkëshortja ime dhe unë vajtëm tek banesa e shtetasit D. M. dhe pamë ambientin e banesës së marrë me huapërdorje. Duke qenë se bashkëshortes sime nuk iu duk ambient i përshtatshëm për të jetuar, vendosëm të mos qëndronim asnjë ditë atje, duke e shuar marrëdhënien verbalisht. Nuk kemi shkuar të bëjmë revokim të kësaj kontrate, pasi nuk e pamë të arsyeshme për sa kohë kontrata nuk u zbatua ndonjëherë, nuk sollim pasojat konkrete mbi posedimin e saj dhe marrëdhëniet ishtë e tillë që nuk shprehte domosdoshmëri për të shkuar përpara noterit për ta revokuar”.*

- Komisioni administroi dokumentacionin e përcjellë nga noterja M. Sh. ³⁰, nga ku rezultoi se huadhënësi D. M. , më 8.7.2015, nëpërmjet kontratës së huapërdorjes nr. *** rep., nr. *** kol., i ka dhënë në përdorim pa kundërshtim një sipërfaqe prej 25 m² nga apartamenti me sip. 104.26 m², me vendndodhje rruga “***”, hyrja ***, apartamenti ***, regjistruar në ZRPP, vol. ***, z. k. *** huadhënësit, subjektit të rivlerësimit në cilësinë e huamarrësit. Afati sipas kontratës është njëvjeçar.

- Nga dokumentacioni ka rezultuar se pasuria apartament është regjistruar në favor të shtetasit D. M. , nëpërmjet kontratës së shkëmbimit nr. ***³¹, datë 4.3.2013, të pasurisë garazh me sip. totale 24.50 m², në rrugën “***” të zotëruar prej tij me pasurinë apartament të sipërcituar në pronësi të shtetasve G. I. dhe R. I.

- Në lidhje me verifikimin e mundësisë së shtetasit D. M. për ta përfutur këtë apartament nëpërmjet shkëmbimit, Komisioni, bazuar në nenet 30 e 45 të ligjit nr. 84/2016, e shtriu hetimin në lidhje me pasurinë apartament me qëllim verifikimin e çdolloj lidhjeje të subjektit me pasurinë në pronësi të shtetasit D. M. ³² Konkretisht:

a. Komisioni i kërkoi informacion FSHU-së dhe me shpresën e administruar nr. *** prot., datë 25.9.2023, FSHU-ja vendosi në dispozicion informacionin nga ku rezulton se: (i) me gjeneralitetet D. M. rezulton një kontratë aktive me nr. ***, në Tiranë, kategoria familjare më

³⁰ Shkresë e administruar në Komision me nr. *** prot., datë 17.11.2022.

³¹ Shkresë kthim përgjigjeje, administruar në Komision me nr. *** prot., datë 27.2.2023.

³² Vendimi nr. 15/2019 (JR), datë 17.7.2019 (KPA).

adresë “*** pranë kompleksit ***”; (ii) kontrata është hapur në datën 29.3.2004 dhe më pas në datën 10.12.2013 është bërë ndryshim i abonentit nga G. I. në D. M. .

b. Komisioni administroi edhe dokumentacionin e përcjellë nga noter J. Zh.³³, në lidhje me praktikën e shitblerjes së pasurisë garazh, nga ku rezultoi se në datën 1.3.2013 shtetasi D. M. e ka blerë nga shtetasit A. H. dhe A. H. pasurinë e llojit garazh me sip. 24.50 m², regjistruar në ZRPP Tiranë në zonën kadastrale ***, me nr. pasurie ***, me adresë rruga “***” kundrejt çmimit 2.327.500 lekë, paguar jashtë zyrës noteriale.

c. Komisioni ka kërkuar informacion edhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë³⁴ lidhur me çështje penale të hetuara me shtetasin z. G. I. apo me shoqërinë “***” sh.a. apo me ortakun (ët)/administratorin (ët)/përfaqësuesin e administratorit për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë për subjektin e rivlerësimit.

52.3. Sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit, duket se: (i) në DVP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përdorimin e kësaj pasurie në përputhje me detyrimin ligjor; (ii) fakti që ajo është dhënë pa kundërshtim dhe pa u shpjeguar në asnjë mënyrë arsyet e një marrëdhënieje të tillë dhe, për më tepër, nuk është deklaruar përdorimi i saj, e bëjnë të pabesueshëm dhe të dyshimtë pretendimin e subjektit se kontrata nuk u zbatua ndonjëherë, nuk solli pasoja konkrete mbi posedimin e saj dhe marrëdhënia ishte e tillë që nuk shprehte domosdoshmëri për të shkuar përpara noterit për ta revokuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

53. Në parashtrimet e veta, subjekti pretendon ashtu sikurse ka sqaruar qartësisht edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 1 se ai nuk ka qenë në kushtet e deklarimit të përdorimit të kësaj pasurie për shkak se nuk e ka përdorur asnjë ditë atë. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti i referohet faktit se kontrata e huapërdorjes datë 8.7.2015 me shtetasin D. M. është hartuar për arsye të aksesimit sa më të favorshëm të vajzës, e cila do të studionte pranë shkollës “***”, pas bisedës paraprake me këtë shtetas, i cili i ka ofruar mundësinë që derisa të gjente një banesë të përshtatshme, të qëndronte në banesën e tij (një dhomë) për një periudhë njëvjeçare. Pasi e panë ambientin (një dhomë 25 m²) dhe nuk iu duk i papërshtatshëm për të jetuar aty, kanë zgjidhur marrëveshjen verbalisht³⁵. Këtë fakt e konfirmon edhe shtetasi D. M. sipas deklaratës noteriale të datës 5.12.2022. Ndodhur në këto kushte, sipas subjektit, nuk është deklaruar përdorimi i kësaj banese, për sa kohë marrëveshja nuk i pati asnjëherë efektet e saj juridike, pasi nuk u ekzekutua.

53.1. Në analizë të të gjitha provave të administruara, Komisioni vlerësoi të bazuara pretendimet e subjektit referuar fakteve e rrethanave si vijojnë: (i) nga leximi i deklarimeve vjetore periodike pas DVP-së së vitit 2015, nuk rezultoi që subjekti të ketë deklaruar ndonjëherë adresën e pasurisë së shtetasit D. M. si vendbanim apo si adresë të gjendjes civile; (ii) nuk u vërtetua që subjekti apo bashkëshortja e tij të kenë kryer ndonjë pagesë kundrejt OSHEE-së apo UKT-së për banesën e këtij shtetasi për periudhën e huapërdorjes; (iii) informacioni i marrë nga OSHEE-ja dhe UKT-ja vërteton pagesat për banesën në pronësinë e subjektit në të njëjtën periudhë. Pra, gjatë kësaj periudhe subjekti ka konsumuar energji elektrike dhe ujë në banesën e tij, fakte që vërtetojnë se familja e tij nuk ka lëvizur për të qëndruar në ndonjë banesë tjetër. Për më tepër, sipërfaqja prej 25 m² objekt i kontratës së

³³ Shkresë protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.9.2023.

³⁴ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.9.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

³⁵ Subjekti i referohet nenit 676 të Kodit Civil, i cili parashikon se kontrata quhet e lidhur kur palët kanë shfaqur në mënyrë të ndërsjellë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj. Shfaqja e vullnetit mund të jetë e shprehur ose në mënyrë heshtësore.

huapërdorjes, pjesë përbërëse e apartamentit me sip. 104.26 m², në pronësi të shtetasit D. M. , i bën të besueshme pretendimet e subjektit se ambienti nuk ishte i përshtatshëm për banim.

53.2. Bazuar në sa më sipër, në përfundim të procesit, Komisioni nuk ka pasur dyshime në lidhje me pasurinë objekt i kontratës së huapërdorjes, e cila duket se është hartuar vetëm për efekt të shkollimit të vajzës së subjektit pranë shkollës “***”, duke mos u ekzekutuar nga palët, si dhe krijoji bindjen se subjekti nuk ka gëzuar asnjëherë të drejtën e përdorimit dhe asnjë lloj të drejte tjetër reale mbi sip. 25 m², me qëllim që sipas pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 të kishte detyrimin për deklarimin e përdorimit të saj.

53.3. Personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar automjet tip “Volkswagen Jetta”, viti i prodhimit 2010, në pjesë 100%, blerë nga R. D. J. në ***, NY, SHBA, për 3.250 USD, më 6.10.2016, nga kursimet e familjes. Automjeti është i regjistruar në Ulster County Department of Motor Vehicles, me adresë *** F. St, K., NY, USA *** (duke bashkëlidhur edhe faturën e blerjes së automjetit datë 10.6.2016) gjatë hetimit administrativ në lidhje me këtë mjet rezultoi se në DIPPV-në vitit 2016, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar, blerë nga bashkëshortja në SHBA, New York, automjetin tip “Volkswagen Jetta”, në datën 6.10.2016, në shumën 3.250 USD, me të ardhurat *cash* të familjes. Nga Komisioni blerja e kësaj pasurie është pasqyruar në analizën paraprake financiare të vitit 2016, nga ku rezultoi në dukje një balancë negative (analizuar më sipër në pasuritë “kursime *cash*”). Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka paraqitur pretendimet e tij në lidhje me analizën financiare, trajtuar hollësisht në paragrafin më poshtë.

Analiza paraprake e treguesve financiarë

54. Analiza paraprake e treguesve financiarë³⁶ është kryer nga Komisioni për periudhën nga fillimi i detyrës së subjektit të rivlerësimit deri në datën 31.12.2016 (dhe jo vetëm), mbështetur në dokumentacionin e disponuar, si dhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur (bashkëshortes). Në analizë të burimit të të ardhurave për krijimin e pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe mundësisë financiare për këto burime, përveç sa pasqyruar/analizuar më lart në këtë vendim, duket se për vitet e mbyllur 2009, 2010, 2012, 2013 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të deklaruara/dokumentuara, për blerje/krijim të pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për këto vite. Balanca negative, në dukje, përkatësisht në vlerat -1.252.914 lekë; -427.492 lekë; -374.109 lekë; -719.299 lekë dhe -372.974 lekë.

54.1. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i ka kaluar barra e provës për të dhënë argumente në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

55. Lidhur me analizën e përgjithshme financiare dhe balancat negative të konstatuara, në parashtrimet e veta subjekti ka bërë prezent në mënyrë shumë të detajuar pretendimet e tij për çdo vit, duke iu referuar konstatimeve të Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ, duke paraqitur nga njëra anë pretendime dhe argumente për çdo konstatim dhe balancë negative në dukje dhe, nga ana tjetër, kërkesat për rishikimin e analizës financiare për çdo zë që kundërshtohet. Pretendimet e subjektit janë trajtuar rast pas rasti në këtë vendim gjatë trajtimit të pasurive, burimeve të tyre dhe deklaratimeve të subjektit, krahasimisht me çdo provë e dokument të administruar gjatë hetimit administrativ.

55.1. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti ka kërkuar rishikimin e analizës financiare vit pas viti si vijon:

³⁶ Bashkëlidhur në aneksin e këtij relacioni, analiza paraprake financiare së bashku me shpjegimet përkatëse.

- **Për vitin 2009** subjekti kërkon rishikimin e analizës financiare duke ngritur pretendime e paraqitur dokumente shkresore në lidhje me: (i) të ardhurat nga paga e bashkëshortes në shumën 300.000 lekë; (ii) të ardhurat në SHBA nga “Cash Issuance History” dhe nga “Assistance Group Eligibility History”; (iii) të ardhurat nga marrëdhënia e punës së bashkëshortes me shoqërinë “P. C.”; (iv) mbulimin e kësteve të kredisë nga vjehri; (v) të korrigjohet ndryshimi likuiditeteve në fund të vitit; (vi) të rishikohen shpenzimet e telefonit; (vii) të rishikohen shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit jashtë vendit. Sipas përlllogaritjeve të tij, analiza financiare paraprake për vitin 2009, pas korrigjimit të zërave, paraqitet me një balancë pozitive +627.560 lekë.

- **Për vitin 2010** subjekti kërkon rishikimin e analizës financiare duke ngritur pretendime e paraqitur dokumente shkresore në lidhje me: (i) të ardhurat nga “Assistance Group”; (ii) mbulimin e kësteve të kredisë nga vjehri; (iii) rishikimin e shpenzimeve telefonike; (iv) rishikimin e shpenzimeve të qëndrimit në SHBA. Sipas subjektit, analiza financiare paraprake për vitin 2010, pas korrigjimit të zërave sipas parashtrimeve më lart, paraqitet me një balancë pozitive +109.598 lekë.

- **Për vitin 2011** subjekti mungon të ketë dhënë parashtrime specifike.

- **Për vitin 2012** subjekti kërkon rishikimin e analizës financiare duke ngritur pretendime e paraqitur dokumente shkresore në lidhje me: (i) kthimin e shumës 5.000 euro kumatit L. D. në vitin 20102, e cila sipas tij duket të konsiderohet si e ardhur e ligjshme në analizën e vitit 2011; (ii) të ardhurat nga Assistance Group; (iii) shpenzimet e qirasë të llogariten si pjesë përbërëse e shpenzimeve të jetesës; (iv) shpenzimet e jetesës në SHBA. Sipas subjektit, analiza financiare paraprake për vitin 2012 pas korrigjimit të zërave, paraqitet me një balancë negative -282.505 lekë.

- **Për 2013** subjekti kërkon rishikimin e analizës financiare duke ngritur pretendime e paraqitur dokumente shkresore në lidhje me: (i) të ardhurat nga Assistance Group; (ii) shpenzimet e qirasë; (iii) shpenzimet jetike. Sipas subjektit, analiza financiare paraprake për vitin 2013 pas korrigjimit të zërave sipas parashtrimeve më lart, paraqitet me një balancë pozitive +99.757 lekë.

- **Për vitin 2014** subjekti kërkon rishikimin e analizës financiare duke ngritur pretendime e paraqitur dokumente shkresore në lidhje me: (i) të ardhurat nga Assistance Group; (ii) shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit/jetesës në SHBA. Sipas subjektit, analiza financiare paraprake për vitin 2014, pas korrigjimit të zërave sipas parashtrimeve më lart, paraqitet me një balancë pozitive +782,931 lekë.

- **Për vitin 2015** subjekti kërkon rishikimin e analizës financiare duke ngritur pretendime e paraqitur dokumente shkresore në lidhje me: (i) shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit në SHBA, si dhe shpenzimet e jetesës. Sipas subjektit, balanca negative që rezulton në analizën financiare pas korrigjimeve të zërave është në shumën -21.209 lekë, e cila është vlerë jomateriale dhe vjen si rrjedhojë e vlerave absolute të përfshira në analizën financiare.

- **Për vitin 2016** subjekti kërkon rishikimin e analizës financiare duke ngritur pretendime e paraqitur dokumente shkresore në lidhje me: (i) zërin “Ndryshim i likuiditeteve”; (ii) pakësimin e gjendjes *cash* si në dollar ashtu edhe në lekë; (iii) shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit në SHBA; (iv) mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, dhuruesit G. S. për të dhuruar shumën 100.000 lekë me 18.4.2016. Sipas subjektit, pas rishikimit analiza e këtij viti paraqitet me balancë negative në shumën -38.209 lekë.

- **Më tej, në lidhje me kursimet *cash*** të deklaruara në deklaratën *Vetting*, subjekti i referohet shpjegimeve që ka dhënë gjatë procesit duke pretenduar se balanca negative e konstatuar nga Komisioni nuk qëndron, për shkak se Komisioni nuk ka njohur kursimet *cash* të deklaruara në vite e, për rrjedhojë, ka dublikuar artificialisht balancën negative (trajtuar hollësisht më sipër

në këtë vendim). Subjekti kërkon rishikim të metodologjisë së përdorur dhe korrigjim të analizës financiare për periudhën 1.1.2017 – 25.1.2017.

55.2. Në përfundim, subjekti kërkon që vlerësimi final i balancave negative ndër vite, të bëhet nga Komisioni në zbatim të parimit të proporcionalitetit duke iu referuar nenit A të Aneksit të Kushtetutës, së cilës i ka bërë një interpretim të zgjeruar, si dhe praktikës së Komisionit në vendimet nr. 188, datë 24.7.2019, nr. 152, datë 7.6.2019, nr. 218, datë 10.12.2019, nr. 215, datë 4.12.2019, të cilat kanë marrë formë të prerë pa u ankimuar nga Komisioneri Publik dhe nuk rezultojnë që të jetë bërë rekomandim për ankim nga ONM-ja. Po kështu, subjekti i referohet edhe praktikës së Kolegjit në vendimet nr. 31, datë 18.11.2020, nr. 38, datë 6.12.2021, nr. 17/2022, nr. 2 (JR), datë 2.2.2023, vendimi nr. 4 (JR), datë 16.2.2023, vendimi 19 (JR), datë 10.6.2022.

Parashtrime në lidhje me të ardhurat të siguruara në SHBA nga “Cash Issuance History” dhe nga “Assistance Group Eligibility”

56. Me vendimin e datës 26.12.2023, trupi gjykues ka vendosur riçeljen e hetimit administrativ, pas të cilit subjektit, ndër të tjera, i është kërkuar qartësimi dhe saktësimi i mënyrës së përlllogaritjes së të ardhurave të siguruara “Cash Issuance History” dhe nga “Assistance Group Eligibility” në SHBA. Në datën 5.1.2024, subjekti ka paraqitur parashtrimet e veta duke bërë një panoramë shumë të detajuar të këtyre të ardhurave bazuar në dokumente shkresore dhe *sitet* përkatëse, ku ka siguruar të dhëna dhe referenca ligjore. Konkretisht, subjekti parashtron se të ardhurat nga këto dy zëra të përfshira në analizën paraprake të dërguar me rezultatet e hetimit administrativ kanë qenë në shumën totale 9.681 USD, ndërkohë që ai pretendon se ato duhet të jenë në shumën 21.211 USD sipas dokumentacionit të paraqitur si në deklaratën *Vetting* ashtu edhe në përgjigje të prapësimeve me njoftimin e rezultateve të hetimit.

56.1. Fillimisht, subjekti shpjegon llojet e të dyja kategorive të të ardhurave si vijojnë:

- Të ardhurat nga asistenca në para (Cash Assistance³⁷) e pasqyruar në dokumentin “Cash Issuance History³⁸” përfitohen çdo muaj nëpërmjet kartës EPPI Card ose direkt në llogarinë bankare. Programi i përfitimit të kësaj të ardhure është deri në 36 muaj dhe i jep mundësi çdo familjeje që jeton në Ohio të përpiqet për të krijuar një stabilitet financiar.

- Të ardhurat nga asistenca në ushqime (The Food Assistance program, ose njohur ndryshe si food stamp/ sot SNAP)³⁹ janë të ardhura mujore të përfituara direkt në kartën Ohio Direction

³⁷ ODJFS eManuals > Family Assistance - Cash/Food Assistance > Cash Assistance Manual > Chapter 1000 - Joint Program Policies > 5101:1-2-70 Issuance of Cash Assistance Benefits (ohio.gov)

³⁸ Cash Assistance - Franklin County Department of Job and Family Services (franklincountyohio.gov)
Ohio Works First (cash assistance) is temporary assistance available to families to help pay for immediate needs while the adults of the family prepare and search for jobs. Ohio Works First is a work program. Families receive assistance by spending a minimum of 20 to 35 hours per week (depending on circumstances) working, in school, or in some cases, volunteering at a location that will help them gain work experience for the future. Benefits are distributed through the EPPI card, which can be used like a debit card, or through direct deposit into the individual’s bank account. Families may be eligible for the program for up to 36 months, which may be non-consecutive. Ultimately, Ohio Works First allows families to work toward financial stability. Ohio Works First is also known as cash assistance or Federal Temporary Assistance to Needy Families (TANF). All customers of cash benefits under OWF can also receive health care under the Medicaid program and food stamps.

³⁹ Cash Assistance - Franklin County Department of Job and Family Services (franklincountyohio.gov)
Food assistance helps families stretch their food budgets to buy healthy food. **The Supplemental Nutrition Assistance Program (SNAP)** is designed to increase nutritional levels and safeguard the health and well-being of Franklin County residents. SNAP benefits are distributed on an “**Ohio Direction Card**” which can be used like a debit card at the grocery store. Healthy people under 60 also participate in Food Assistance Employment and Training (FAET) while receiving food assistance to help them gain work experience and move toward self-sufficiency. Ultimately, Food Assistance helps families meet their basic needs while adults work toward

Card⁴⁰, e cila është një kartë speciale për të blerë ushqime dhe përdoret në supermarkete dhe dyqane të përcaktuara. Me këto të ardhura nuk lejohet të blihen pije alkoolike, karburant, cigare, ushqime për kafshë, ilaçe dhe ushqime të gatshme. Këto të ardhura janë mujore⁴¹, masa e tyre e përfitimit përcaktohet në disa mënyra. Në muajin e parë të përfitimit të SNAP, të ardhurat përpjesëtohen në bazë të marrjes së aplikimit nga institucioni dhe përllogariten ditët nga dita e aplikimit deri në fund të muajit. Për të përpjesëtuar muajin e parë të përfitimeve, agjencia duhet të përcaktojë se sa do të ishte ndarja e ndihmës ushqimore SNAP për të gjithë muajin (shpjegimi për përfitimin e masës mujore është i përcaktuar sipas metodës së zgjedhur për aplikim). Të gjitha të dhënat për masën e përfitimit mujor, mënyrën dhe masën e përfitimit për muajin e parë të aplikimit janë të paraqitura dhe të detajuara në *website*.⁴² Si bazë përfitimi për të ardhurat nga SNAP janë të ardhurat e familjarëve në SHBA⁴³.

financial stability. Food Assistance is known nationally as the Supplemental Nutrition Assistance Program, or SNAP.

⁴⁰ ODJFS eManuals > Family Assistance - Cash/Food Assistance > Food Assistance Certification Manual > FAH.1000. General Provisions > 5101:4-1-04 Food Assistance: Benefit Issuance and Use (ohio.gov).

⁴¹ <https://emanuals.jfs.ohio.gov/CashFoodAssist/FACM/FAH4000/5101-4-4-27.stm>

(A) How is a monthly benefit allotment determined?

The monthly food assistance supplemental nutrition assistance program (SNAP) benefit can be determined several ways. The benefit amount can be determined through the statewide automated eligibility system, by using the basis of coupon/EBT issuance table, and or by doing a manual budget. When calculating monthly benefits without using the statewide automated eligibility system the county agency must use the maximum food assistance allotment table and may need to use the basis of coupon/EBT issuance table and the maximum net monthly income standards. All of these tables are issued annually through a food assistance change transmittal, which that can be found in the food assistance certification handbook at the Ohio department of job and family services website.

⁴² <https://emanuals.jfs.ohio.gov/CashFoodAssist/FACM/FAH4000/5101-4-4-27.stm>

(B) How are benefits prorated for the initial month?

The term "initial month" means the first month for which the assistance group is certified for participation in the food assistance program SNAP. The initial month must follow a period when the assistance group was not participating in the food assistance program SNAP. For most assistance groups the break in receiving food assistance SNAP can be any amount of time. However, for migrant and seasonal farm workers, an initial month is determined by a break in benefits of at least one month. Assistance groups containing migrant and seasonal farm workers shall receive a full month's allotment when the break in benefits is less than one month.

Benefits for the initial month of application are prorated based on the date the application is received by the county agency. **To prorate the initial month of benefits the county agency must determine what the food assistance SNAP allotment would have been for the entire month** as explained in paragraph (A) of this rule, and then prorate the benefits as described in this paragraph based on the date the application was received:

⁴³ <https://emanuals.jfs.ohio.gov/CashFoodAssist/FACM/FAH4000/5101-4-4-31.stm>

What is the general standard for anticipating income?

For the purpose of determining the supplemental nutrition assistance program (SNAP) assistance group's eligibility and **monthly benefit**, the county agency shall take into account the **income already received by the assistance group during the certification period** and any anticipated income the assistance group and the county agency are reasonably certain will be received during the remainder of the certification period. When the amount of income that will be received or when it will be received is uncertain, the county agency shall not count that portion of the assistance group's income that is uncertain. When the exact amount of the income is not known, that portion of it that is anticipated with reasonable certainty is considered income. In cases where the receipt of income is reasonably certain but the monthly amount may fluctuate, the county agency must average income.

(B) How is income anticipated?

Income received during the past thirty days shall be used as an indicator of the income that is and will be available to the assistance group during the certification period. However, the county agency shall not use past income as an indicator of income anticipated for the certification period if changes in income have occurred or can be anticipated. When income fluctuates to the extent that a thirty-day period alone cannot provide an accurate indication of anticipated income, the county agency and the assistance group may use a longer period of past time when it will provide an accurate indication of anticipated fluctuations in future income. Similarly, when the assistance group's income fluctuates seasonally, it may be appropriate to use the most recent season comparable to the certification period, rather than the last thirty days, as one indicator of anticipated income.

56.2. Në vijim të parashtrimeve, subjekti paraqet të dhëna të detajuara të të ardhurave, pasqyruar në aktet shkresore të administruara (të cilave u është referuar edhe Komisioni) dhe ka kryer përlllogaritjet përkatëse për periudhën 2009 – 2016 (edhe në formë tabelare), në përfundim të të cilave, sipas tij, të ardhurat e përfshira në analizë nga Komisioni janë më të ulëta se të ardhurat e dokumentuara që duhet të përfshihen në analizën financiare.

56.3. Në përfundim të parashtrimeve, pasi ka bërë një arsyetim të përmbledhur të pretendimeve të tij, subjekti i kërkon Komisionit rishikimin e analizës financiare për të ardhurat nga Cash Assistance dhe Food Stamp, dukë përfshirë të ardhurat nga asistenca sipas masës së përfitimit të pretenduar nga ana e tij, si të bazuar dhe provuar në ligj dhe në prova.

56.4. Në përfundim të procesit, Komisioni i gjeti të bazuara pretendimet e subjektit, arsyetuar si vijon:

- Nga Komisioni rezulton se është bërë mbledhje aritmetike nominalisht për të ardhurat nga asistenca, vetëm për pjesën e muajit të miratuar dhe për pjesën e muajit të parë të periudhave (disa muaj), në të cilat është miratuar asistenca. Për muajt e tjerë të periudhave nuk është bërë përlllogaritje e të ardhurave mujore të përfituara nga asistenca. Madje, në disa raste nuk është bërë mbledhje aritmetike as e muajit të parë të periudhës, sikurse është rasti në vitin 2009, 2011, etj. Subjekti argumenton se: *“Si në vendin tonë, ashtu edhe në SHBA, asistenca përfitohet me bazë mujore. Rezultoi e provuar edhe nga manuali i të ardhurave nga asistenca se pagesa përfitohet çdo muaj dhe në muajt kur bëhet aplikimi përfitohet asistenca nga data e aplikimit deri në fund të çdo muaji”*.

- Me të drejtë, subjekti pretendon se nuk ka logjikë ligjore dhe ekonomike që përfitimi për pjesën e muajit apo për muajin paraardhës të jetë i barabartë me masën e përfitimit të periudhës së miratuar, që sikurse rezulton varion nga dy deri në tetë muaj, për vitet 2009 – 2014. Në këtë logjikë, masa mujore e përlllogaritur nga punonjësi bie në mënyrë të menjëhershme, deri në 8 herë, pa ndryshuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara për përfitimin mujor të asistencës. Subjekti argumenton se: *“Mënyra e vlerësimit dhe përfshirjes së vlerave të përfituara nga Komisioni, në vlerësimin tim nuk ka kuptim logjik dhe ekonomik, pasi vlera e përfituar për periudhën të përpjesëtohet me numrin e muajve dhe kjo të ndodhë në çdo periudhë miratimi. Nëse i referohemi mënyrës së përfshirjes së të ardhurave nga Komisioni, do të rezultonte se për një periudhë kohore, nga 2 dhe më shumë muaj, masa e përfitimit mujor do të ishte rreth 50 USD/muaj. ...termi “Benefit amount” përfaqëson masën mujore të përfitimit muaj pas muaji gjatë të gjitha periudhave të miratuara”*.

- Shuma e përlllogaritur në muajt që janë jo të plotë, për shkak të datës së aplikimit përkon me shumën e plotë mujore të miratuar, përpjesëtuar me ditët që rezultojnë nga data e aplikimit deri në fund të muajit përkatës. Subjekti i referohet një shembulli: *“Pra, le të marrim si shembull periudhën e aprovuar në dokument 1.11.2009 (e shkruar në dokument ekzakt 11.1.2009, pasi në SHBA vendoset muaji para datës) nën kolonën begin/fillon e deri më 28.2.2009 (e shkruar në dokument 2.28.2009) nën kolonën end/mbaron. Shuma korresponduese në krahasim të djathtë është 259 USD. Ndërmjet periudhës 1.11.2009 – 28.2.2010, janë të paktën 120 ditë. 259*

The county agency shall exercise particular caution in using income from a past season as an indicator of income for the certification period. In many cases of seasonally fluctuating income, the income also fluctuates from one season in one year to the same season in the next year. However, in no event shall the county agency automatically attribute to the assistance group the amount of any past income. The county agency shall not use past income as an indicator of anticipated income when changes in income have occurred or can be anticipated during the certification period.

(C) When is income anticipated for the month received?

Income anticipated during the certification period shall be counted as income only in the month it is expected to be received, unless the income is averaged as described in paragraph (I) or (J) of this rule. Nonrecurring lump-sum payments are counted as a resource starting in the month received and not counted as income.

USD/120 ditë = 2.15 USD/ditë. 2.15 USD x 8 ditë (kështu do të rezultonte që nga data e aplikimit 23.9.2009 deri në fund të muajit shtator do të kishim një përfitim në shumën 17.2 USD (2.15 ditë * 8 ditë), ndërkohë në dokument përfitimi për këto 8 ditë është në shumën 69 USD, që korrespondon me shumën e përfitimit mujor të miratuar prej 259 USD. Në realitet shuma mujore prej 259 USD është pjesëtuar me numrin e ditëve të muajit dhe shuma ditore është shumëzuar me numrin e ditëve të mbetura, përfshirë ditën e aplikimit, prodhimi i tyre përcakton masën e përfitimit për këtë pjesë të muajit. Kjo metodologji përlllogaritjeje përsëritet në mënyrë sistematike në të gjitha vitet”.

- Subjekti, me të drejtë i referohet faktit që në krye të dokumentit shkruhet “Assistance Group Eligibility History” që do të thotë historiku i kualifikimit për këtë grup asistence. Pra, tregon periudhën për të cilën kualifikohen pjesëmarrësit në program dhe shumën mujore (*benefit amount*) që është hedhur elektronikisht çdo muaj (nuk mund të mblidhen vlerat nominalisht).

- Më tej, subjekti arsyeton se: “Begin/Fillimi End/Mbarimi Kolonat 3, 4, 5 dhe gjashtë të shënuara përkatësisht si AG, NON-FIN, RESOURCE, dhe FINANCIAL përkojnë me llojet verifikimeve të kryera për aprovimin e benefiteve, ndaj dhe janë shënuar poshtë tyre me PASS/Kalon apo FAIL/Nuk kalon/Ngel. Kolona 7 BUDGET METHOD/Metoda e buxhetimit, e cila poshtë saj ka të shënuar PRO (prospective), është metoda me an; të së cilës përlllogarisin shumën mujore të benefitit sipas algoritmeve të tyre. Në asnjë nga kolonat e dokumentit nuk përcaktohet apo nënkuptohet që shuma në krah të periudhave të miratuara përfaqëson shumën totale të përfituar. Por, logjika ekonomike dhe ajo ligjore, kushtet dhe kriteret e dhënies së asistencës tregojnë qartë tej çdo dyshimi se shuma e paraqitur në kolonën “Benefit Amount” përfaqëson shumën mujore të miratuar dhe përfituar për çdo muaj”.

- Po kështu, me të drejtë, subjekti arsyeton se: “Nga analiza logjike dhe aritmetike e dokumentit të vendosur në dispozicion Komisionit për përfitimin e asistencës, si dhe nga manuali elektronik për përfitimin e të ardhurave nga asistenca, printuar nga faqja zyrtare online e Department of Job & Family Services Ohio www.emanuals.jfs.ohio.gov, rezulton se në shtetin e OHIO nuk ka miratim të masës së përfitimit për periudhë (disa mujore), por sikurse evidentohen dhe në manual, ka miratim të masës së përfitimit mujor, periudhës për sa muaj do të merret ky përfitim”.

56.5. Në përfundim të procesit, pasi u verifikuan edhe një herë dokumentet shkresore të administruara dhe u kryen përlllogaritjet përkatëse, u kryen ndryshimet në analizën financiare të rishikuar në lidhje me të ardhurat në SHBA nga “Cash Issuance History” dhe nga “Assistance Group Eligibility”.

56.6. Në përfundim të procesit, Komisioni, pasi ka analizuar çdo pretendim e çdo dokument të paraqitur prej subjektit në funksion të kundërshtimit të barrës së provës të bëra prezent në parashtrimet e datave 14.12.2023 dhe 5.1.2024 dhe ka marrë në konsideratë një pjesë të konsiderueshme të pretendimeve të tij, analizuar hollësisht rast pas rasti në këtë vendim, ka rishikuar analizën financiare, sipas së cilës balancat negative paraqiten si vijojnë: për vitin 2011 në shumën -493.444 lekë, për vitin 2012 në shumën -701.704 lekë, për vitin 2015 - 45.920 lekë, në total, me shumën -1.241.068 lekë. Nëse të ardhurat e bashkëshortes së subjektit pranë “P. C.” në SHBA për vitet 2008 dhe 2009, në vlerën totale 720.000 lekë nuk do të konsiderohen të ardhura të ligjshme, kjo balancë do të ishte në vlerën 1.385.552 lekë, e cila nuk sjell ndonjë efekt domethënës në favor të masës së shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Vlerësimi përfundimtar në lidhje me kriterin pasuror

57. Në përfundim të procesit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Valentin Preçi: (i) ka kryer deklarime të sakta në përputhje me ligjin (shkronja “a” e pikës 5); (ii) ka mungesë burimesh financiare për

të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit në vlerën -1.241.068 lekë (shkronja “b” e pikës 5); (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë (shkronja “c” e pikës 5); (iv) nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit (shkronja “d” e pikës 5).

57.1. Në respektim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, referuar fakteve e rrethanave si vijojnë: (i) vlera -1.241.068 lekë shpërndahet në disa vite në vlera jo domethënëse; (ii) e gjithë pasuria e subjektit dhe bashkëshortes përbëhet nga një apartament dhe një autoveture dhe nuk u vërtetuan përpjekje të subjektit për të fshehur apo për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në posedim ose në përdorimin e tij; (iii) nuk u evidentuan transaksione të dyshimta në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij, të cilat mund të vinin në dyshim burimet e pasurive dhe shpenzimet e çdo lloji; (iv) gjatë vlerësimit të kriterit të figurës nuk ka pasur të dhëna apo dyshime për veprimtari të kundërligjshme të subjektit që mund të vinin në dyshim burimin e të ardhurave për krijimin e pasurive, nga Komisioni vlerësohet se balanca negative prej -1.241.068 lekësh nuk mund të shërbejë si shkak për të vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

KONTROLLI I FIGURËS

58. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka paraqitur pranë Komisionit raportin fillestar nr. *** prot., datë 2.11.2017, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, të deklasifikuar plotësisht⁴⁴, ku informon se: *“Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës. Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar”*.

58.1. Në deklaratën për kontrollin e figurës, në pikën b “Të dhëna për sigurinë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“...A. Z. P. është vëllai im. Më ka vënë në dijeni që është arrestuar në Spanjë në korrik 2015 për veprat penale “Vjedhje me forcë” dhe “Pjesëmarrje në grup kriminal”. Në muajin tetor 2015 është dëbuar nga Spanja...”*.

58.2. Në vijim të raportit thuhet se për të konkluduar në përshtatshmërinë ose jo të subjektit të rivlerësimit bazohemi në të dhënat e ardhura nga autoritetet e verifikimit. Nga këto autoritete, për subjektin e rivlerësimit Valentin Z. Preçi kanë ardhur përgjigje pozitive dhe nuk disponojnë të dhëna implikuese në ngarkim të tij. Kemi të bëjmë me rrethanë lehtësuese ku subjekti e ka vetëdeklaruar këtë rrethanë.

58.3. Bazuar në informacionet e përditësuara të ardhura nga institucionet verifikuese, rezulton se për subjektin Valentin Preçi nuk disponohen të dhëna të përditësuara për përfshirjen në veprimtari të kundërligjshme.

58.4. Komisioni, pas hetimit të kryer në lidhje me këtë kriter, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Valentin Preçi ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë

⁴⁴ Vendim nr. ***, datë 7.7.2020, i KDZH-së.

ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

59. Vlerësimi i aftësive profesionale është kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit mbi aftësitë profesionale; aftësitë organizative; etiken dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale; aftësive personale dhe angazhimin profesional.

59.1. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë këtë formular dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, sektori i protokoll – arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

Formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

60. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, konstatohet saktësia e formularit të vetëdeklarimit, evidentohet përvoja profesionale, si dhe janë analizuar dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit si vijojnë:

- Dokumenti ligjor nr. 1. “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ***, viti 2014”.
- Dokumenti ligjor Nr. 2. “Konkluzione përfundimtare në lidhje me çështjen penale Nr. *** të vitit 2015”.
- Dokumenti ligjor nr. 3. “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale Nr. *** viti 2014”.

Të tria dokumentet ligjore janë të strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese – arsyetuese dhe dispozitivi. Ato përmbajnë të dhënat dhe elementet e kërkuara nga Kodi i Procedurës Penale. Nga përmbajtja e akteve konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta dhe përmbajnë referenca ligjore. Dokumentet paraqiten të strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri - tjetri, teksti paraqitet i kuptueshëm. Në 3 dokumentet e paraqitura për vlerësim, nga vetë subjekti i rivlerësimit, si nga analiza e kryer nga Grupi i Punës i KLP-së ashtu edhe nga Komisioni, nuk rezultuan mangësi që kanë të bëjnë me kriterin profesional.

Analizë e 5 dosjeve për prokurorin Valentin Preçi, të përzgjedhura për vlerësim me short.

61. Nga Komisioni u shqyrtuan 5 dosjet e shortuara si vijojnë:

- Dosja nr. 1. “Vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, viti 2014”.
- Dosja nr. 2. “Vendim për pushimin e çështjes nr. ***, viti 2013”.
- Dosja nr. 3 “Vendim për pushimin e çështjes nr. ***, vitit 2015”.
- Dosja nr. 4 “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2014”.
- Dosja nr. 5 “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2016”.

Pesë dokumentet ligjore si më sipër janë të strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse; pjesa përshkuese – arsyetuese; dhe dispozitivi. Ato përmbajnë të dhënat dhe elementet e kërkuara

nga Kodi i Procedurës Penale dhe nga përmbajtja e tyre konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta dhe pasqyrohen të qarta referencat përkatëse ligjore. Dokumentet paraqiten të strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri - tjetri, teksti paraqitet i kuptueshëm. Në 5 dokumentet e shortuara për vlerësim, si nga analiza e kryer nga Grupi i Punës i KLP-së ashtu edhe nga Komisioni, nuk rezultuan mangësi që kanë të bëjnë me kriterin profesional.

Të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime

62. Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, rezulton që ndaj prokurorit Valentin Preçi të mos jenë dhënë masa disiplinore. Subjekti i rivlerësimit Valentin Preçi, për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 është vlerësuar nga Prokurori i Përgjithshëm me vlerësimin “Shumë mirë”. Nga subjekti i rivlerësimit janë depozituar certifikata trajnimesh dhe kualifikimesh të ndryshme. Bazuar në përgjigjet e ardhura nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, për kallëzime dhe të dhëna të tjera në lidhje me prokurorin Valentin Preçi, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës informon se në lidhje me prokurorin Valentin Preçi rezulton të jetë regjistruar materiali kallëzues nr. ***, viti 2019, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 14.9.2019 (bashkëlidhur një kopje e fashikullit përkatës).

63. Në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme janë administruar këto ankesa për prokurorin Valentin Preçi:

63.1. Ankesa nr. ***, viti 2017, e shtetasit Y. D. . Në ankesën e tij, ky shtetas ka pretendime në lidhje me vendimin e mosfillimit të çështjes penale mbi kallëzimin e paraqitur prej tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rezulton se me shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2017, sektori i burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun pranë Prokurorisë së Përgjithshme i ka kthyer përgjigje këtij shtetasi duke i bërë me dije rrugën procedurale që duhet të ndjekë në lidhje me pretendimet që ka mbi vendimmarrjen e prokurorit, duke iu drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si organ kompetent.

Komisioni e pyeti subjektin në lidhje me statusin e kallëzimit penal të shtetasit Y. D. , i cili sqaroi se: *“Në datën 16.7.2013, shtetasi Y. D. ka paraqitur kallëzim penal ndaj regjistruarit të ZVRPP Tiranë etj., për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Mashtrimi”, parashikuar nga nenet 248, 186 e 143 të Kodit Penal. Pas kryerjes së veprimeve verifikuese, me vendimin datë 16.9.2013 është vendosur mosfillimi i procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, datë 16.7.2013, të paraqitur nga shtetasi Y. D. . Ky vendim është ankimuar në gjykatë nga shtetasi Y. D. dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 10.3.2014, ka vendosur: “Pranimin e ankimit të bërë nga ankuesi Y. D. ; prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kallëzimin nr. ***, viti 2013, dhe detyrimin e Prokurorisë të fillojë hetimet...”. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 22.10.2014, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 10.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Në respektim të vendimeve gjyqësore është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal dhe në përfundim të veprimeve të nevojshme hetimore, me vendimin e datës 18.4.2017 është vendosur pushimi i çështjes penale nr. ***, viti 2017, pasi është arritur në konkluzionin se nga ana e punonjësve të ZVRPP-së Tiranë nuk janë kryer veprime të kundërligjshme dhe nuk janë konsumuar elemente të veprës penale. Ky vendim i prokurorit i është njoftuar kallëzuesit Y. D. dhe ky i fundit e ka kundërshtuar në gjykatë. Me vendimin nr. *** Akti, datë 19.7.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës së ankuesit Y. D. . Lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të datës 18.4.2017 për pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2017...”. Pas shqyrtimit të ankimit të shtetasit Y. D. , me vendimin nr. ***, datë 19.12.2017 Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. *** Akti, datë*

19.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Referuar të dhënave që pasqyrohen në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë rezulton se pranë kësaj gjykate në datën 16.3.2018, mbi bazën e rekursit të shtetasit Y. D. është regjistruar çështja nr. *** me objekt: “Kundërshtim i vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2017”. Datë të planifikuar për shqyrtimin e kësaj çështje nuk rezulton të jetë caktuar.

Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të tij, vendosi në dispozicion kopje të fashikullit të kallëzimit penal me nr. *** për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Nga shqyrtimi i dosjes rezultojnë të provuara shpjegimet e subjektit të rivlerësimit si më lart. Gjithashtu, nga dosja rezulton se: Në datën 23.7.2013, subjekti ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e verifikimeve paraprake. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 10.3.2014, për pranimin e ankimit të bërë nga ankuesi Y. D. dhe prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal që ka disponuar subjekti, ka argumentuar se: “Nga analizimi i fashikullit rezulton se Prokuroria nuk ka kryer veprime të plota verifikuese në lidhje me këtë kallëzim penal. Prokuroria është mjaftuar vetëm me provat shkresore të dërguara nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, dokumentacion, i cili është fotokopje dhe pa u vërtetuar njësia me origjinalin. Prokuroria nuk ka pyetur personin që ka bërë kallëzimin penal Y. D. , i cili do të jepte sqarime dhe shpjegime në lidhje me kallëzimin penal të bërë. Nuk ka pyetur dy të kallëzuarit e tjerë...”.

Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në sa më sipër u konstatua se:

- Sipas vendimit të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 10.3.2014, lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka përmbushur funksionet e prokurorit të parashikuara nga neni 24 i Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka bërë një hetim të plotë në lidhje me kallëzimin e bërë.

- Nga momenti i regjistrimit të materialit kallëzues 16.7.2013, deri në momentin e marrjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal në datën 16.9.2013 ka kaluar një periudhë prej rreth 2 muajsh. Nga të dhënat e pasqyruara si më sipër, vendimi për mosfillimin e procedimit penal është marrë jashtë afatit 30-ditor, të parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012 “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005 “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar, të Prokurorit të Përgjithshëm.

Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësimet e tij, subjekti ka shpjeguar se në datën 16.7.2013 shtetasi Y. D. ka paraqitur kallëzim penal ndaj regjistruarit të ZVRPP-së Tiranë etj., për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Mashtrimi”, parashikuar nga nenet 248, 186 e 143 të Kodit Penal. Pas kryerjes së veprimeve verifikuese, me vendim të datës 16.9.2013 është vendosur mosfillimi i procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, datë 16.7.2013, të paraqitur nga ky shtetas. Ky vendim është ankimuar në gjykatë nga shtetasi Y. D. dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 10.3.2014, ka vendosur: “Pranimin e ankimit të bërë nga ankuesi Y. D. ; Prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kallëzimin nr. ***, viti 2013, për shkak se nga analizimi i fashikullit rezulton se Prokuroria nuk ka kryer veprime të plota verifikuese në lidhje me këtë kallëzim penal. Prokuroria është mjaftuar vetëm me provat shkresore të dërguara nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, dokumentacion i cili është fotokopje dhe pa u vërtetuar njësia me origjinalin. Prokuroria nuk ka pyetur personin që ka bërë kallëzimin penal dhe pikërisht shtetasin Y. D., i cili do jepte sqarime dhe shpjegime në lidhje me kallëzimin penal të bërë. Nuk ka pyetur dy të kallëzuarit e tjerë si dhe detyrimin e Prokurorisë të fillojë hetimet...”.

Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 22.10.2014, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 10.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Në respektim të vendimeve të mësipërme gjyqësore është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal dhe në përfundim të veprimeve të nevojshme hetimore, me vendim të datës 18.4.2017 është vendosur pushimi i çështjes penale nr. ***, viti 2017, pasi është arritur në konkluzionin se nga ana e punonjësve të ZRPP-së Tiranë nuk janë kryer veprime të kundërligjshme dhe nuk janë konsumuar elemente të veprës penale.

Ky vendim i është njoftuar kallzuesit Y. D. dhe ky i fundit e ka kundërshtuar në Gjykatë vendimmarrjen e prokurorit. Me vendimin nr. *** akti, datë 19.7.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës së ankuesit Y. D. ; Lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të datës 18.4.2017 për pushimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2017...”. Pas shqyrtimit të ankimit të shtetasit Y. D. , me vendimin nr. ***, datë 19.12.2017, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. *** akti, datë 19.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Referuar të dhënave që pasqyrohen në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë, rezulton se pranë kësaj Gjykate në datën 16.3.2018, mbi bazën e rekursit të shtetasit Y. D. është regjistruar çështja nr. ***, me objekt: “Kundërshtim i vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2017”. Datë të planifikuar për shqyrtimin e kësaj çështjeje nuk rezulton të jetë caktuar.

Nga trupi gjykues i Komisionit konstatohet se sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 10.3.2014, lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka përmbushur funksionet e prokurorit të parashikuara nga neni 24 i Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka kryer një hetim të plotë në lidhje me kallëzimin e bërë.

Në vijim, subjekti shpjegon se referuar nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale të kohës, është në diskrecionin e çdo prokurori në Republikën e Shqipërisë të vendosë nëse duhet ta fillojë ose jo një çështje penale, bazuar në të dhënat fillestare të rastit dhe në *indiciet* për ekzistencën e veprave penale apo duhet të pushojë procedimin penal. Në momentin që fakti objekt verifikimi rezultonte më se i qartë në mënyrën se si ishte parashtruar nga kallëzuesi në kallëzimin e tij me shkrim, hartuar nën asistencën e një avokati të zgjedhur prej tij, nuk është vlerësuar e nevojshme pyetja e tij apo e personave të kallëzuar. Për zgjidhjen ligjore të këtij materiali kallëzues, subjekti është mjaftuar me administrimin e kopjes së praktikës nga ZVRPP-ja Tiranë, duke ngarkuar policinë gjyqësore me kryerjen e këtij veprimi dhe pas studimit të akteve ka arritur në konkluzionin se në këtë rast nuk duhet të urdhërohej regjistrimi i një procedimi penal.

Fakti që në rastin konkret, ky qëndrim i subjektit të rivlerësimit për mosfillim procedimi penal nuk përputhet me qëndrimin dhe vendimmarrjen e Gjykatës, nuk do të thotë se ky vendim është i padrejtë. Në lidhje me këtë kallëzim, subjekti ka shprehur mendimin e tij të arsyetuar në vendimin e mosfillimit, për të cilin ka qenë i bindur dhe e ka argumentuar qartësisht në vendim. Edhe pas shfuqizimit të këtij vendimi, në vijim janë kryer veprime të plota hetimore dhe rezulton që vendimi për pushimin e çështjes penale është lënë në fuqi nga Gjykatat.

Fillimi i një procedimi penal është një moment i rëndësishëm, i cili sjell pasoja për individët e kallëzuar, por edhe për palët në një proces gjyqësor civil. Për këtë shkak, ai nuk mund të nisët *apriori*, bazuar vetëm në kallëzimin e palëve në proces civil, pa pasur indicie për elemente të veprës penale të pretenduar, sikurse është rasti konkret, në të cilin kontestohet procesi i regjistrimit të një pasurie nga specialistë të ZVRPP-së Tiranë, por nuk rezulton asnjë element i veprës penale të kallëzuar, për aq kohë sa pretendimet e kallëzuesit janë tërësisht të karakterit juridiko-civil dhe thelbësisht të lidhura me zgjidhjen e çështjes civile.

Gjithashtu, nga Komisioni kërkohen shpjegime edhe për faktin se nga momenti i regjistrimit të materialit kallëzues në datën 16.7.2013, deri në momentin e marrjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal në datën 16.9.2013, ka kaluar një periudhë prej rreth 2 muajsh. Nga të dhënat e pasqyruara si më sipër, vendimi për mosfillimin e procedimit penal është marrë jashtë afatit 30-ditor të parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar, të Prokurorit të Përgjithshëm.

Subjekti sqaron se në f.*** të fashikullit që ka vendosur në dispozicion ndodhet formulari për trajtimin e materialit kallëzues nr. ***, datë 16.7.2013, me shënimin e marrjes në dorëzim nga prokurori datë 22.7.2013. Sapo është njohur me aktet, në datën 23.7.2013 ka urdhëruar kryerjen e verifikimeve paraprake. Është fakt i njohur botërisht që muaji gusht përkon me lejet vjetore për gjyqtarët e prokurorët, duke kufizuar veprimtarinë e punës këtë muaj, sipas një grafiku gatishmërie për çështje të ngutshme si arrestime në flagrancë apo ndalime të personave të dyshuar për kryerjen e krimeve të ndryshme. Në përfundim të lejes vjetore për vitin 2013, në muajin shtator të këtij viti, brenda afatit 15-ditor (ditë pune pa llogaritur ditë pushimi e festa zyrtare) që parashikon baza ligjore e sipërcituar, ka disponuar me vendimin përkatës datë 16.9.2013 për mosfillim të procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, datë 16.7.2013, të paraqitur nga shtetasi Y. D. .

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Së pari, në lidhje me konstatimin e Komisionit se sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 10.3.2014, lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka përmbushur funksionet e prokurorit të parashikuara nga neni 24 i Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka bërë një hetim të plotë në lidhje me kallëzimin e bërë, Komisioni, pasi shqyrtoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit, evidentoi se:

- Në zbatim të urdhrit datë 23.7.2013, të subjektit të rivlerësimit për kryerjen e verifikimeve paraprake janë marrë në shqyrtim kallëzimi i shtetasit Y. D. dhe provat e depozituara me procesverbalin e marrjes në dorëzim datë 29.7.2013, si dhe është administruar praktika nga ZVRPP Tiranë.

- Në kallëzim pretendohet se veprimet e punonjësve të ZVRPP-së Tiranë për regjistrimin e një objekti që nuk është pasuri e paluajtshme dhe që është zëvendësuar me një objekt tjetër të paluajtshëm, përbën veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” (neni 248 i Kodit Penal). Pasurinë e regjistruar nga ZVRPPP-ja, shtetasi T. R. ia ka shitur verbalisht shtetasit Y. D. para 14 vitesh, i cili e ka prishur atë objekt dhe në vitin 2000 ka ndërtuar një objekt me sip. 30 m², me tulla dhe beton. Pra, objekti i ri i ndërtuar mbi truallin, nuk është regjistruar në ZVRPP Tiranë. Për pronësinë e truallit dhe të objektit të ndërtuar mbi të, palët janë përfshirë në një konflikt dhe në një proces gjyqësor civil.

- Ka rezultuar se shtetasi T. R. ka privatizuar nga Ndërmarrja e Riparim Shërbimeve nr. *** Tiranë, një objekt me sip. 9 m² (jo truallin) me anën e dy kontratave⁴⁵. Kontratat janë regjistruar në ZVRPP Tiranë me nr. *** regj., datë 9.12.1991. Për të njëjtin objekt, njëra nga kontratat citon “Njësi” dhe tjetra “Barakë” dhe është lëshuar vërtetimi hipotekor datë 10.11.2000, ku objekti citohet “Një barakë”, ndërsa sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 4.6.2013, objekti citohet “Njësi”.

- Regjistrimi fillestar është bërë duke iu përmbajtur kontratës së privatizimit dhe vendimit të regjistruarit nr. ***, datë 5.12.2000, ku citon se ishte kryer më parë verifikimi i dokumentacionit të tërhequr nga arkivi qendror i Ministrisë së Ndërtimit. Pas procedurave të

⁴⁵ Kontrata e lidhur midis blerësit T. R., shitësit Ndërmarrja e Riparim-Shërbimeve dhe Agjencisë së Privatizimit në Komitetin Ekzekutiv Rajoni nr. ***, Tiranë; kontratë noteriale midis këtyre palëve nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.12.1991.

afishimit publik, ku me sa duket nuk ka rezultuar që të ketë pasur ndonjë ankesë në lidhje me regjistrimin fillestar të kësaj pasurie, qoftë mbi të dhënat dhe statusin e pasurisë, qoftë mbi emrin e pronarit të kësaj pasurie, në vitin 2013 për këtë objekt është lëshuar certifikatë për vërtetim pronësie ku objekti citohet “Njësi” njësoj si në kontratën e privatizimit. Në seksionin “Shënime të veçanta” të kartelës së kësaj pasurie është bërë shënimi “pasuria nuk ka marrëdhënie me trualli”. Pra, rezulton se ZVRPP-ja ka kryer regjistrimin e një objekti bazuar: (i) në kontratën noteriale të privatizimit; (ii) në përshkrimin “Njësi” sipas kësaj kontrate; (3) në verifikimet e procedurat ligjore, pa shtrembëruar asnjë fakt apo të dhënë.

Për sa më lart, për çdo paqartësi apo pasaktësi të kryer në aktet e ZVRPP-së Tiranë, kallëzuesi duhej të ezauronte rrugën administrative apo civile të së drejtës. Veprimet e kryera nga ZVRPP-ja Tiranë për regjistrimin e pronës edhe pas azhurnimit, datojnë deri në vitin 2000, ndërsa certifikata e lëshuar në vitin 2013 nga kjo ZVRPP është bërë në referim të të dhënave në kartelat dhe regjistrat e pasurisë që janë plotësuar gjatë procesit të regjistrimit fillestar të këtij objekti. Pra, edhe sikur të ishim para elementeve të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, referuar masës së sanksionit për këtë vepër dhe nenit 66 të Kodit Penal, kjo vepër është parashkuar për veprimet e kryera para vitit 2000.

Që të kemi veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” nevojitet të vërtetohet jo vetëm paligjshmëria e veprimit të kryer, por edhe pasoja që është përfitimi i padrejtë i një personi apo dëmtimi i interesave të ligjshëm të shtetit apo individit. Në rastin konkret, kallëzimi me provat bashkëlidhur dhe praktika nga ZVRPP-ja duket se mjaftojnë për të provuar se shtetasi T. R. e ka fituar pronësinë me kontratë noteriale (veprim juridik i ligjshëm), ndërsa shtetasi Y. D. nuk provoi të ketë titull pronësie mbi objektin e hetimit dhe, si rrjedhojë, nuk i është cenuar ndonjë interes i ligjshëm i tij.

Duke parë në tërësinë e tyre veprimet e subjektit të rivlerësimit dhe vendimet e gjykatave që kanë vlerësuar vendimmarrjet e tij, kuptohet se subjekti ka marrë vendimin e mosfillimit të procedimit penal në datën 16.9.2013, pasi ka krijuar bindjen e tij të brendshme bazuar në të dhënat e referuara në kallëzimin me shkrim; në administrimin e kopjes së praktikës nga ZVRPP-ja Tiranë, si dhe në referim të nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale. Siç rezultoi edhe më lart, provat e administruara në veprimet paraprake kanë qenë të mjaftueshme që subjekti të krijonte bindjen se nuk ekzistojnë elementet e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe që procedimi nuk duhej filluar.

Pavarësisht se ky vendim i subjektit të rivlerësimit është rrëzuar nga të dyja gjykatat me vendimet nr. ***, datë 10.3.2014 dhe nr. ***, datë 22.10.2014, fakti që pasi janë zbatuar këto vendime dhe janë kryer hetime të mëtejshme, sërish ka rezultuar që nuk ka elemente të veprës penale e prandaj çështja duhej pushuar, madje në këtë përfundim kanë arritur edhe Gjykata e Shkallës së Parë edhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimet e tyre respektive nr. *** Akti, datë 19.7.2017 dhe nr. ***, datë 19.12.2017, duke lënë në fuqi vendimin e subjektit datë 18.4.2017, tregon se bindja e brendshme e subjektit të rivlerësimit në vendimmarrjen e tij të parë në datën 16.9.2013 ka qenë e saktë dhe e bazuar.

Duke mbajtur parasysh këto rrethana, duket se veprimet e para hetimore që ka kryer subjekti i rivlerësimit kanë qenë të mjaftueshme që ai të krijonte bindjen e tij të brendshme se procedimi penal nuk duhej filluar, prandaj Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur tendencën që të shkelë dispozitat procedurale dhe të japë një vendim të padrejtë.

Së dyti, në lidhje me konstatimin e Komisionit se nga momenti i regjistrimit të materialit kallëzues 16.7.2013 deri në momentin e marrjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal në datën 16.9.2013 kanë kaluar 2 muaj dhe kështu vendimi për mosfillimin e procedimit penal është marrë jashtë afatit 30-ditor, të parashkuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, i ndryshuar” të Prokurorit

të Përgjithshëm, Komisioni mori në shqyrtim prapësimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat bashkëlidhur prapësimeve.

Duke mbajtur parasysh kronologjinë e veprimeve procedurale kur në datën 16.7.2013 është regjistruar kallëzimi penal; në datën 22.7.2013, subjekti ka marrë në dorëzim kallëzimin (sipas formularit për trajtimin e materialit kallëzues nr. ***, datë 16.7.2013, i ndodhur në dosje); në datën 23.7.2013, subjekti ka filluar verifikimet paraprake; në muajin gusht të çdo viti magjistratët kryejnë pushimet vjetore; në datën 16.9.2013, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, atëherë duket qartë se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime procedurale gjatë periudhave 22.7.2023 – 31.7.2023 (10 ditë) dhe 1.9.2023 – 16.9.2023 (16 ditë), pra për 26 ditë në total. Si rrjedhojë, nuk është tejkaluar afati procedural 30-ditor, i parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, i ndryshuar” të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit janë bindëse dhe të bazuara, prandaj nuk konstatohen mangësi në lidhje me ankimin nr. ***, viti 2017, të shtetasit Y. D. , të trajtuar më lart.

63.2. Ankesa nr. ***, viti 2020, e shtetasit D. N.. Me anë të kësaj ankese ankuesi pretendon se ndaj prokurorit Valentin Preçi kishte depozituar një kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe kjo e fundit kishte vendosur mosfillim të procedimit penal. Në kërkesë, ai deklaroi se ndaj vendimit është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe kjo e fundit e ka lënë në fuqi vendimin për mosfillimin e procedimit penal. Gjithashtu, ankuesi deklaroi se ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Durrës. Ankuesi ka pretenduar gjithashtu edhe mbi fakte të tjera në lidhje me prokurorin dhe në lidhje me këto pretendime në shkresën nr. *** prot., datë 17.3.2020, Drejtoria e Koordinimit Institucional pranë Prokurorisë së Përgjithshme i ka kthyer përgjigje duke i bërë me dije ankuesit se në lidhje me këto fakte të pretenduara është në të drejtën e tij t’i paraqesë me shkrim në prokurorinë përkatëse.

Komisioni e pyeti subjektin në lidhje me statusin e procedimit penal nr. ***, viti 2019, i cili sqaroi se: “Në datën 22.5.2019, shtetasi D. N. ka paraqitur kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit për veprën penale “Kryerje e veprimeve arbitrare” dhe “Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme”, parashikuar nga nenet 250 e 251 të Kodit Penal. Meqenëse ky kallëzim penal është depozituar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku subjekti ushtronte detyrën si prokuror, atëherë kallëzimi është dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës me shkresën nr. *** prot., datë 28.5.2019. Me shkresën nr. *** prot., datë 14.6.2019, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës i është dërguar e plotë kopja e fashikullit të procedimit penal nr. ***, viti 2015, përmbajtja e të cilit shërben edhe si bazë e pretendimeve të ngritura në kallëzimin e shtetasit D. D.. Me vendimin datë 14.6.2019, prokurori i çështjes ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal për materialin e kallëzuar nga shtetasi D. N. ”, sepse bazuar në nenin 290/1, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Penale, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Ky vendim i është njoftuar kallëzuesit, i cili brenda afatit ligjor ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila me vendimin nr. (***) ***, datë 17.1.2020, ka vendosur “Anulimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, datë 14.6.2019 për “Mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin e paraqitur nga ankuesi D. N. ...”. Mbi bazën e ankimit të prokurorit të çështjes pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 30.6.2020, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. (***) ***, datë 17.1.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe kthimin e akteve pranë asaj gjykate...”. Ankuesi nuk ka ushtruar rekurs ndaj këtij vendimi. Bazuar në vendimin

e mësipërm të Gjykatës së Apelit Durrës, sipas të cilit vendimi i Gjykatës së Rrethit që ka prishur është konstatuar si i paarsyetuar, për pasojë absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 112/3 të Kodit të Procedurës Penale, aktet janë kthyer po kësaj gjykate për t'u shortuar dhe gjykuar nga një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate.

*Me vendimin nr. (***) ***, datë 3.11.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës penale me nr. regj. them. (***) ***, datë regjistrimi 9.10.2020, me kërkesë D. N., me objekt kundërshtimin e vendimit datë 14.6.2019 “Për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues nr. ***, datë 31.5.2019” të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, si të pabazuar në ligj dhe prova...”*

*Pas ankimimit të këtij vendimi nga shtetasi D. N., Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 15.2.2021, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 3.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”. Referuar të dhënave që pasqyrohen në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë rezulton se pranë kësaj gjykate në datën 19.4.2021, mbi bazën e rekursit të shtetasit D. N. është regjistruar çështja nr. *** me objekt “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. ***, viti 2019, për shtetasin Valentin Preçi”. Datë të planifikuar për shqyrtimin e kësaj çështjeje nuk rezulton të jetë caktuar.*

Lidhur me bazueshmërinë e pretendimeve të shtetasit D. N., subjekti shpjegon se është plotësisht dakord me arsyetimin e prokurorit të çështjes pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili ka vendosur dhe arsyetuar shkaqet për marrjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, si dhe me vendimet e gjykatave që kanë rrëzuar pretendimet e ankuesit si të pabazuara në ligj e prova”.

Subjekti në mbështetje të shpjegimeve vendosi në dispozicion kopje të fashikullit të procedimit penal nr. ***, viti 2019. Nga dosja e kësaj çështjeje, Komisioni konstatoi se në datën 22.5.2019 ankuesi D. N. ka kallëzuar penalisht prokurorin Valentin Preçi për veprat penale “Kryerja e veprimeve arbitrare” dhe “Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme”, vepra këto të parashikuara nga nenet 250 dhe 251 të Kodit Penal. Në kallëzim, shtetasi D. N. shprehët se: “Në datën 25.5.2015, prokurori Valentin Preçi pushoi procedimin penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit D. N. për kryerjen e veprave penale “Falsifikim i vulave dhe stampave”, “Prodhim i kundërligjshëm i artikujve ushqimorë dhe industrialë” dhe “Fshehje të ardhurash”. Sipas kallëzuesit, prokurori nuk ka hetuar dhe ka marrë të mirëqena të gjitha veprimet e kryera nga OPGJ-ja duke mos kryer detyrën e tij të hetimit paraprak, përveçse ndërmarrjen e veprimeve arbitrare nga ana e tij duke rënduar situatën e shtetasit D. N. përgjatë seancës së caktimit të masës së sigurimit. Prokurori nuk ka qenë aktiv në hetime dhe për shkak të neglizhencës së tij shtetasit D. N. i është shkaktuar një dëm pasi ka qëndruar 35 ditë në ambientet e paraburgimit.

Çështja ndaj subjektit të rivlerësimit ka kaluar për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës së bashku me dosjen e procedimit penal nr. ***, e hetuar nga prokurori Valentin Preçi. Prokuroria e Rrethit Durrës, me vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal” datë 14.6.2019 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për materialin e kallëzuesit D. N. nr. ***, datë 31.5.2019.

Kundër këtij vendimi për mosfillimin e procedimit penal ka ushtruar të drejtën e ankimit shtetasi D. N. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila me vendimin nr. ***, datë 17.1.2020, ka vendosur: Pranimin e kërkesës së kërkesit D. N.; anulimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës datë 14.6.2019 “Për mosfillimin e procedimit penal” për materialin kallëzues të ankuesit D. N., regjistruar me nr. ***, datë 31.5.2019.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka kërkuar në Gjykatën e Apelit Durrës ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë “Për mosfillimin e procedimit penal” datë 14.6.2019.

Nga fashikulli i vënë në dispozicion nuk ka ndonjë vendimmarrje të Gjykatës së Apelit në lidhje me këtë çështje.

Në përfundim të hetimit, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime në lidhje me çështjen dhe padrejtësisht ka mbajtur një qytetar në paraburgim për 35 ditë duke mos qenë i fajshëm për veprën penale që është akuzuar. Sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit që të japë shpjegime lidhur me këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësimet e paraqitura prej tij, subjekti i rivlerësimit shpjegon se gjatë hetimit të kryer nga Komisioni, pas administrimit të fashikullit përkatës dhe vendimeve gjyqësore, ka informuar trupën e Komisionit se në datën 22.5.2019 shtetasi D. N. ka paraqitur kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit për veprën penale “Kryerje e veprimeve arbitrare” dhe “Mosmarrje e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme”, parashikuar nga nenet 250 e 251 të Kodit Penal. Në vijim të prapësimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtat shpjegime dhe ka parashtruar të njëjtat rrethana që ka dhënë edhe gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

Për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, subjekti shpjegon se lidhur me bazueshmërinë e pretendimeve të shtetasit D. N. është plotësisht dakord me arsyetimin e prokurorit të çështjes pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili ka vendosur dhe arsyetuar shkaqet për marrjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal ndaj subjektit, si dhe me vendimet e gjykatave që kanë rrëzuar pretendimet e ankuesit si të pabazuara në ligj e prova. Në fashikullin e vënë në dispozicion të Komisionit ndodhet shkurtimi i vendimit nr. ***, datë 30.6.2020, i Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe shënimi në vendimin nr. (***) ***, datë 3.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës se *me vendimin nr. ***, datë 15.2.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës, është vendosur lënia në fuqi e këtij vendimi*, me shënimet nga kryesekretaria gjyqësore.

Gjithashtu, nga Komisioni kërkohen shpjegime edhe për faktin se duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime në lidhje me çështjen dhe padrejtësisht ka mbajtur një qytetar në paraburgim për 35 ditë, duke mos qenë i fajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar. Për sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se nga rrethanat e çështjes të paraqitura nga policia gjyqësore kishte dyshime të arsyeshme të bazuara se edhe shtetasi D. N. ishte i përfshirë në aktivitet kriminal me të dyshuarit e tjerë.

Sipas informacionit për referimin e veprës penale tek prokurori datë 3.3.2015, shërbimet e policisë gjyqësore të seksionit për krimin ekonomik e financiar pranë DPQ Tiranë kanë arrestuar në flagrancë shtetasit I. V. , D. N. dhe G. H. , të dyshuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 180, 190/2 dhe 288/a të Kodit Penal. Kjo pasi kishte informacione në rrugë operative se në pastiçerinë e I. V. s prodhoheshin në mënyrë të kundërligjshme artikuj ushqimorë (patatina) që shiteshin në qytete të ndryshme. Në datën 3.3.2015, ora 07:00, është kapur në flagrancë shtetasi A. D. duke dalë nga ambientet e pastiçerisë dhe kishte mjetin e ngarkuar me mallra ushqimorë, ndërsa në ambientet e brendshme të kësaj pastiçerie është gjetur I. V. , i cili nuk dispononte asnjë lloj dokumentacioni shkresor, si dhe shtetasi D. N. brenda një dhome ku ishte montuar një linjë prodhimi e ambalazhi patatinash.

Nga dëshmia e shtetasit A. D. ka rezultuar se kishte afro 1 muaj që punonte në këtë pastiçeri dhe në dijeninë e tij shtetasit I. V. e D. N. ishin ortakë në biznes dhe se me të dy kishte biseduar për kushtet e punës, madje sipas kësaj dëshmie, shtetasi D. N. merrej me llogaritë e shitblerjeve, si dhe me marketingun e mallrave. Po ashtu, shtetasi D. N., i pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetime, fillimisht nuk ka pranuar të japë asnjë shpjegim kur është pyetur në lidhje me faktet që i atribuonte policia gjyqësore, duke mbajtur të njëjtin qëndrim dhe ka shfaqur mungesë bashkëpunimi me organin procedues, ashtu si dhe i dyshuari kryesor I. V.. Më pas,

në prani të avokatit ka mohuar përfshirjen në këtë aktivitet, duke deklaruar se ditën e ngjarjes ka qenë krejt rastësisht në ambientet e brendshme të pastiçerisë.

Nisur nga sa më sipër, ka pasur të dhëna të mjaftueshme që krijojnë dyshim të arsyeshëm, të bazuar në prova, se ndaj shtetasve I. V. , G. H. e D. N. duhet të caktohet një masë sigurimi personal me karakter shtrëngues. Kërkesa e prokurorit u pranua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. *** akti, datë 6.3.2015, ka vendosur: “Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të personit nën hetim D. N. i. Caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” për D. N.”. Ndaj këtij vendimi nuk rezulton të jetë paraqitur ankim nga shtetasi D. N. dhe hetimet kanë vijuar dhe përfunduar në një afat shumë të shkurtër kohor. Gjithsesi, subjekti shpjegon se në vlerësimin e tij nuk është prokurori që mban në burg të arrestuarin, pasi prokurori bën kërkesë në gjykatë dhe është kjo e fundit që vendos nëse një i arrestuar do të qëndrojë në masë sigurimi arrest në burg apo jo.

Pas kryerjes së një sërë veprimesh hetimore për sqarimin e përgjegjësisë penale të personave nën hetim, veçanërisht për sqarimin e pozitës së shtetasit D. N. , janë pyetur persona që kanë dijeni për veprën penale si A. T., H. N., E. Q. e F. D., nga deklaratimet e të cilëve provohet se shtetasit D. N. dhe I. V. nuk kishin marrëdhënie biznesi dhe ditën e ngjarjes ishin bashkë rastësisht për të pirë kafe. Ky fakt provohet edhe nga ballafaqimet e kryera midis shtetasit A. D. dhe personave nën hetim, si dhe nga deklaratimet e shtetasve I. V. e G. H. .

Nën dritën e këtyre provave të administruara përgjatë hetimeve, në datën 3.4.2015, pas 1 muaji nga arrestimi në flagrancë i kryer nga policia gjyqësore, subjekti i është drejtuar gjykatës me kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit D. N., nga ajo e “Arrestit në burg” në atë të “Detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Kjo kërkesë u pranua nga gjykata me vendimin nr. ***, datë 7.4.2015. Në vijim, është vendosur edhe pushimi i hetimeve në ngarkim të shtetasit D. N., duke vendosur marrjen në cilësinë e të pandehurve për shtetasit I. V. e G. H..

Për këto arsye, subjekti vlerëson se pretendimet e ankuesit D. N. janë tërësisht të pabazuara, pasi në momentet e para kishte të dhëna të plota që krijojnë dyshim të arsyeshëm bazuar në nenin 228 të Kodit të Procedurës Penale për policinë gjyqësore, për prokurorin e çështjes dhe për gjykatën, dyshim ky i bazuar në prova si: procesverbali i kapjes në flagrancë; procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes; procesverbali i sekuestrimit të provave materiale dhe deklarimeve të shtetasit Ador Dule, që edhe shtetasi D. N. ishte i përfshirë në aktivitet kriminal së bashku me të dyshuarit e tjerë në këtë çështje. Hetimet janë kryer të plota, të shpejta dhe ezauruese në lidhje me çështjen.

Kjo ka qenë situata faktike që ka sjellë për pasojë qëndrimin e shtetasit D. në paraburgim për afro 30 ditë, bazuar në dyshim të arsyeshëm. Ndërsa fajësia e tij është koncept që lidhet me dhënien e një vendimi përfundimtar nga gjykata, kur i pandehuri rezulton fajtor përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.

Nga analiza e fashikullit, subjekti vlerëson se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë, pasi ai ishte ndaluar nga policia gjyqësore mbi bazën e dyshimit të arsyeshëm për përfshirjen e tij në aktivitet të paligjshëm, bazuar në provat e sipërcituara që kanë krijuar bindjen e brendshme edhe te gjykata për të vleftësuar si të ligjshëm arrestimin e tij në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”. Ky vendim gjyqësor as nuk është apeluar nga shtetasi D. N., duke u pajtuar vetë ankuesi me masën e sigurimit të caktuar nga gjykata. Pra, liria e tij është kufizuar përkohësisht deri në sqarimin e pozitës së tij si person i dyshuar për një vepër penale, të kryer në bashkëpunim.

Procedimi penal ndaj tij ka qenë i bazuar në fakte, pasi nuk kishte asnjë arsye që ai të gjendej në ambientet e brendshme të një pastiçerie ku as figuronte i punësuar, pikërisht në dhomën ku ishte montuar linja e prodhimit dhe e ambalazhit të patatinave. Po ashtu, si prova për

regjistrimin e procedimit penal janë vlerësuar edhe deklaratimet e shtetasit A. D., i cili në deklaratimet e para konfirmonte se në dijeninë e tij, shtetasit I. V. e D. N. ishin ortakë në biznes dhe me të dy kishte biseduar për kushtet e punës, madje shtetasi D. N. merrej me llogaritë e shitblerjeve, si dhe me marketingun e mallrave.

Ka qenë pikërisht diligenca e duhur e prokurorit, dinamika e hetimit të shpejtë, si dhe administrimi i provave të reja, të cilat në tërësi kanë bërë të mundur sqarimin e pozitës së shtetasit D. N., duke konkluduar në vendimin e pushimit të hetimeve në ngarkim të tij. Subjekti shprehet se: *“Ndaj vlerësoj se faktet e pretenduara nga shtetasi D. N. nuk mund të vlerësohen si mangësi profesionale nga ana ime në hetimin e kësaj çështjeje”*.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Në lidhje me konstatimin e Komisionit se duket që subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime në lidhje me çështjen dhe padrejtësisht ka mbajtur një qytetar në paraburgim për 35 ditë, duke mos qenë i fajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të detajuara dhe të argumentuara mbi fakte dhe bazë ligjore se në momentin e arrestimit në flagrancë të shtetasit D. N. kishte prova të mjaftueshme (procesverbalet e veprimeve të para që përmenden më lart nga subjekti) që krijuan tek ai dhe gjykata bindjen e brendshme se ky shtetas kishte kryer veprën penale për të cilën u arrestua.

Arrestimi në flagrancë i këtij shtetasi është kryer në përputhje me nenet 251, 252 të Kodit të Procedurës Penale dhe fillimisht është vlerësuar i ligjshëm nga gjykata. Kërkesa fillestare e subjektit të rivlerësimit për caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj shtetasit D. N. është marrë mbi një dyshim të arsyeshëm të bazuar në prova dhe në përputhje të plotë me nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale dhe Gjykata e ka gjetur të bazuar këtë kërkesë duke e pranuar atë, pra në përfundim të kësaj faze të procesit penal është gjykata ajo që në bazë të neneve 244 dhe 278 të Kodit të Procedurës Penale, vendos se cila masë sigurimi personal do të aplikohet ndaj shtetasit të ndaluar.

Me shpjegimet dhe rrethanat që subjekti paraqet në lidhje me veprimet e tij procedurale dhe hetimore, kuptohet se ai ka kryer veprimet e nevojshme dhe në kohë reale për të arritur në konkluzionin nëse qëndronte ose jo akuza mbi këtë shtetas, madje qysh në hetimet e para, kur u administruan prova të reja sipas të cilave dukej se ky shtetas mund të mos ishte fajtor për veprën penale që akuzohej, subjekti ka kërkuar në gjykatë zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest me burg” në “Detyrim për paraqitje pranë policisë gjyqësore” në përputhje me nenin 260 të Kodit të Procedurës Penale. Pra, ndërsa vetë i arrestuari nuk e ka ankimuar vendimin gjyqësor për caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest me burgim”, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar me iniciativën e vet, zbutjen e kësaj mase duke u bazuar në prova të reja që kushtëzuan këtë kërkesë.

Pra, të gjitha këto veprime të subjektit, krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit në asnjë moment nuk ka pasur tendencën për të mbajtur padrejtësisht të burgosur shtetasin D. N. dhe as për të kryer veprime joprofesionale apo në shkelje të dispozitave ligjore. Përkundrazi, duket qartë se Subjekti ka vepruar me përgjegjshmëri, brenda afateve procedurale dhe me profesionalizëm për zbardhjen e çështjes, evidentimin e autorëve të veprës penale dhe përcaktimin e përgjegjësisë penale të secilit prej tyre.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se në lidhje me ankesën nr. ***, viti 2020, të shtetasit D. N., nuk rezultojnë mangësi në veprimet e subjektit të rivlerësimit, në lidhje me kriterin profesional.

63.3. Ankesa nr. ***, viti 2009, e shtetasës S. Sh. . Në ankesën e saj kjo shtetase ka sqaruar se kishte paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasit A. G. dhe në lidhje me këtë kallëzim prokurori Valentin Preçi kishte vendosur mosfillimin e procedimit penal. Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. *** akti, datë 21.4.2008,

kishte vendosur prishjen e vendimit të mosfillimit dhe kthimin e akteve organit të prokurorisë me qëllim vazhdimin e hetimeve. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 1.5.2008. Prej datës që vendimi ka marrë formë të prerë ankuesja pretendon se nga ana e prokurorit nuk është vënë në dijeni në lidhje me vazhdimin e hetimeve. Për këtë shkak ka kërkuar ndërhyrjen e institucioneve më të larta. Në lidhje me këtë ankesë, me shkresën nr. *** prot., datë 15.4.2009, Drejtoria e Koordinimit Institucional pranë Prokurorisë së Përgjithshme e ka kaluar ankesën për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Komisioni e pyeti subjektin në lidhje me statusin e procedimit penal nr. ***, i cili sqaroi se: *“Në datën 28.1.2008, shtetasja S. Sh. (G.) ka paraqitur një kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pretenduar falsifikimin e një kontrate privatizimi banese të vitit 1994, e përdorur në një gjykim civil me palë shtetasin A. G. . Me vendim të datës 19.2.2008, zv. Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z. G. Q., ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. *** të paraqitur nga shtetasja S. Sh. ndaj shtetasit A. G. .*

*Ky vendim i është njoftuar kallëzueses, e cila brenda afatit ligjor ka paraqitur ankim në gjykatë. Me vendimin nr. *** Akti, datë 21.4.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “Prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. ***, datë 28.1.2008, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve...”. Në këtë proces, subjekti ka përfaqësuar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nuk ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi gjyqësor.*

*Nisur nga arsyetimi i vendimit gjyqësor të mësipërm, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 28.5.2008 ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, me vendim të datës 10.6.2009 është vendosur pezullimi i hetimeve të çështjes penale nr. ***, viti 2008, pasi kishte të dhëna të mjaftueshme se firma e shtetasës S. Sh. ishte e falsifikuar, por nuk është bërë e mundur të identifikohet autori i veprës penale.*

*Në datën 20.4.2012, Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rifillimin e hetimeve të pezulluara për procedimin penal nr. ***, viti 2008 dhe hetimet i janë ngarkuar një prokurori tjetër pranë kësaj Prokurorie. Në datën 24.5.2012, prokurori i çështjes ka vendosur: “Pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2018, pasi vepra penale është parashkruar”. Edhe në përmbajtje të këtij vendimi pranohet fakti se kontrata e shitjes objekt hetimi, e sekuestruar në origjinal, ka rezultuar e falsifikuar, pra mbi këtë kontratë nuk mund të disponohet me vendim për kthimin apo lënien në ruajtje të sendit të sekuestruar. Por, kalimi i afatit ligjor ka sjellë për pasojë parashkrimin e ndjekjes penale.*

*Vendimi për pushim i është njoftuar rregullisht palës kallëzuese dhe bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nga verifikimet e kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Penale të Gjykatës për periudhën 2012 – 2023, nuk rezulton që të jetë ushtruar ankim nga palët S. Sh. dhe A. G. / procedimi penal nr. ***”.*

Subjekti në mbështetje të shpjegimeve vendosi në dispozicion të Komisionit kopje të fashikullit të procedimit penal me nr. *** për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi”.

Nga shqyrtimi i dosjes rezulton se:

- Në datën 28.1.2008, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar kallëzimi penal nr. *** për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

- Në datën 19.2.2008, zv. Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z. G. Q., ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin nr. ***, datë 28.1.2008.

- Në vijim të ankimit të kallëzueses S. Sh., me vendimin datë 21.4.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit të mosfillimit dhe ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve në lidhje me këtë kallëzim.
- Në zbatim të vendimit gjyqësor datë 21.4.2008, subjekti i rivlerësimit në datën 28.5.2008 ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe vazhdimin e hetimeve në lidhje me këtë kallëzim.
- Në datën 10.6.2009, subjekti ka marrë vendim për pezullimin e hetimeve të çështjes penale me nr. ***, me arsyetimin se nuk njihet autori i veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”.
- Në datën 20.4.2012, Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rifillimin e hetimeve të pezulluara për procedimin penal nr. ***, viti 2008 dhe hetimet i janë ngarkuar një prokurori tjetër pranë kësaj prokurorie.
- Në datën 24.5.2012, një subjekt tjetër rivlerësimi ka vendosur: “Pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2018, pasi vepra penale është parashkruar”.

Sa më sipër konstatohet se:

- Sipas vendimit nr. *** akti, datë 21.4.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka vendosur prishjen e vendimit “Mosfillimi i procedimit penal nr. ***” dhe kthimin e akteve organit të prokurorisë me qëllim vazhdimin e hetimeve, subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka përmbushur funksionet e prokurorit të parashikuara nga neni 24 i Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka bërë një hetim të plotë në lidhje me kallëzimin e bërë.
- Në çështjen konkrete, subjekti duket se nuk ka zbatuar drejt parashikimet e nenit 66 të Kodit Penal, pasi vepra penale “Falsifikimi i aktit të përpiluar në vitin 1994” ishte parashkruar dhe nuk mund të vijonte ndjekja penale.

Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësimet e tij, subjekti ka sqaruar se në datën 28.1.2008 shtetasja S. Sh. (G.) ka paraqitur një kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pretenduar për falsifikimin e një kontrate privatizimi banese të vitit 1994, kontratë kjo e përdorur në një gjykim civil në vitin 2008 me palë shtetasin A. G..

Në vijim, subjekti ka përshkruar të gjithë hapat ligjorë të ndërmarrë dhe vendimmarrjet përkatëse në mënyrë kronologjike në lidhje me këtë procedim, ku vlen të theksojmë se në datën 24.5.2012 prokurori i çështjes (një prokuror tjetër dhe jo subjekti i rivlerësimit) ka vendosur: “Pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2018, pasi vepra penale është parashkruar”. Edhe në përmbajtje të këtij vendimi pranohet fakti se kontrata e shitjes objekt hetimi, e sekuestruar në origjinal, ka rezultuar e falsifikuar, pra mbi këtë kontratë nuk mund të disponohej me vendim për kthimin apo lënien në ruajtje të sendit të sekuestruar, por kalimi i afatit ligjor ka sjellë për pasojë parashkrimin e ndjekjes penale.

Vendimi për pushimin e çështjes i është njoftuar rregullisht palës kallëzuese dhe bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e në verifikimet e kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Penale të Gjykatës për periudhën 2012 – 2023, nuk rezulton që të jetë ushtruar ankim nga palët S. Sh. dhe A. G. /procedimi penal nr. ***.

Nga trupi gjykues janë kërkuar shpjegime për faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur funksionet e prokurorit të parashikuara nga neni 24 i Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka bërë një hetim të plotë në lidhje me kallëzimin e kësaj shtetaseje. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti rithekson faktin që vendimi për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin nr. *** të shtetasës S. Sh. është marrë nga një prokuror tjetër, zv. Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z. G. Q., me vendim të datës 19.2.2008.

Pas vendimit nr. *** Akti, datë 21.4.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka vendosur prishjen e vendimit të mosfillimit dhe kthimin e akteve organit të prokurorisë me qëllim vazhdimin e hetimeve, në datën 28.5.2008, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, ka kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga gjykata, si dhe veprime të tjera si p. sh. kryerja e ekspertimeve grafike etj. Në përfundim ka arritur në konkluzionin e pasqyruar në vendimin e tij datë 10.6.2009, “Për pezullimin e hetimeve” se shkrimi e nënshkrimi i znj. S. Sh. në aktin objekt ekspertimi nuk duhet të jenë shkruar prej saj, por nga ana tjetër me gjithë veprimet e mundshme hetimore nuk është bërë e mundur të përcaktohet as koha se kur është bërë ky falsifikim nënshkrimi dhe as të identifikohet autori i këtij falsifikimi. Për pasojë është vendosur pezullimi i hetimeve dhe dërgimi i akteve në policinë gjyqësore për zbulimin e autorit të këtij falsifikimi të një akti shkresor që pretendohet të ishte përdorur në vitin 2000.

Lidhur me konstatimin e paraqitur në rezultatet e hetimit nga Komisioni për dyshime se nuk janë zbatuar drejt parashikimet e nenit 66 të Kodit Penal, pasi vepra penale e falsifikimit të aktit të përpiluar në vitin 1994 ishte parashkruar dhe nuk mund të vijonte ndjekja penale, subjekti ka sqaruar se vepra penale “Falsifikimi i dokumenteve” nga ana objektive mund të kryhet nëpërmjet falsifikimit të dokumentit apo përdorimit të tij, si veprime që mund të datojnë në periudha të ndryshme kohore. Edhe në rastin konkret, dokumenti i vitit 1994 rezultonte të ishte përdorur në vitin 2000 e në vijim në një proces gjyqësor civil në vitin 2007 apo 2008, referuar deklarimeve të shtetasve S. (Sh.) G. dhe A. e A. G., pra rezultonte e provuar se në këtë periudhë kohore ishin konsumuar elemente të veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, nëpërmjet përdorimit të një dokumenti të provuar shkencërisht si të falsifikuar.

Sipas Kodit Penal të kohës kur është kryer kjo vepër (viti 2007), parashikohej se: *“Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet...”*

Neni 66 i Kodit Penal parashikon se: *“Nuk mund të bëhet ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit të pandehur kanë kaluar :... c) dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim;... ç) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë...”*

Për sa më lart, subjekti shpjegon se nisur nga interpretimi i dispozitave të sipërcituara rezulton se në vitin 2009 kur ai ka vendosur pezullimin e hetimeve, duke pasur dyshime se falsifikimi mund të ishte kryer në bashkëpunim apo se dokumenti i falsifikuar mund të ishte përdorur më shumë se një herë, ka konkluduar se ndjekja penale nuk ishte parashkruar, pasi kushtëzohej nga kalimi i afatit 5-vjeçar.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, pasi mori në shqyrtim prapësimet e subjektit të rivlerësimit, vëren se subjekti ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me konstatimin e Komisionit. Konkretisht, kallëzimi penal është bërë në datën 28.1.2008 nga shtetasja S. Sh. në lidhje me një kontratë privatizimi të vitit 1994 që pretendohet e falsifikuar. Ky kallëzim është regjistruar me nr. *** dhe si prokuror për ndjekjen e tij është caktuar subjekti i rivlerësimit. Në vendimin e parë, datë 19.2.2008, “Për mosfillimin e procedimit penal” mbi këtë kallëzim, në pjesën hyrëse citohet: *“Unë G. Q., zv. Drejtues në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi studiova kallëzimin penal nr. ***, datë 28.1.2008, konstatova...S. Sh. është në gjykim civil... gjatë gjykimit ajo duhet të kërkojë që të bëhet ekspertimi i kontratës që është përdorur në gjykim dhe nëse rezulton e falsifikuar nga gjykata, të bëhet kallëzim penal. Si e tillë, kjo çështje penale nuk duhet të fillohet”*.

Në pjesën e dispozitivit citohet “Vendosa: Mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin nr. ***, datë 28.1.2008” e në fund vendimi është nënshkruar nga zv. Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z. G. Q., dhe nga subjekti i rivlerësimit. Për këtë arsye, duket se vendimi është marrë dhe arsyetuar nga zv. Drejtuesi i Prokurorisë, ndërsa subjekti i rivlerësimit ka sigluar në cilësinë e prokurorit që ka regjistruar kallëzimin penal dhe ka kryer veprimet e para hetimore. Referuar nenit 24, pika 4 dhe nenit 25, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, duket se në këtë vendim është konkretizuar vullneti vendimmarrës i prokurorit më të lartë. Për këto arsye, subjekti i rivlerësimit nuk ka përgjegjësi direkte në lidhje me këtë vendimmarrje.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit se në çështjen konkrete, *subjekti duket se nuk ka zbatuar drejt parashikimet e nenit 66 të Kodit Penal, pasi vepra penale e falsifikimit të aktit të përpiluar në vitin 1994 ishte parashkruar dhe nuk mund të vijonte ndjekja penale*, Komisioni i gjen të bazuara në prova e në ligj prapësimet e subjektit të rivlerësimit. Referuar nenit 186 të Kodit Penal vepra “Falsifikimi i dokumenteve” nga ana objektive mund të kryhet nëpërmjet falsifikimit të dokumentit apo përdorimit të tij dhe këto veprime mund të datojnë në periudha të ndryshme kohore. Në rastin konkret, kontrata e falsifikuar datonte në vitin 1994 dhe referuar këtij viti, nenit 183 të Kodit Penal që përcakton se “*Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet*”, si dhe nenit 66 të Kodit Penal që përcakton se “*Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë*”, kjo vepër penale mund të ishte parashkruar. Por, nga ana tjetër ekzistonin rrethana të tjera që nuk lejonin pushimin e ndjekjes penale për shkak parashkrimi. Këto rrethana ishin përdorimi i kontratës së falsifikuar si provë në vitin 2000 e në vijim në një proces gjyqësor civil në vitin 2007, si dhe pamundësia për të përcaktuar kohën e saktë (viti 1994 apo ndonjë vit tjetër) se kur është bërë ky falsifikim. Për këto arsye, subjekti, duke mos qenë në kushtet e nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale për pushimin e akuzës ose çështjes, me të drejtë ka vendosur pezullimin e hetimit dhe dërgimin e akteve në Policinë Gjyqësore për zbulimin e autorit të falsifikimit.

Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, pasi ka kryer një sërë veprimesh hetimore përfshirë edhe ekspertimin e shkrimit në kontratën objekt hetimi dhe ka konkluduar se shkrimi e nënshkrimi i znj. S. Sh. në këtë kontratë nuk duket të jenë shkruar prej saj, por ndërkohë nga gjithë veprimet e mundshme hetimore nuk është bërë e mundur të përcaktohet as koha e falsifikimit dhe as të identifikohet autori i falsifikimit, vendimi që subjekti ka marrë në datën 10.6.2009, “Për pezullimin e hetimeve” dhe dërgimin e akteve në policinë gjyqësore për zbulimin e autorit të veprës penale, është i bazuar në prova dhe në përputhje me nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale.

Veprimet procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, përfshirë edhe vendimin për pezullimin e hetimeve, janë në përputhje me afatet procedurale, pa vonesa e zvarritje.

63.4. Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se në procedimin penal nr. ***, për të cilin është depozituar ankesa nr. ***, viti 2009, i shtetases S. Sh. ndaj subjektit të rivlerësimit, nuk konstatohen mangësi, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në lidhje me kriterin profesional.

ANALIZA E GJETJEVE⁴⁶

64. Analiza e gjetjeve në këtë raport bazohet në 3 burime informacioni: (a) në formularin e vetëvlerësimit dhe dokumenteve bashkëlidhur, të paraqitura nga subjekti; (b) në dosjet e përzgjedhura me short; (c) në dokumentacionin arkivor pranë sektorit të protokoll/arkivit në

⁴⁶ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

Prokurorinë e Përgjithshme. Të dhënat nga 23 prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, drejtorisë së përgjimeve të telekomunikimit dhe marrëdhënieve me shërbimet informative dhe zyra e informacionit të klasifikuar, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

64.1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurori Valentin Preçi, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit; shfaq aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi; përdor arsyetim të qartë dhe lidh drejtë normën ligjore me zbatimin e saj në rastin konkret hetimi; ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale; shfaq njohuri të mira edhe në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të akteve që normojnë fushën e ndërtimit, institucioneve përgjegjëse në këtë fushë, detyrave përkatëse të çdo punonjësi të këtyre institucioneve; shfaq njohuri të plota në drejtim të kuptimit të normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Nga dosjet e vëzhguara, konstatohet se subjekti e ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë. Kështu, menjëherë pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti, përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre.

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme, bën interpretim sistematik dhe logjik të normës ligjore në raport me faktin e referuar dhe konkludon në një zgjidhje ligjore të rastit.

b) Arsyetimi ligjor

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara evidentohet se subjekti shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej tij kanë shtjellim të kuptueshëm.

Subjekti organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregon kujdes që konkluzionet e tij të përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt dhe bazës ligjore të përdorur gjatë arsytimit; tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Në tri aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se nga ana e tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit, analizë e zgjeruar e provave të mbledhura, e provave të paraqitura nga mbrojtja, si dhe e kërkesave e pretendimeve të mbrojtjes, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore të çështjeve në ndjekje.

64.2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave rezulton se për periudhën e punës, subjekti i rivlerësimit ka trajtuar 1116 çështje.

Nga gjetjet në 5 dokumentet ligjore të përzgjedhura me short për periudhën e vlerësimit qershor 2014 – tetor 2016, rezulton se nga ana e prokurorit Valentin Preçi tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore

Prokurori Valentin Preçi kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet se nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat në

kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat e aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje. Konstatohet se është respektuar detyrimi për të njoftuar vendimet përkatëse tek subjektet palë në proces.

Gjithashtu, vihet re se qëndrimi i prokurorit në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara, janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

64.3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë prokurori, si dhe nga dosjet e hedhura në short ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Nuk rezulton të ketë pasur ankesa se nga ana e subjektit janë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla, jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Gjatë hetimit administrativ u konstatua se në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar:

- *“24.6.2012 – 24.6.2012, udhëtim në Mal të Zi, brenda ditës. Kam udhëtuar me z. A. F., i cili po shkonte për arsyet e tij në Mal të Zi. Rastësisht kam mësuar se kishte për të shkuar në Mal të Zi dhe i kam kërkuar të udhëtoj me të, me qëllim për t’i dërguar një pako me medikamente mikut tim E. M..*

- *17.7.2012 – 17.7.2012, udhëtim në Prizren, me shtetasin M. F.. Takimi ishte i rastësishëm dhe meqenëse erdha në dijeni të udhëtimit të tij, mendova të shkoja me qëllim që të shihja qytetin e Prizrenit”.*

Në lidhje me këto deklarime të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se duket se udhëtimet me persona të ekspozuar politikisht dhe të proceduar penalisht cenojnë etikën e magistratit. Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Në parashtrimet, subjekti ka shpjeguar se takimi i tij me shtetasin A. F. ka qenë në qytetin e Shkodrës në datën 24.6.2012, kur subjekti është nisur nga Tirana për të shkuar në Ulqin, Mal të Zi, me makinën personale rreth orëve të pasdites. Qëllimi i udhëtimit ishte t’i dërgonte disa medikamente mjekësore/ilaç për dhimbje të forta (subjekti kujton se e ka pasur emrin “Tramadol”) mikut të tij dhe familjes së tij, shtetasit E. M., i cili jeton në Ulqin dhe subjekti ka me të lidhje të vjetra miqësore dhe familjare. Subjekti kujton nga telefonatat me E. shqetësimin dhe urgjencën që ai kishte për gjetjen dhe dërgimin sa më shpejt të atij ilaçi. Subjekti sqaron se ka pyetur në disa farmaci, pasi (ndoshta) kishte mungesë në atë periudhë dhe gjithashtu, për shkak të nevojës së tij urgjente, marrëdhëniet miqësore, dëshirës për ta takuar, ngushëlluar e ndihmuar, ka vendosur që ilaçet t’ia dërgonte vetë.

Subjekti sqaron se sapo është afruar në qytetin e Shkodrës, makina e tij është dëmtuar në pjesën e poshtme të saj (dëmtim sadokardi), si rezultat i punimeve në rrugë dhe ka konstatuar që kishte rrjedhje vaji dhe, për këtë arsye, duke qenë se udhëtimi i tij ishte i pamundur, në këto kushte, vendosi të shkonte për të parkuar makinën pranë lokalit të të afërmit të tij të quajtur Gj. P. dhe të interesohet për riparimin e saj. I afërmi i tij, shtetasi Gj. P., u interesua në lidhje me gjetjen

e ndonjë mekaniku që mund të riparonte makinën, por me gjithë interesimin e tij dhe të vetë subjektit, ishte e pamundur që ky riparim të bëhej po atë ditë, kjo edhe për shkak se ishte ditë pushimi, ditë e diel (me sa kujton).

Në mbrëmje, subjekti sqaron se ka qenë duke darkuar me të afërmin Gj. P. dhe familjen e tij në lokalin e tij, bar-restorant "Athina". Aty ka ardhur për të darkuar edhe shtetasi A. F.. Është përshëndetur me të afërmin e subjektit dhe janë takuar së bashku. Ky ka qenë momenti kur i afërmi i tij i ka thënë se ky shtetas është nga Puka dhe po shkon në Mal të Zi për punët e tij. Subjekti sqaron se e ka pyetur këtë shtetas nëse ishte bezdi për atë që ta merrte rrugën e vajtjes (dalje) dhe kujton se ai i ka thënë "*aspak*", madje nëse subjekti mbaronte punë shpejt mund ta merrte edhe në ardhje (hyrje). Pasi kanë konsumuar vaktet respektive (tavolina të ndryshme) janë nisur për në udhëtim dhe e ka dërguar në hotelin në pronësi të shtetasit E. M.. Subjekti ka takuar E. dhe i ka dhënë ilaçin. Shtetasi A. F. e ka marrë po në hotelin në pronësi të shtetasit E. M. pasi ka mbaruar angazhimet e tij dhe është kthyer po në Shkodër. Gjithë kontakti rastësor me shtetasin A. F. ka qenë ky udhëtim.

Nga momenti që është kthyer në Shkodër, shtetasi A. F. e ka lënë subjektin në banesën e të afërmit Gj. P.. Më pas, subjekti nuk ka pasur më asnjëherë ndonjë komunikim, kontakt apo takim qoftë edhe të rastësishëm me këtë shtetas. Në momentin që subjekti ka marrë informacion nga media për problemet e këtij shtetasi me ligjin, duke qenë se kontakti ka qenë rastësor dhe marrëdhënia me këtë shtetas ka qenë tërësisht indiferente (nuk ka pasur kurrë asnjë marrëdhënie) dhe është kujdesur që të mos ketë asnjë kontakt qoftë edhe të rastësishëm me të (prezenca ime në të njëjtat ambiente me këtë shtetas), duke treguar në këtë mënyrë një kujdes edhe më të shtuar në respekt të parimeve individuale dhe të detyrimit ligjor për statusin e magjistratit.

Në lidhje me deklaratimet e tij për kalimin në kufi me shtetasin M. F. , subjekti vlerëson të domosdoshme të shpjegojë rrethanat e takimit me këtë shtetas. Konkretisht, subjekti deklaron se në datën 17.7.2012 (data i kujtohet nga udhëtimi i deklaruar) ka shkuar për të takuar në ambientet e punës së saj shtetasen D. A., e cila është kushëriri e parë e babait të subjektit. Ajo ka një biznes të përpunimit të drurit të quajtur "****". Aty ka ardhur edhe shtetasi M. F., të cilin kushërira ia prezantoi si biznesmen dhe që kishte origjinë nga një fshat i rrethit Pukë, i quajtur K.. Ky shtetas interesohej për porositjen e disa mobilieve dhe biseda ka qenë rreth sasisë dhe çmimit të tyre. Ka dëgjuar rastësisht se shtetasi M. F. menjëherë pas këtij takimi në datën 17.7.2012 do të udhëtonte për në Prizren, Kosovë, dhe meqë kishte për të qëndruar një kohë shumë të shkurtër në Prizren (disa orë), subjekti mendoi të shkojë edhe ai pasi nuk kishte qenë asnjëherë në Kosovë. Kanë shkuar në Prizren, ku ai ka përfunduar angazhimet e tij, ndërsa vetë subjekti ka shëtitur-vizituar qytetin e Prizrenit dhe në kthim kanë ardhur në Tiranë po në datën 17.7.2012. Ky ka qenë kontakti (rastësor) i parë dhe i fundit me këtë shtetas. Për këtë shtetas, subjekti nuk ka pasur asnjë lloj informacioni që të ketë qenë person me precedent penal apo i ekspozuar politikisht.

Në zgjedhjet e përgjithshme qershor 2013, sikurse është publikisht e ditur, shtetasi M. F. ka garuar për deputet në Kuvendin e Shqipërisë dhe qoftë para apo pas marrjes së mandatit të tij (shtetasit M. F.) subjekti sqaron se nuk ka pasur asnjë kontakt qoftë edhe të rastësishëm (prezencë në të njëjtat ambiente me këtë shtetas) apo marrëdhënie me këtë shtetas.

Sa i përket cenimit të etikës së magjistratit, subjekti shpjegon se në vlerësimin e tij, kontakti rastësor me këta dy persona, i ndodhur përpara se ata të ishin të ekspozuar politikisht apo të proceduar penalisht, nuk përbën cenim të etikës nga ana e tij, për sa kohë që edhe para se të kishte rënë në dijeni të problemeve të tyre me drejtësinë apo angazhimeve politike, ai nuk ka pasur asnjë kontakt tjetër të çfarëdolloji (tej asaj që ka shpjeguar më sipër) me këta shtetas. Subjekti asnjëherë nuk është shoqëruar me njerëz që kanë qenë të proceduar penalisht as me ata, as me ndonjë person të afërm të tyre, madje as marrëdhënie shoqërore të përbashkëta nuk

ka pasur asnjëherë. Gjithashtu, nuk ka pasur as ndonjë çështje penale, ku ata të kenë qenë të hetuar.

Subjekti përfundon arsyetimin duke deklaruar se vlerësimi i anës subjektive është elementi thelbësor për të bërë një interpretim të plotë dhe për t'í dhënë një kuptim të drejtë përkufizimit që jep ligji, për sa i përket etikës së magjistratit, në zbatim të Kushtetutës. Marrëdhënia e vendosur qëllimisht është një marrëdhënie që vendoset ose mbahet nga subjekti i rivlerësimit sipas zgjedhjes së tij/marrëdhënie shoqërore. Nga tërësia e dokumentacionit të administruar, shpjegimeve të subjektit në kuadër të hetimit administrativ në lidhje me këtë fakt, duke mbajtur në vëmendje se ai me këta persona nuk ka pasur asnjë kontakt tjetër, komunikim apo marrëdhënie të çdo lloji (shoqërore apo lidhje të posaçme), nuk ka pasur ndonjëherë çështje në ngarkim të tyre (përveç këtyre dy udhëtimeve të rastësishme), nuk ka pasur kontakte me ata, as komunikime elektronike apo takime të qëllimshme, që do të binin në kundërshtim me etikën e magjistratit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Në lidhje me konstatimin e Komisionit se *duket që udhëtimet me persona të ekspozuar politikisht dhe të proceduar penalisht cenojnë etikën e magjistratit (udhëtimet e subjektit me shtetasin A. F. në datën 24.6.2012 – 24.6.2012 në Mal të Zi, brenda ditës dhe me shtetasin M. F. në datën 17.7.2012 – 17.7.2012 udhëtim në Prizren)*, Komisioni mban në konsideratë disa rrethana për shkak të të cilave shpjegimet e subjektit të rivlerësimit i gjen bindëse. Konkretisht:

- Subjekti i rivlerësimit nuk i ka fshehur këto dy kontakte, por që në pyetësonin standard i ka deklaruar me transparencë të plotë dhe me detaje, të cilat vlerësohen të besueshme nga Komisioni në lidhje me takimet me këta shtetas.

- Takimi me secilin nga këta shtetas nuk u vërtetua të jetë i planifikuar dhe i qëllimshëm.

- Qëllimi i secilit nga dy udhëtimet ka qenë në një rast për veprime humane njerëzore dhe në një rast për vizitë turistike të shkurtër njëditore. Gjithashtu, njohjet që të afërmit e subjektit (por jo personat e lidhur me subjektin) kishin me këta dy shtetas kanë qenë një lloj sigurie për subjektin se nuk po shoqërohej me persona me precedentë kriminalë dhe në situatë normale gjithkush ka një farë sigurie kur shoqërohet për disa orë (jo në vazhdimësi) me të njohurit e të afërmit të tij.

- Kontakti rastësor i subjektit të rivlerësimit me këta dy shtetas ka ndodhur kohë përpara se ata të ekspozoheshin politikisht apo të procedoheshin penalisht dhe pas atij kontakti subjekti nuk rezultoi të ketë pasur ndonjë kontakt apo komunikim me mënyra të tjera me ta.

- Subjekti nuk ka pasur kontakt as me ndonjë person të afërm të këtyre shtetasve.

- Subjekti, pasi është informuar nga mediat për problemet e këtyre shtetasve me ligjin, është kujdesur që të mos ketë asnjë kontakt tjetër qoftë edhe rastësor me ta.

- Nga të dhënat e organeve ligjzbatuese që ka administruar Komisioni gjatë hetimit administrativ nuk janë provuar kontakte apo komunikime elektronike/telefonike, udhëtime të tjera të subjektit me këta shtetas; nuk është provuar, qoftë edhe me indicie as që subjekti të jetë vënë nën presion nga këta shtetas; nuk është provuar as që subjekti të ketë tendencën për t'u përfshirë në veprime kriminale me këta shtetas (veprime këto në kuptim të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016).

Në përmbledhje të sa më lart cituar, Komisioni bazohet në faktet se subjekti nuk ka pasur asnjë lidhje (përveç nga një takim rastësor me secilin nga këta shtetas); nuk ka ndjekur ndonjë proces penal të tyre; pasi është informuar për problemet e tyre me ligjin është përpjekur të tregojë kujdes që të mos ketë asnjë kontakt tjetër, qoftë rastësor me ta; nuk ka të dhëna nga organet ligjzbatuese për kontakte të vazhdueshme të subjektit me këta shtetas. Neni 34 i ligjit nr. 84/2016 përcakton se kontrolli i figurës së subjektit të rivlerësimit bazohet në verifikimin e

kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Kuptimi i kontakteve të papërshtatshme, sipas nenit 3, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, është *një takim, komunikim verbal apo elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi e qëllimshme, që nuk përputhet dhe/ose nuk ka lidhje me ushtrimin e detyrës nga punonjësi, pavarësisht nëse vendoset marrëdhënie biznesi apo ndonjë marrëdhënie tjetër.*

Nga rrethanat më lart nuk rezultoi që takimi i subjektit me secilin nga të dy shtetasit F. të ketë qenë i qëllimshëm.

Referuar nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, në rastin konkret nuk ekzistojnë rrethana rënduese që përcakton pika 4 e këtij neni për efekt të konstatimit nëse ekziston ose jo një kontakt i papërshtatshëm. Nga ana tjetër, në rastin konkret, duke mbajtur parasysh shpjegimet e subjektit dhe mungesën e informacionit nga organet ligjzbatuese, ekzistojnë rrethanat lehtësuese të përcaktuara nga pika 5 e këtij neni për efekt të konstatimit se nuk ka “kontakte të papërshtatshme”.

Për më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime që cenojnë figurën, etikën dhe integritetin e tij si magjistrat.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Valentin Preçi dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e zgjedhura me short, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Valentin Preçi; nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit; në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar.

64.4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjet e përzgjedhura me short vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit Valentin Preçi për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016 nga Prokurori i Përgjithshëm, rezultojnë se është vlerësuar “Shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti Valentin Preçi rezultojnë se ka marrë pjesë në trajnimin me temë në fushën penale, të organizuar pranë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

DENONCIME

65. Denoncim i shtetasit M. L., regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 27.1.2022, drejtuar kundër disa subjekteve të rivlerësimit, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit Valentin Preçi.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit të mosfillimit që ka marrë subjekti i rivlerësimit për një kallëzim penal të bërë në vitin 2021, për një çështje që i përket vitit 2005. Nga dokumentacioni i verifikuar rezultoi se vendimmarrja ka ardhur si rezultat i parashkrimit të afateve për ushtrimin e ndjekjes penale. Lidhur me këtë denoncim, Komisioni nuk vërejtí problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

Komisioni nuk gjen indicie për fillimin e hetimeve të mëtejshme në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

66. Denoncimi i *.-së**, regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 24.12.2018, kundër subjektit të rivlerësimit.

Denoncuesi ankohet se në lidhje me procedimin penal nr. ***, subjekti: (i) nuk e ka analizuar figurën e veprës penale; (ii) nuk ka arsyetuar në asnjë moment të vetëm lidhjen shkakësore të veprimeve të personit juridik; (iii) nuk e ka njoftuar bankën për përfundimin e hetimeve dhe njoftimin e akuzës; (iv) në median audiovizive dhe të shkruar nga ana e organit të prokurorisë ka rrjedhur informacioni për bankën duke cenuar rëndë hetimin ligjor; (v) ka treguar mungesë profesionalizmi, duke shfaqur doza të forta njëanshmërie dhe arbitrarë, duke shkaktuar padrejtësi, cenim të integritetit. Lidhur me këtë denoncim, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime të shoqëruar me dokumentacionin provues ligjor.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësime, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nga pala ankuese paraqiten një sërë pretendimesh ndaj tij si prokuror i çështjes që ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale me pallë kallëzuese A. D. dhe të pandehur ***, L. S. etj. Në vijim, subjekti ka paraqitur qëndrimin e tij për çdo pretendim të pabazuar në këtë denoncim, duke theksuar në parantezë se aktualisht denoncuesi *** ka statusin e të pandehurit, për sa kohë që çështja penale ndodhet e regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, referuar shkresës nr. *** prot., datë 24.11.2023, dhe është në pritje të planifikimit për t’u shqyrtuar.

Në fashikullin e këtij procedimi penal ndodhet akti për njoftimin e akuzës ndaj subjektit tregtar ***. Në kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim dhe në aktin procedural Konkluzione Përfundimtare pasqyrohen hollësisht rrethanat e çështjes, fakti penal objekt hetimi, provat e administruara, gjithashtu janë analizuar elementet e figurës së veprës penale “Mashtrimi”, që ngarkojnë me përgjegjësi penale të pandehurit në proces si pasojë e pakësimit të pasurisë së viktimës A. D..

Nuk qëndron as pretendimi i BKT-së për mungesë arsyetimi të lidhjes shkakësore të veprimeve të personit juridik me pasojën e ardhur, pasi nga shqyrtimi i hollësishëm i përmbajtjes së akteve procedurale në fashikull pasqyrohet një analizë e plotë e bazës ligjore, konkretisht nenit 3 e vijues të ligjit nr. 9754, viti 2007 “Për përgjegjësinë penale të personit juridik”, që në interpretim të organit të akuzës passjell lindjen e përgjegjësisë penale për personin juridik ***, edhe për veprimet e paligjshme të kryera nga punonjësit e ***-së gjatë ushtrimit të detyrës, V. G., V. D. apo A. B., ku, për shembull, kjo e fundit është deklaruar fajtorë sipas vendimit penal nr. ***, datë 23.4.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i cili ka marrë edhe formën e prerë.

Lidhur me pretendimin e ***-së se nuk është njoftuar për përfundimin e hetimeve dhe njoftimin e akuzës, subjekti sjell në vëmendje aktet e ndodhura në fashikullin gjyqësor. Në datën 23.7.2018 është vendosur marrja në cilësinë e të pandehurit edhe njoftimi i akuzës për shoqërinë tregtare *** sh. a., përfaqësuar nga administratori K. P., i cili e ka nënshkruar këtë akt procedural në prani të përkthyesit të licencuar, z. S. D., në datën 27.7.2018. Po ashtu, në fashikull ndodhet njoftimi përkatës për përfundimin e hetimeve nënshkruar po nga z. K. P., si dhe procesverbali i datës 27.7.2018, nënshkruar nga administratori i *** dhe OPGJ A. E..

Denoncuesi aludon edhe për rrjedhje informacioni në median audiovizive dhe të shkruar nga ana e organit të prokurorisë, informacion ky që për bankën ka cenuar rëndë hetimin ligjor. Subjekti e kundërshton edhe këtë pretendim si tërësisht të pabazuar, pasi hetimi ka qenë sekret deri në përfundim të hetimeve paraprake. Çuditërisht anashkalohet fakti që aktet e këtij procedimi penal u janë njoftuar 6 të pandehurve dhe viktimës në proces, e pa asnjë bazë logjike apo faktike pretendohet për rrjedhje informacioni nga prokurori i çështjes. Vetëm pas dërgimit të çështjes në gjykatë, media vizive apo e shkruar ka pasur gjithë të drejtën të publikojë akte nga fashikulli gjyqësor, duke pasqyruar të dhëna të provuara gjatë hetimeve, madje cilido ka të drejtë të jetë i pranishëm në sallën e gjykimit, për sa kohë që procesi nuk zhvillohej me dyer të mbyllura.

Rasti konkret përbën një nga procedimet penale që tregojnë përvojë dhe profesionalizëm të organit të akuzës, pavarësisht qëndrimit të gjykatës apo mbrojtjes së të pandehurve. Është detyrim ligjor i organit të akuzës respektimi i të drejtave procedurale të viktimës në proces, madje neni 9/a i Kodit të Procedurës Penale kërkon garanci që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor, si dhe të mbrohen nga ridëmtimi.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Pasi mori në shqyrtim prapësimet e subjektit, Komisioni vlerëson se në lidhje me dy pretendimet e denoncuesit se subjekti: (i) nuk e ka analizuar figurën e veprës penale; (ii) nuk ka arsyetuar lidhjen shkakësore të veprimeve të personit juridik, Komisioni, në referim të nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, çmon se këto veprime të subjektit kanë të bëjnë me themelin e çështjes, me aspektin material të saj dhe jo atë procedural. Për këto arsye, Komisioni nuk ka kompetencë të hetojë dhe vlerësojë për këto veprime të subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se subjekti nuk e ka njoftuar bankën për përfundimin e hetimeve dhe njoftimin e akuzës, subjekti ka provuar se në fashikullin gjyqësor ndodhen: vendimi datë 23.7.2018 për marrjen në cilësinë e të pandehurit dhe njoftimi i akuzës për shoqërinë tregtare *** sh.a., i nënshkruar nga administratori i saj K. P., në prani të përkthyesit të licencuar S. D., në datën 27.7.2018; njoftimi përkatës për përfundimin e hetimeve, nënshkruar nga shtetasi K. P.; si dhe procesverbali datë 27.7.2018, nënshkruar nga administratori i ***-së dhe OPGJ A. E.. Pra, rezulton se njoftimi i akuzës është kryer nga subjekti i rivlerësimit.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se në median audiovizive dhe të shkruar nga ana e organit të prokurorisë ka rrjedhur informacioni për bankën, duke cenuar rëndë hetimin ligjor, Komisioni vlerëson se në kushtet kur denoncuesi aludon dhe nuk provon me prova bindëse se sekretet hetimor ka dalë pikërisht nga organi i prokurorisë, si dhe në kushtet kur sipas deklaramit të subjektit, me aktet e hetimit janë njohur dhe kanë pasur dijeni të gjitha palët në proces, përfshirë edhe 6 të pandehurit, përgjegjësia për këtë rrjedhje informacioni nuk mund të bjerë personalisht mbi subjektin e rivlerësimit. Madje edhe neni 279, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale përcakton se: “*Veprimet hetimore janë sekrete derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijeni për to*”. Gjithashtu, denoncuesi pretendon se informacioni ka rrjedhur nga “organi i prokurorisë” duke i dhënë këtij termi cilësimin si institucion dhe jo cilësimin e prokurorit të çështjes si individ.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se subjekti ka treguar mungesë profesionalizmi, duke shfaqur doza të forta njëanshmërie dhe arbitrare, duke shkaktuar padrejtësi, cenim të integritetit, Komisioni vlerëson se denoncuesi nuk ka provuar me prova dhe në cilat raste konkrete subjekti ka kryer këto veprime. Subjekti nga ana e tij pretendon se në këtë procedim ka treguar profesionalizëm, pavarësisht qëndrimit të gjykatës apo mbrojtjes së të pandehurve. Nisur nga kjo, Komisioni vlerëson se jo në çdo rast kur vendimmarrja e gjykatës nuk përkon

me vendim marrjen e prokurorit, ka vend për mungesë të profesionalizmit nga ana e këtij të fundit, pasi përveç përcaktimeve ligjore dhe provave, faktor në vendimmarrje është edhe bindja e brendshme e secilit organ që është palë në procesin penal.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se pretendimet e denoncuesit në këtë denoncim nuk qëndrojnë dhe subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për veprimet e pretenduara nga denoncuesi.

67. Denoncimi i shtetasit E. S., regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 18.2.2019, kundër disa subjekteve të rivlerësimit, përfshirë edhe subjektin Valentin Preçi.

Denoncuesi ankohet se në lidhje me procedimin penal nr. *** dhe ***, ku denoncuesi ka qenë në cilësinë e kallëzuesit del qartë skema e organizuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili nuk kryen asnjë veprim hetimor. Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dosje të fashikullit përkatës për kallëzimin penal nr. *** dhe ***. Me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi në dispozicion kopje të fashikullit të procedimit penal nr. ***. Ndërsa për sa i përket procedimit penal nr. ***, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë informon Komisionin se pas verifikimeve rezulton se për shtetasin J. Q. çështja është pushuar dhe për pjesën tjetër të hetimeve është marrë vendim për pezullim në datën 25.6.2015. Në lidhje me fashikullin penal, prokuroria i është drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë për të disponuar materialin.

Nga shqyrtimi i dosjes rezulton se procedimi penal nr. *** është trajtuar nga një subjekt tjetër rivlerësimi, për rrjedhojë Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me këtë procedim, si *indicie* për fillimin e hetimeve të mëtejshme në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

68. Denoncimi i shtetasit R. Z., regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 29.10.2020 dhe nr. *** prot., datë 20.1.2021, kundër subjektit të rivlerësimit.

Denoncuesi ankohet për subjektin e rivlerësimit për zvarritje të hetimeve dhe se subjekti nuk e ka pyetur denoncuesin në cilësinë e kallëzuesit. Nisur nga fakti që pretendimet e denoncuesit nuk referojnë ndonjë provë apo shkelje procedurale konkrete nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk gjen *indicie* për fillimin e hetimeve të mëtejshme në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

69. Denoncimi i shtetasit B. A., regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 11.9.2018, kundër subjektit të rivlerësimit me objekt “Korrupsion dhe mungesë profesionalizmi”. Më konkretisht, denoncuesi pretendon se subjekti e mbylli çështjen pa hetim, pa marrë në pyetje dëshmitarë dhe pa kontaktuar me personin e kallëzuar për veprën penale “Mashtrimi”. Komisioni administroi dosjen e fashikullit për procedimin penal nr. ***, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga shqyrtimi i dosjes rezulton në mënyrë kronologjike se:

- Në datën 24.5.2016, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar kallëzimi penal nr. *** për veprën penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal mbi bazën e kallëzimit të shtetasit B. A. në ngarkim të shtetasit N. V..

- Në përfundim të veprimeve hetimore nga ana e organit të akuzës është konkluduar se fakti i mësipërm nuk përben elemente të veprës penale, pasi kjo është një marrëdhënie juridiko-civile dhe, si e tillë, duhet të vendoset mosfillimi i procedimit penal nr. ***, vitit 2016.

- Me vendimin nr. *** akti, datë 11.11.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: Pranimin e kërkesës së kërkuesit B. A.; anulimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal për kallëzimin penal nr. *** të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kryerjen e hetimeve të mëtejshme. Rezulton se ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me

vendimin nr. ***, datë 23.4.2018, ka lënë në fuqi vendimin nr. *** akti, datë 11.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Në datën 28.5.2018, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. *** për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, duke urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore për këtë procedim penal nga OPGJ L. A..

- Në vijim të veprimeve hetimore me shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2018, i është përcjellë Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Ministrinë e Drejtësisë kërkesa për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve të drejtësisë së shtetit rumun.

- Me urdhrin e datës 14.11.2018, subjekti i rivlerësimit njofton shtetasin rumun N. V. të paraqitet pranë organit të akuzës për t’u pyetur si person që ka dijeni për veprën penale.

- Më 25.2.2019, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, pikërisht emrin e shtetasit nën hetim N. V. për veprën penale “Mashtrimi” e parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.

- Në datën 26.2.2019, subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë vendimin mbi deklarin e mosgjetjes se shtetasit N. V..

- Në përfundim të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në kuadër të procedimit penal, ka paraqitur në gjykatë kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes nr. *** në ngarkim të shtetasit N. V. për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 23.4.2019, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit N. V. për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi” dhe në bazë të nenit 143/3 të Kodit Penal dënimin e tij me 5 vjet burgim”.

Sa më sipër konstatohet se:

Nga analiza e fashikullit ka rezultuar se nga ana e organit të akuzës, me regjistrimin e kallëzimit penal nr. *** të shtetasit B. A. nuk janë kryer veprime procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit, i cili ka arritur në konkluzionin se fakti i mësipërm nuk përbën elemente të veprës penale, pasi kjo është një marrëdhënie juridiko - civile dhe, si e tillë, duhet të vendoset mosfillimi i procedimit penal nr. ***, viti 2016.

Pasi gjykata e ka shqyrtuar çështjen, ka vendosur të anulojë vendimin e mosfillimit dhe ka detyruar organin procedural të kryejë hetime. Gjykata ka konstatuar se organi i akuzës nuk ka kryer një hetim të plotë dhe për këtë arsye vendimi duhet të kthehet pranë këtij organi për hetime të mëtejshme.

Në përfundim të hetimeve, subjekti i është drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjykim ndaj shtetasit N. V. për veprën penale “Mashtrimi” të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.

Nisur nga faktet që rezultojnë në dosje, Komisioni ka konstatuar mangësi profesionale nga ana e subjektit në hetimin e kësaj çështjeje.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka ngarkuar subjektit barrën e provës për të dhënë argumente në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësimet e tij, subjekti i rivlerësimit shpjegon se ankuesi ka pretendime ndaj tij për korrupsion dhe mungesë profesionalizmi, edhe pse çështja penale e iniciuar nga denoncuesi është dërguar për gjykim dhe i pandehuri është deklaruar fajtor, sipas vullnetit të kallëzuesit B. A..

Denoncuesi ka pretenduar se subjekti e ka mbyllur çështjen pa hetim, pa marrë në pyetje dëshmitar dhe pa kontaktuar aspak me personin e kallëzuar për veprën penale “Mashtrimi”. Por përmbajtja e fashikullit hetimor pasqyron qartë të gjitha përpjekjet e kryera gjatë hetimit për të marrë në pyetje shtetasin rumun N. V., i cili është hetuar e gjykuar në mungesë.

Në lidhje me konstatimin e trupit gjykues të Komisionit, subjekti shpjegon se në momentet e para të verifikimit të materialit kallëzues të shtetasit B. A., i është krijuar përshtypja se fakti i kallëzuar nuk përmbante elemente të veprës penale, pasi ishte një marrëdhënie juridike-civile dhe, si e tillë, duhet të vendosej mosfillimi i procedimit penal. Natyrisht që ky vendim është marrë pa kryer asnjë veprim procedural, nisur edhe nga mënyra e paraqitjes së rrethanave të faktit nga B. A. në kallëzimin e tij.

Pas vendimeve gjyqësore për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit janë kryer disa veprime hetimore dhe janë bërë përpjekje për të kontaktuar dhe marrë në pyetje shtetasin e kallëzuar N. V., përpjekje që kanë rezultuar pa sukses edhe për shkak të qëndrimit të tij në Rumani. Ripyetja e kallëzuesit ka ndihmuar organin e akuzës në detaje të tjera të marrëdhënies mes dy ish-ortakëve në biznes, detaje që kanë krijuar bindjen se shtetasi N. V. kishte përdorur gënjeshtren dhe shpërdoruar besimin e kallëzuesit për shtënien në dorë të shumës 60.000 euro. Edhe deklarata shkresore e paraqitur nga i pandehuri, deklarimet e të pyeturve I. K. dhe aktet e tjera shkresore në fashikull, konkludonin drejt marrjes së shtetasit të kallëzuar N. V. në cilësinë e të pandehurit, i cili është deklaruar fajtor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe çështja penale ndodhet e regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, referuar shkresës nr. *** prot., datë 24.11.2023, në pritje të planifikimit për t'u shqyrtuar.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Pasi mori në shqyrtim prapësimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni rithekson se në rastin e këtij procedimi penal, nisur nga fakti që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur⁴⁷ anulimin e vendimit të subjektit për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. ***; nisur nga fakti që pasi kanë rifilluar hetimet ka rezultuar se shtetasi N. V. e ka kryer veprën penale “Mashtrimi” për të cilën akuzohej dhe është dënuar nga gjykata për këtë veprë penale, vendimi i subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë i drejtë.

Megjithatë, Komisioni mban në konsideratë edhe faktet që subjekti: nuk e ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka anuluar vendimin e tij të parë për mosfillimin e procedimit penal; ka kryer të gjitha detyrat dhe hetimet e orientuara nga gjykata; ka kërkuar në përfundim të hetimeve të riçelura gjykimin e shtetasit N. V. si fajtor për veprën penale; gjykata në gjykimin e themelit të kësaj çështjeje ka konkluduar njësoj si subjekti me shpalljen fajtor dhe dënimin e të pandehurit N. V.; si dhe ka mbajtur qëndrim pohues në prapësime për këtë veprim të tij.

Nisur nga këto rrethana, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në përfundim ka marrë një vendim të drejtë duke treguar profesionalizëm dhe vendimmarrja e parë e tij për “Mosfillimin e procedimit penal”, e bazuar në përmbajtjen e kallëzimit dhe në bindjen e tij të brendshme, krijojnë tek Komisioni bindjen se vendimi i parë i subjektit, pavarësisht se rezultoi i gabuar, nuk është marrë me qëllim favorizimin e të pandehurit, aq më tepër që nuk u provuan me prova shkresore apo me ndonjë *indicie* veprimet korruptive të subjektit të rivlerësimit në raport me të pandehurin N. V..

Për sa më lart, Komisioni në përfundim çmon që vendimin e subjektit të rivlerësimit “Për mosfillimit të procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***”, ta vlerësojë në tërësinë e veprimeve të subjektit për këtë procedim dhe në tërësi, gjatë vlerësimit profesional të tij duke

⁴⁷ Me vendimin nr. *** akti, datë 11.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

i dhënë një peshë të konsiderueshme edhe parimit të proporcionalitetit në lidhje me veprimet/problematikat e konstatuara nga Komisioni për rastin në fjalë.

70. Denoncimi i shtetasit D. B. (i përsëritur katër herë), regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 7.2.2020, nr. *** prot., datë 10.3.2020, nr. *** prot., datë 7.7.2020, nr. *** prot., datë 8.9.2020, kundër disa subjekteve të rivlerësimit, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit Valentin Preçi, i cili nuk ka të përcaktuar qartë shkaqet e ankimit. Nisur nga fakti që pretendimet e denoncuesit nuk referojnë ndonjë provë apo shkelje procedurale konkrete nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk gjen *indicie* për fillimin e hetimeve të mëtejshme në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

71. Denoncimi i shtetasit D. N., i përsëritur katër herë, regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 9.7.2017, nr. *** prot., datë 16.7.2018, nr. *** prot., datë 19.2.2020, nr. *** prot., datë 8.7.2020, kundër subjektit të rivlerësimit. Denoncuesi ankohet në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2014, regjistruar për veprën penale “Prodhim të kundërligjshëm të artikujve ushqimorë dhe industrialë”, “Falsifikim të vulave, stampave dhe formularëve” dhe “Fshehje të ardhurash”. Më konkretisht, denoncuesi pretendon se ka qëndruar padrejtësisht në ambientet e paraburgimit dhe masa e sigurimit “Arrest me burg” është dhënë në kundërshtim të parashikimeve të legjislacionit përkatës procedural penal. Shkeljet procedurale të subjektit të rivlerësimit kanë cenuar të drejtën për liri dhe siguri të denoncuesit.

Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dosje të fashikullit përkatës për kallëzimin penal nr. ***. Me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi në dispozicion kopje të fashikullit penal.

Nga shqyrtimi i dosjes rezulton në mënyrë kronologjike:

- Në datën 4.3.2015, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimi penal nr. ***, vitit 2015, për veprën penale “Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve ushqimorë dhe industrialë”, “Falsifikim të vulave dhe stampave dhe formularëve kryer në bashkëpunim” dhe “Fshehje të ardhurash”, parashikuar nga nenet 288/a/2, 190/2 dhe 180 të Kodit Penal në ngarkim të shtetasve D. N. dhe I. V..

- Në datën 4.3.2015, subjekti i rivlerësimit nxjerr urdhër për regjistrimin e procedimit penal;

- Në datën 4.3.2015, OPGJ-ja ka dhënë informacion për referim të veprës penale. Janë kryer veprime hetimore paraprake nga ana e OPGJ-së si: procesverbali i kapjes në flagrancë, procesverbal i arrestit në flagrancë datë 3.3.2015; procesverbal i kontrollit personal të shtetasit D. N. datë 3.3.2015; procesverbal i këqyrjes së vendit të ngjarjes datë 3.3.2015; kërkesa drejtuar gjykatës për vlerësimin e ligjshëm të arrestimit të personave të dyshuar për kryerjen e veprës penale.

- Në datën 5.3.2015, subjekti ka dërguar në gjykatë kërkesa për vlerësim arresti dhe caktim mase sigurimi për të tre të dyshuarit për veprat penale “Prodhim i paligjshëm i artikujve ushqimorë dhe industrialë”, “Falsifikim të vulave, stampave dhe formularëve”, kryer në bashkëpunim dhe “Fshehje të ardhurash”, parashikuar nga nenet 288/a/2, 190/2 dhe 180 të Kodit Penal.

- Në datën 4.3.2015, subjekti ka vendosur vlerësimin e sekuestros.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 6.3.2015, vendosi vlerësimin e paligjshëm të arrestit në flagrancë të personit nën hetim G. H. dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim subjekti i rivlerësimit dhe Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Me vendimin nr. *** akti, datë 7.4.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: Zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale në atë të “Detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale për të dyshuarin D. N. .

- Në datën 22.5.2015, OPGJ-ja ka dorëzuar relacionin për përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, ku ka sugjeruar: (1). dërgimin në gjyq të të pandehurve G. H. dhe I. V. për veprën penale të parashikuar nga nenet 288/a/1 dhe 190 të Kodit Penal; (2). pushimin e akuzës për personin nën hetim D. N. bazuar në nenet 34/4 dhe 328/1/b të Kodit të Procedurës Penale. (3). shuarjen e masës së sigurimit personal të caktuar nga gjykata me vendimin nr. ***, datë 7.4.2015.

- Në datën 25.5.2015, subjekti i rivlerësimit urdhëron dërgimin e çështjes në gjykim ndaj personave G. H. dhe I. V., si dhe vendimin për pushimin e hetimeve ndaj shtetasit D. N..

- Në datën 21.10.2015, në bisedimet përfundimtare subjekti i rivlerësimit kërkon: deklarinin fajtor të të pandehurit I. V. dhe dënimin e tij me një vit burg për veprën penale “Falsifikim i vulave dhe stampave”; deklarinin fajtor të të pandehurit G. H. dhe dënimin e tij me 13 muaj burg për veprën penale “Prodhim i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale e ushqimorë”.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 18.11.2015, ka vendosur: Deklarimin fajtor të të pandehurit G. H. dhe e ka dënuar me 1 vit burg, ndërsa të pandehurin I. V. e ka shpallur të pafajshëm. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë nga subjekti i rivlerësimit.

Sa më sipër, konstatohet se: (i) Nga analiza e fashikullit ka rezultuar se pretendimet e denoncuesit qëndrojnë pasi ai ishte ndaluar, kishte qëndruar në ambientet e paraburgimit dhe i është hequr liria padrejtësisht duke u akuzuar për vepra penale, të cilat ai nuk i kishte kryer; (ii) Procedimi penal ndaj tij ka qenë i pabazuar në fakte dhe prova dhe në vendimin e pushimit të hetimeve në ngarkim të tij, organi i akuzës ka arritur në konkluzionin se ky shtetas nuk ka bashkëpunuar me asnjërin nga të pandehurit dhe se ka qenë fare rastësisht tek pastiçeria e të pandehurit I. V., për shkak të njohjeve që ka pasur me këtë të fundit; (iii) Nisur nga faktet që rezultojnë në dosje, Komisioni konstaton mangësi profesionale nga ana e subjektit të rivlerësimit në hetimin e kësaj çështjeje. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka ngarkuar subjektin të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë argumente në lidhje me këto konstatime.

Ky denoncim është trajtuar më lart tek kapitulli “Vlerësimi profesional”, kreu III (Të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime), tek ankesa nr. ***.

72. Denoncimi i shtetasit A. H., regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 24.1.2023, ku denoncuesi ankohet se subjekti nuk i ka njoftuar vendimin për pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2021, duke shkelur dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Komisioni ka administruar⁴⁸ nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë dosjen e fashikullit përkatës për kallëzimin penal nr. **. Nga shqyrtimi i dosjes rezulton:

- Në datën 3.12.2021, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë është urdhëruar nga një subjekt tjetër rivlerësimi regjistrimi i procedimit penal nr. *** për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal me kallëzues shtetasin A. H., mbi bazën e akteve të dërguara për kompetencë nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë.

⁴⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Në datën 3.10.2022, subjekti i rivlerësimit është caktuar në cilësinë e prokurorit të çështjes, me short elektronik.

- Në datën 4.11.2022, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur para gjyqtarit të seancës paraprake të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën penale me objekt: “Pushimi i çështjes nr. ***, regjistruar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, me arsyetimin se mungojnë veprimet në kundërshtim me ligjin material penal dhe në bazë të nenit 328/1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

- Në lidhje me kërkesën, gjyqtari i seancës paraprake me vendimin nr. ***, datë 15.3.2023, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës së përfaqësuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e procedimit penal nr. ****”.

Nga analizimi i fashikullit të dosjes duket se nuk konstatohet dërgimi dhe marrja dijani nga palët e interesuara të “kërkesës për pushimin e çështjes” sikundër parashikon neni 329/a/4: *“Kërkesa i njoftohet të pandehurit, mbrojtësit të tij, viktimës ose trashëgimtarëve të saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim. Ata kanë të drejtë të njihen me aktet dhe provat, si dhe të marrin kopje të tyre”*. Në këtë mënyrë, palëve u është mohuar e drejta për të realizuar të gjitha kërkesat kushtetuese e ligjore të një procesi të rregullt ligjor. Për sa më sipër, Komisioni i kërkoj subjektit të japë shpjegime lidhur me këtë denoncim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësimet e tij, subjekti shpjegon se kjo gjetje e Komisionit dhe pretendimi i shtetasit A. H. për mungesë të “Kërkesës për pushimin e çështjes” nga prokurori, është i bazuar, pasi në fashikull nuk i rezulton të ndodhet shkresa drejtuar kallëzuesit me kërkesën bashkëlidhur. Sa më sipër ka ardhur si pasojë e ngarkesës së lartë në punë në vitin 2022. Nga ana tjetër, kjo e metë e hetimeve paraprake nuk ka sjellë asnjë pasojë për të drejtat e shtetasit A. H., pasi ai është njoftuar rregullisht nga Gjykata e Seancës Paraprake, ai ka marrë pjesë në gjykim dhe ka parashtruar kërkimin e tij për kthimin e çështjes për plotësim të hetimeve, pretendim të cilin e bazon vetëm në faktin se nuk ishte kryer një hetim i drejtë dhe i bazuar në ligj, pa dhënë asnjë detaj të mëtejshëm për pretendimet e tij apo në çfarë drejtimi konkret duhet të plotësoheshin hetimet. Pra, ankuesit A. H. i është garantuar e drejta e një procesi të rregullt ligjor, për të marrë pjesë në gjykim, për t’u dëgjuar dhe për të paraqitur gjithë pretendimet e tij, për të kundërshtuar rezultatin apo bazueshmërinë e hetimeve të kryera, ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** regj., datë 15.3.2023, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. ***. Natyrisht që kallëzuesi, në respektim të nenit 329/c të Kodit të Procedurës Penale ka të drejtë që të kërkojë revokimin e vendimit të pushimit të çështjes, nëse dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, pasi mori në shqyrtim dosjen e fashikullit të procedimit penal nr. *** dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit, i çmoi rrethanat e kësaj çështjeje, në tërësi dhe harmoni me njëra-tjetrën, duke mbajtur parasysh rëndësinë e shkeljes dhe rëndësinë e pasojës së ardhur. Konkretisht, mosnjohja e kallëzuesit me kërkesën “Për pushimin e procedimit penal” që subjekti i ka drejtuar gjykatës, është i vetmi veprim i subjektit në kundërshtim me dispozitat procedurale; subjekti në prapësime mban qëndrim pohues në lidhje me këtë veprim dhe e justifikon si një veprim të paqëllimshëm, i kushtëzuar nga ngarkesa e madhe në punë; gjykata, nga ana tjetër, ka pranuar si të drejtë kërkesën e subjektit “Për pushimin e procedimit penal”, pavarësisht nga ky veprim që ka kryer ai; pasoja ndaj kallëzuesit për shkak të mosnjohjes së tij me kërkesën e prokurorit “Për pushimin e procedimit penal”, nuk është me vlerë përcaktuese në proces, referuar faktit që kallëzuesi gjatë gjykimit të kësaj kërkesë nuk ka paraqitur ndonjë

provë që mund të pretendonte se nuk i është marrë në konsideratë nga subjekti gjatë hetimit apo nuk ka paraqitur ndonjë pretendim që i është cenuar ndonjë e drejtë tjetër gjatë hetimit. Si rrjedhim i këtyre fakteve, pasoja e pretenduar nga denoncuesi ka mbetur në “niveлин formal” të një të drejte procedurale të pazbatuar, duke zbehur kështu edhe rëndësinë e shkeljes që ka kryer subjekti i rivlerësimit në këtë rast.

Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se një mangësi e tillë me një rëndësi dhe pasojë minimale në rastin konkret, nuk arrin deri në atë nivel sa të ndikojë negativisht në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

73. Denoncim anonim, regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 21.7.2023, kundër subjektit të rivlerësimit. Më konkretisht, denoncuesi pretendon se subjekti i ka kërkuar 20.000 euro për të pushuar çështjen. Denoncuesi nuk referon të dhëna në lidhje me procedimin penal.

Nisur nga fakti që pretendimet e denoncuesit nuk referojnë ndonjë provë apo shkelje procedurale konkrete nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk gjen *indicie* për fillimin e hetimeve të mëtejshme në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

74. Denoncimi i shtetasit G. R., regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 21.6.2023, drejtuar subjektit të rivlerësimit në lidhje me procedimin penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, regjistruar në datën 20.2.2023. Sipas denoncuesit, subjekti ka vepruar në kundërshtim flagrant me kriteret e nenit 290, shkronja “e” dhe nenin 7 të Kodit të Procedurës Penale, duke e gjykuar “hetuar” denoncuesin dy herë për të njëjtin fakt. Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dosje të fashikullit përkatës penal. Me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2023, kjo prokurori informon Komisionin se në bazë të kallëzimit të shtetasit E. N., prokuroria ka regjistruar procedimin penal me nr. ***, datë 12.4.2023, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186. Çështja vijon të jetë në fazë hetimi.

Sa më sipër, Komisioni çmon se kontrolli i aftësisë profesionale nuk mund të kryhet për këtë çështje, sipas pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, pasi për rrjedhojë do të paragjykohej zgjidhja e një çështjeje që është duke u shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit.

75. Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet e mësipërme, sipas ligjit nr. 84/2016, si dhe shpjegimet e dhëna dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit dhe nuk gjeti elemente që përbëjnë dyshime për paaftësi profesionale apo që cenojnë figurën e prokurorit.

75.1. Gjithashtu, në prapësime subjekti ka ngritur pretendimin se: *“Disa dosje që Komisioni ka marrë në shqyrtim, janë përtej periudhës Vetting datë 8.10.2016, të përcaktuara nga ligji nr. 84/2016. Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, do të jenë 3 vite e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 84/2016. Në rast se subjekti i rivlerësimit ka më pak se 3 vite në detyrë, periudha e vlerësimit konsiderohet e gjithë koha gjatë ushtrimit të detyrës. Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim si përjashtim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Pra, periudha e rivlerësimit nuk mund të shtrihet asnjëherë pas datës 8.10.2016! Pas kësaj date, në respektim të neneve 3, pika 2, 41 të ligjit nr. 84/2016, të nenit 171 të ligjit nr. 96/2016, si dhe neneve 4 dhe 7 të Kushtetutës së Shqipërisë, kompetencën ekskluzive për të bërë inspektimin e shkeljeve disiplinore dhe vlerësimin etik e profesional të magistratëve e ka Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë”.*

75.2. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, Komisioni sjell në vëmendje se përtej periudhës 8.10.2013 – 8.10.2016 janë këto çështje të shqyrtuara më lart: ankesa nr. ***, viti 2020, e shtetasit D. N. (procedim i vitit 2019); ankesa nr. ***, viti 2009, e shtetasit S. Sh. (procedim i vitit 2008), si dhe denoncimet nr. *** prot., datë 27.1.2022 (procedim penal i vitit

2021); nr. *** prot., datë 24.12.2018 (procedim penal i vitit 2018); nr. *** prot., datë 24.1.2023 (procedim penal i vitit 2021).

75.3. Në referim të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, trupi ka shqyrtuar ankesën nr. ***, viti 2020, të shtetasit D. N. (procedim i vitit 2019), nisur nga fakti që ishte një informacion i dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme mbi bazën e një ankimi ku pretendohet për shkelje të kryera nga subjekti në aspektin profesional. Pra, në këtë rast Komisioni i është përmbajtur kësaj dispozite ligjore.

75.4. Në lidhje me ankesën nr. ***, viti 2009, dhe tre denoncimet, pavarësisht se janë tej afatit ligjor të vlerësimit, Komisioni sjell në vëmendje se për këto procedime nuk janë konstatuar mangësi që e ngarkojnë subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi.

76. Pas një analize në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, bazuar edhe në opinionin e Komisionit të Venecias dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, të cilat kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, Komisioni nuk i çmoi problematikat e evidentuara dhe të trajtuara hollësisht në këtë vendim si shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të germës “e” të Aneksit të Kushtetutës, apo që ta bëjnë atë të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

SEANCA DËGJIMORE

77. Në datat 19.12.2023 dhe 9.1.2024, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvilluan seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Valentin Preçi i cili në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisioneren Xhensila Pine, e cila rekomandoi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit dhe shpalli vendimin në seancën e datës 7.12.2023, sipas pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

78. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi u është përgjigjur me korrektësi dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime/deklarime për informacionin e kërkuar bazuar në dokumente shkresore dhe bazën ligjore, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

79. Shumica e trupit gjykues, bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit, sipas pikës 5 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit

Valentin Preçi ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 51, shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Valentin Preçi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 10.1.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore (kundër)

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku

V.Preci																		
Periudha		Viti 2003	Viti 2004	Viti 2005	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	TOTAL		
Perberja familjare (certifikate)/nr. persona		1	1	1	1	2	2	3	3	4	4	4	4	4	4			
KATEGORI	NËNKATEGORI																	
ASETE	Ao. me sip. 84.54 m ² dhe garazh me sip. 14 m ² në S. Tirane blerë me kontratën e shit-						6,190,000									6,190,000		
	Automjet Benz Mercedes me targë *** vit prodhimi 1991 në vlerë 230,000 lekë , datë krijimi 02.07.2004, deklaruar		230,000				-230,000									0		
	Automjet Opel me targë *** , blerë me kontratë datë 19.12.2009 në shumën 3,600 euro, shitur me kontratë datë 5.11.2014 në shumën 3,500 euro.								496,656					-496,656		0		
	Automjet Ford vit prodhimi 2002, blerë nga personi i lidhur (bashkëshortja) në ShBA në vitin 2010 në shumën 2815 USD (deklaruar);									292,760				-292,760		0		
	Automjet Volkswagen Jetta vit prodhimi 2010, blerë nga bashkëshortja në ShBA në datë 10.06.2016 në shumën 3250 USD;														416,553	416,553		
	Automjet Skoda Fabia, me targë *** (vit prodhimi 2011), blerë me kontratë datë 18.10.2016 në shumën 3,200 USD.														410,144	410,144		
	Likujditë (ndryshim gjendje, shtesa/pakësime)			265,853	511,292	683,922	-884,829	-486,193	421,654	315,252	1,006,163	1,183,617	37,746	-427,794	-1,141,388	1,485,298		
TOTALI		0	230,000	265,853	511,292	453,922	5,305,171	10,463	714,414	315,252	1,006,163	1,183,617	-751,670	-427,794	-314,689	8,501,994		
DETYRIME	Kredi Hipotekore marrë në Emporiki Bank me kontratë në datë 12.03.2008 në shumën 24.500 euro, për 20 vjet (Principali);						2,969,277	-83,929	-80,002	-85,479	-81,556	-93,382	-105,376	-115,446	-123,330	2,200,778		
	Kredi Konsumatore marrë në Emporiki Bank me kontratë në datë 12.03.2008 në shumën 5.500 euro, për 4 vjet (Principali);						578,162	-152,800	-160,747	-194,801	-69,815					0		
	Hua nga kunati L.D (shuma 5.000 Euro);									619,000	-619,000					0		
	DETYRIME shoqërisë ndëruase						1,238,000			-619,000			-619,000			0		
TOTALI		0	0	0	0	0	4,785,439	-236,729	-240,749	-280,279	-770,370	-93,382	-724,376	-115,446	-123,330	2,200,778		
TE ARDHURA	Të ardhura neto nga paga e subjektit të rivlerësimit;	435,823	825,163	817,747	801,542	880,327	887,790	893,227	1,130,068	1,125,880	1,145,620	811,768	1,155,863	1,112,157	1,146,708	13,169,683		
	Të ardhura neto nga Prisma Communication (bashkëshortja);						420,000	300,000								720,000		
	Të ardhura të tjera (pagese paafesie paguar nga Posta Shqiptare);														180,540	180,540		
	Të ardhura nga paga bashkëshortja në USA ;								662,737	610,938	2,211,736	2,057,063				5,542,473		
	Të ardhura rimbursime nga taksa ShBA ;									24,412	154,223	767,413	951,685			1,897,733		
	Të ardhura nga Assistance Group ;							162,111	234,624	31,832	352,057	495,956	730,213			2,006,792		
	Të ardhura, ndihma të tjera ShBA ;														132,656	132,656		
	Të ardhura të deklaruara të realizuara nga ceremonia e martesës në muajin nëntor 2007 (500,000 lekë);															0		
	Të ardhura nga lojrat e fatit deklaruar;															0		
	Dhurime nga vjehëri dhe kunetërit me rastin e lindjes së vajzës (deklaruar në DIPPV 2009 shuma 100,000 lekë nga vjehëri dhe nga 50,000 lekë kunetërit);							346,640	641,472	381,618						1,369,730		
	Dhurime/donacion nga vjehëri për pagesë këstesh kredie, shpenzime udhëtimi etj, deklaruar në pyetësor;															0		
	Dhurime/donacion nga te trete viti 2016 deklaruar nga shtetasi T.A (shuma 2,000 Euro);														270,460	270,460		
	Dhurime/donacion nga te trete viti 2016 deklaruar nga shtetasi G.S (shuma 100,000 lekë);															100,000		
Dhurime/donacion nga te trete viti 2016 deklaruar nga shtetasi M.Gj (shuma 30,000 lekë);															30,000			
Të ardhura të dokumentuara nga paga subjektit për periudhën 2001-2002;		351,600													351,600			
TOTALI		787,423	825,163	817,747	801,542	880,327	1,654,430	1,996,810	2,409,046	1,793,061	3,863,636	4,132,200	2,837,760	1,112,157	1,860,364	25,771,667		
SHPENZIME	Kredi hipotekore marrë në Emporiki Bank me kontratë në datë 12.03.2008 në shumën 24.500 euro, për 20 vjet (Interesa);						12,6495	197,984	183,411	228,445	251,308	228,194	203,689	183,486	171,923	1,774,935		
	Kredi Konsumatore marrë në Emporiki Bank me kontratë në datë 12.03.2008 në shumën 5.500 euro, për 4 vjet (Interesa);						61,061	73,846	39,999	21,461	1,903					198,269		
	Shpenzime për komisioin dhe sigurime të lidhura me kredite;						82,941	35,939	34,896	41,708	10,014	9,020	8,708	8,189	7,695	239,111		
	Shpenzime për regjistrimin/ sigurime automjeti sipas AMF;														14,700	14,700		
	Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit ;						165,416	268,072	389,541	151,631	227,148	222,384	228,715	333,488	478,715	2,465,109		
	Shpenzime për telefoninë celulare referuar Credins bank;								188,776	160,345	204,218	173,090	42,075	35,587	30,647	834,738		
	Shpenzime për telefoninë celulare referuar Raiffeisen bank;								109,280							109,280		
	Shpenzime për telefoninë celulare deklaruar në pyetësor;			60,000	60,000	60,000										180,000		
	Shpenzime hipotekore ;														23,254	23,254		
	Shpenzime blerje me MC ne Credins Bank (ilog e subjektit) për periudhën ;													146,734		146,734		
	Shpenzime për blerje mobilje për shumën 4950 eu, të tërhequra cash në datë 10.04.2008 nga Illogaria në emër të subjektit (burim kontrata e huasë datë 12.03.2008, Banka Emp							150,000								150,000		
	Shpenzime arëdim mobilim pajisje elektroshtëpiake të deklaruara ;									50,000		100,000	50,000		150,000	350,000		
	Humbje nga shitja/njerja jashtë përdorimit/vjedhja pasuri të huajshme (sistemim);						230,000								149,127	379,127		
	Humbje nga kursi i këmbimit EURO, për pagesat e kështjve të apartamentit dhe Garazhit në Selitë Tirane (SISTEMIM);										75,650				81,700	157,350		
	Humbje nga kursi i këmbimit EURO, për pagesat e kështjve të kredive (principali) SISTEMIM);								27,077	29,111	34,254	19,307	12,371	13,908	12,570	159,985		
	Shpenzime minimale për konsum deri në datë 31.12.2002;	125,152														125,152		
	Shpenzimet mesatare për jetesë në USA (pa përfitime qytetare) duke filluar nga data 10.10.2011 ;									626,167	1,935,361	1,830,706	223,234		319,823	4,935,292		
Shpenzime qiraje në USA ;															0			
Shpenzime shtese qëndrimi dhe ushqimi tek prinderit në Kamez Tirane (deklaruar illogaritur);	26,036	26,036	10,443	10,443		273,240	313,665	409,860	301,313	139,548	164,979	824,540	897,104	758,735	4,624,579			
Shpenzime minimale për konsum në vend sipas INSTAT, ILLDKPKI (2003-2016) .	93,964	93,964	109,557	109,557	134,554	273,240	313,665	409,860	301,313	139,548	164,979	824,540	897,104	758,735	4,624,579			
TOTALI	245,152	120,000	180,000	180,000	424,554	859,153	1,025,861	1,275,595	1,690,975	2,788,806	2,755,444	1,995,685	1,470,424	1,928,925	16,940,573			
ANALIZA FINANCIARE		Viti 2003	Viti 2004	Viti 2005	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	TOTAL (2003-2016)		
1. Të ardhura		787,423	825,163	817,747	801,542	880,327	1,654,430	1,996,810	2,409,046	1,793,061	3,863,636	4,132,200	2,837,760	1,112,157	1,860,364	25,771,667		
2. Asete		0	230,000	265,853	511,292	453,922	5,305,171	10,463	714,414	315,252	1,006,163	1,183,617	-751,670	-427,794	-314,689	8,501,994		
3. Detyrime		0	0	0	0	0	4,785,439	-236,729	-240,749	-280,279	-770,370	-93,382	-724,376	-115,446	-123,330	2,200,778		
4. Shpenzime		245,152	120,000	180,000	180,000	424,554	859,153	1,025,861	1,275,595	1,690,975	2,788,806	2,755,444	1,995,685	1,470,424	1,928,925	16,940,573		
Balanca e fondeve (1-2+3-4)		542,271	475,163	371,894	110,280	1,851	275,546	723,756	178,289	-493,444	-701,704	99,757	869,369	-45,920	122,779	-12,41,688		

* Kjo pasqyrë është e lidhur me Aneksin "Shpjegime të analizës së neqesive financiare" të Rezultateve të Hetimit Administrativ